



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:073664

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765177

PKR.nr.112/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË– Departamenti për Krime të Rënda, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Ilir Rashkaj, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët Drilon Haraçia dhe Sulltan Dobraj, anëtarë të trupit gjykues, si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, në çështjen penale kundër të pandehurit D. Gj. nga Lagjja . . ., Komuna e V.s, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprave penale: Vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1, pika 1.5 të KPRK-së (Ligji nr.04/L-129), dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së (Ligji nr.04/L-129), i pandehur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr. 249/2020 datë 05.08.2022, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor publik me dt. 05.08.2022, 20.09.2022, 04.11.2022, 20.12.2022, 25.09.2023 dhe 27.10.2023, në praninë e mbrojtësit të pandehurit av. Xhemajl Ademaj nga Prishtina, i caktuar sipas autorizimit dhe të dëmtuarve A. K. dhe G. A., si dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H. A., av. Prek Kola, me datën 20.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 17.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

D. Gj., me nofkën E. nga i ati N. dhe e ëma M., e gjinisë T., data e lindjes . . ., në fshatin K., M., Republika e Shqipërisë, me vendbanim lagjja . . ., V., Republika e Shqipërisë, i martuar, i ati i dy fëmijëve, me profesion bujk, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal . . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

I.

Sepse, me datë 14.10.2018, rreth orës 07:48 minuta, në fshatin S., Komuna e Gjakovës, ka privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S, Komuna e Gjakovës, dhe me atë rast vë në rrezik jetën e të dëmtuarit A. K., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri D., rreth orës 02:30 min., ka vendosur një material eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të

ndjerit H., në momentin kur tani i ndjeri rreth orës 08:02 min, del nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll dyert e oborrit, i pandehuri nga një largësi e panjohur, përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K..

Me çka kishte për të kryer veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 179 paragrafi 1 pika 1.5 të KPRK-së.

## II.

Sepse, më parë ka siguruar dhe gjerë me datë 14.10.2021, pa autorizim, ka poseduar materie eksplozivi të tipit dhe natyrës së panjohur në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla e të cilin eksploziv ditën kritike rreth orës 08:02 min, i pandehuri e aktivizon në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi duke privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës.

Me çka kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 KPRK-së.

*Për shkak se nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.*

Shpenzimet e procedurës penale paguhën nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Të dëmtuarit: A. K. dhe F. A., që të dy nga Gjakova, rr. “. . .”, p.nr., si dhe H. A. e G. A., që të dy nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

### *1. Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit*

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.249/2020, të datës 05.08.2022, kundër të pandehurit D. Gj. nga Lagjja . . . , Komuna e V., Republika e Shqipërisë, për shkak të veprave penale: Vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1, pika 1.5 të KPRK-së (Ligji nr.04/L-129), dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së (Ligji nr.04/L-129), të cilën e ka dorëzuar në gjykatë me datë 08.08.2022 dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

### *Kompetenca*

Gjykata Themelore në Gjakovë duke u bazuar në Ligjin për Gjykatat, saktësisht në nenin 19 par.1, e lidhur me nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale, vlerëson se ka kompetencë lëndore dhe territoriale për ta trajtuar këtë rast penal. Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra e pretenduar penale ka ndodhur në fshatin S., Komuna e Gjakovës dhe rrjedhimisht, bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Gjakovës sipas nenit 29 paragrafi 1 të KPRK-së. Sipas nenit

15, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat, veprat penale Vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1, pika 1.5 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së bien në juridiksionin e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, prandaj, lënda është gjykuar nga Departamenti për Krime të Rënda.

### *Rrjedha e procedurës*

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.08.2022, në të cilën kanë marrë pjesë: Prokurori i Shtetit Sahide Sefa, dhe i pandehuri D. Gj., së bashku me mbrojtësin e tij, Av. G. Pozhegu me seli në Gjakovë, i angazhuar sipas autorizimit, ndërsa për të dëmtuarit nuk ka prezantuar askush.

Meqenëse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku gjithsej janë mbajtur 16 seanca, dhe atë me datat: 30.08.2022, 16.12.2022, 10.01.2023, 02.02.2023, 13.03.2023, 08.05.2023, 22.06.2023, 25.09.2023, 20.10.2023, 17.11.2023, 27.12.2023, 19.12.2023, 22.01.2024, 05.03.2024, 07.03.2024, 15.03.2024, ku kanë qenë të pranishëm: Prokurori i Shtetit Ervehe Gashi, i pandehuri D. Gj., së bashku me mbrojtësin e tij, av. Xhemajl Ademaj nga Prishtina, i caktuar sipas autorizimit, si dhe të dëmtuarit A. K., H. K., F. dhe G. A., si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H. A., av. Prek Kola, me ç'rast prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

### *Publiciteti dhe regjistrimi i seancave të shqyrtimit gjyqësor*

Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë rast kanë qenë publike. Seancat e shqyrtimit gjyqësor nuk janë regjistruar me audio dhe video në mungesë të pajisjeve të nevojshme për incizime të tilla, mirëpo regjistrimi është bërë vetëm në procesverbal me shkrim. Palët nuk kanë pasur vërejtje në përmbajtjet e procesverbaleve. Pas çdo seance të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit.

## *2. Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor*

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës, ka qëndruar në tërësi pranë saj.

I pandehuri D. Gj., pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. Xhemajl Ademaj nga Prishtina, duke u deklaruar lidhur me fajësinë, ka theksuar, se: nuk e pranon fajësinë për veprat penale e këtë e ka bërë edhe në shqyrtimet e kaluara.

### *2.a. Fjala hyrëse*

2.a.1. Prokurori i Shtetit Ervehe Gashi, ka deklaruar se: në këtë çështje penale DKR i prokurorisë ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarit D. Gj. për shkak të veprave penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.5. e KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, përshkrimet e pikës 1 dhe 2 të kësaj aktakuze pa mëdyshje do të vërtetohen nga dëshmitë materiale dhe deklaratat e të dëmtuarave, deklaratat e dëshmitarëve dhe deklaratat e të dëmtuarve të marrë në cilësinë e dëshmitarit se me datën 14.10.2018 rreth orës 07:48 minuta, në fshatin S. të Komunës së Gjakovës, është kryer vepra penale e vrasjes në mënyrën e përshkruar si në aktakuzë e në dëm të të dëmtuarit H. A., kjo do të vërtetohet edhe nga provat materiale të radhitura në propozimin nën pikën 2.2. të

aktakuzës që e përfaqëson, si dhe nga provat materiale të cilat do të shikohen e të radhitura në pikën 2.3. të propozimit të aktakuzës. Po ashtu edhe vepra penale e dytë do të vërtetohet po nga këto prova materiale.

2.a.2. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H. A., avokati Prek Kola nga Gjakova, ka deklaruar se: e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të prokurores së shtetit e po ashtu shton se pas administrimit të provave të cilat janë propozuar në aktakuzë konsiderojnë se do të vërtetohet në tërësi dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet. Po ashtu kanë paraqitur edhe kërkesën pasurore juridike.

2.a.3. E dëmtuara F. A., ka deklaruar se: e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të prokurores së shtetit dhe përfaqësuesit të autorizuar, av. Prek Kola nga Gjakova.

2.a.4. I dëmtuari A. K., ka deklaruar se: e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të prokurores së shtetit dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe parashton kërkesë pasurore juridike.

2.a.5. I dëmtuari G. A. ka deklaruar se: e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të prokurores së shtetit dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe parashton kërkesë pasurore juridike.

2.a.6. Mbrojtësi i të pandehurit D. Gj., avokati Xhemajl Ademaj, ka deklaruar se: aktakuza si e tillë nuk do të duhej që të kishte arritur deri në këtë fazë të procedurës, për arsye se alibinë me ligje pozitive dhe ndërkombëtare i takon prokurorisë ta vërtetojë, pas administrimit të provave në këtë shqyrtim për të dy veprat penale për të cilat akuzohet D. Gj., do të bindeni se aktakuza nuk ka mbështetje në prova të ligjshme dhe relevante, se ajo është ndërtuar mbi bazën e dyshimit të bazuar të deklaratave të dëshmitarëve të cilat kanë ndryshuar disa herë. Ky veprim i prokurorisë është i paprecedent e cila në mungesë të provave e prodhon një dëshmi të pavërtetuar asnjë herë që quhet dyshim i bazuar dhe i dha rol vendimtar në ngritjen e akuzës. Gjithashtu me provat që do të administrohen do të provohej edhe motivi i cili gjendet i përmendur në aktakuzë, se gjëja D. ka pasur mosmarrëveshje me viktimën dhe për shkak të disa pazareve ka ardhur deri tek rasti. Andaj, i nderuar trup gjykues nga provat që do të administrohen do të provohet në procedurë se i akuzuari D. Gj. nuk është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet. Nga trupi gjykues ka kërkuar që të administrohen tri kategori të prova shfajësuese për të mbrojturin e tij: 1. Ekspertizat forenzike që nuk figurojnë asnjë provë relevante që e lidh klientin e tij me vendin e ngjarjes apo ngjarjen kriminale. 2. Provat, dokumentet e noterizuara si transkripti apo tabulaten e nxjerr nga Kompania Vodafon, të bisedave telefonike me kënd ka komunikuar i mbrojturi i tij gjatë ditës dhe orës kritike të datës 14.10.2018. 3. Dëshmitë e dëshmitarëve të cilët kanë qenë në kontakt atë ditë me të mbrojturin e tij në territorin e Rep. së Shqipërisë, prandaj në bazë të cekurave më lartë konsideron se shqyrtimi kryesor do të vërtetojë pafajësinë e të mbrojturit të tij, nga se nuk ka prova as në kuptimin formalo-juridik e as materialo-juridik, për të akuzuarin D. Gj. për veprat penale për të cilat akuzohet.

2.a.7. I pandehuri D. Gj., ka deklaruar se: pajtohet me deklaratimet e bëra nga mbrojtësi të tij, av. Xhemajl Ademaj, duke shtuar se në momentin që del vetëm një provë e vetme që i njëjti ka dijani se kush e ka kryer këtë vepër, gjykata me kërkesën e tij është e lutur që të i jep dënimin maksimal që parashihet me ligjet e Kosovës.

2.b. *Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.*

Meqenëse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, Gjykata seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave, me ç'rast në cilësi të dëmtuarve-dëshmitarëve ka dëgjuar:

F. A., G. A. dhe A. K., ndërsa në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar: G. B., S. B., F. A. P., L. LL., L. Sh., P. B., G. S., dhe ekspertët Sh. G. F. dhe S. S., si dhe janë lexuar dhe administruar edhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si:

- Raporti i Autopsisë MA 18-311, i dt.14.10.2018;
- Raporti i ekspertimit të gjurmëve daktiloskopike me nr. AKF/2019-0545/2019-484, i dt. 25.06.2019;
- Raporti i ekspertimit të ADN-së me nr. AKF/2019-0545-483, i dt. 16.10.2019;
- Raporti i ekspertimit balistik të Laboratorit të AKF-së për analiza zjarr vënie dhe eksploziv me nr. AKF/2019-0070;
- Raporti i ekspertimit të AKF-së, AKF/2019-0545/2019-485, të dt. 07.03.2019;
- Raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës;
- Procesverbali për identifikimin e të dyshuarit i dt. 06.10.2020;
- Komunikimi nga llogaria e FB-së “. . .”;
- Raporti i Sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së, me nr. të dosjes 168-FVTI-2018 dhe nr. i dosjes së hetimit 2018-EA-1124;
- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124;
- Raporti shtesë i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës NJETK-EA-32 dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124;
- Raporti pas operacional i Njësisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive me nr. ref./04/2-01E/216-A/2018;
- CD-ja me video incizim 2018-EA-1124, të dt.14.10.2018;
- Foto dokumentacioni nga dosja e forenzikës NJRTEK-18-32;
- Tabela e matjeve të vendit të ngjarjes;
- Skica e vendit të ngjarjes;
- Lista e dëshmimeve me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124;
- Raporti i sektorit për fotografi, videoanalizë dhe ekzaminim të T.I.-së;
- Raporti i ekspertimit i bërë nga AKF, me nr. AKF-2023-0291, i dt. 18.08.2023, dhe
- Raporti i ekspertimit i lëshuar nga Instituti Forenzik në Cyrih të Zvicrës.

2.b.1. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 16.12.2022, në cilësi të dëmtuarës është dëgjuar F. A., me ç’rast e njëjta duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se: në deklaratën e dhënë në Prokurori me datën 22.07.2020, po ashtu për të dytën herë në Prokurori me datën 22.09.2021, i kujtohet se çka ka deklaruar dhe

mbetet pranë atyre deklaratave të dhëna, për herë të fundit babain e kishte parë, një natë para natës kritike, ashtu që babai i saj kishte shkuar në banesë dhe kishin biseduar dhe e kishte lënë me burrin (A.) me datë 14.10.2018, që të shkojnë për të bërë pazar për pasterm në fshatin S., atë ditë burrin e kishte lutur që mos të shkonte aq herët se ishte ditë pushimi, kurse bashkëshorti i kishte kërkuar që të vazhdoj të flej, ndërsa e njëjta i kishte kërkuar që të ja sjell nënën, pasi që nëna ishte në banesë kurse A. i kishte thënë, se frikësohet se mos po pisket H. meqë e kanë lënë në orën 07:00/h me shku për ta blerë pastermen, pastaj i kishte thënë: Nënës dil poshtë, dhe e ka sjellë në banesën e saj, ndërsa A. ka shkuar në drejtim të fshatit S, për arsye se babai një javë para se të vritej, kishte shkuar për të fjetur në fshatin S, dhe burri shkojë për ta marrë babën në fshatin S. dhe për të shkuar me bo pazare për të blerë pastermen. Gjersa ishte duke biseduar me nënën se kishte fole e njëjta me babën dhe i kishte treguar se është një sinjal i keq, se B. ka ikur jashtë që dy (2) ditë dhe e kishte thirr burrin në telefon në orën 07:30/h duke i treguar se H.-nëna është ka pret për të shkuar, ndërsa i njëjti i kishte thënë: Hajt, hajt, dhe e ka ndalur telefonin, pastaj e kishte telefonuar qika e axhës - qika I., dhe duke i cituar fjalët, “F. moj, unë e pyeta se si e ke burrin dhe fëmijët?, ajo i kishte thënë: Se a e dinë çka ka ndodhur në S?”, ku e dëmtuara ia ka ndalur telefonin dhe e ka thirr A., dhe i ka thënë: Se çfarë ka ndodhur me bacën Xh. (H.), më ka thënë: Mina, mina, dhe e kam pyetur: Se a është gjallë, A. i ka thënë: Jo, H. ka vdekur. E njëjta thekson se, B. e ka djalin e axhës, ndërsa sinjali i keq ishte sepse vëllai i saj, A., ishte vrarë për shkak të B., dhe B. prapë se prapë në familjen e saj shikonte me bo vrasje, kurse një (1) javë para se të vritet babait, i vjen një ilake, dhe i thotë ki kujdes, se B. është duke e përgatitur vrasjen, pra ky person na tregojë se B. kishte shkuar në Gjermani, dy (2) ditë para se të ndodhte vrasja, para se të ndërronte jetë babai i saj, të dëmtuarës i vinin mesazhe nga D., që e kishte baba im i ndjerë (H.) atë në Facebook dhe ajo (F.) bashkërisht e kanë përdorur, një natë para natës kritike bënë telefoni dhe i vjen një mesazh nga D, duke i kërkuar që ti thotë babës edhe burrit që të vijnë në Shqipëri se është duke e ndrequr një çati dhe nuk mund të vijë në Kosovë, kurse e njëjta për shkak se dyshonte, ia kishte kthyer: Se baba nuk mund të vjen, kurse në mëngjes një (1) orë para se të bëhet vrasja, i kujtohet shumë mirë se ka qenë ora 6 apo 7, nuk i kujtohet shumë mirë, dhe D. i kishte shkruar se kur ka prerë (nxjerr) biletën H. për tu kthyer në Gjermani, por e dëmtuara ia ka kthyer: Se nuk di. Pas këtij momenti e deri në orën 16:00/h D. nuk ka hy në rrjetin social, D. e njeh si E. Gj., ndërsa babai i kishte treguar se është D. Gj., babai i kishte thënë një ditë, a do më dërgosh në Prizren, dhe më tha se do të vie një shok i A. për të shitur mjaltë, pastaj babai kishte shkuar edhe në Shqipëri tek D, pastpo ashtu D kishte ardhur edhe në Gjakovë, fillimisht kishte ardhur tek pllaci ku është në . . . për ta shikuar vendin e për ta kryer vrasjen e B. që D. na kishte ofruar për ndihmën e shokut A., por kur e ka kuptuar të vërtetën, kur janë lyp çelësat e S. dhe i ka thënë baba, F. nuk ka qef D. që të e sheh njeri dhe unë pas dyshimeve që kishte, se e sjelli babën disa herë (10 herë) nga Gjermania, eja-shko, dola në ballkon e nala dritën e ballkonit, nënës i thash, ti dërgojë çelësat se do të shikojë se kush është ai njeri, dhe doli e pash, pak më i plotë se sot, një vinjakë të zi me kapulaqë me lesh, dhe u nisën në drejtim të S., e gjithë kjo ka qenë afër dy muaj para vrasjes, ku një muaj, i kishte thënë babit, mi largo qenët prej S. dhe me u siguri që kamerat të mos punojnë, dhe babi kur e kishte dërguar në S., thotë që D. i ka thënë se mua më vyn vetëm çelësi i dhomës aty ku është vendosur eksplozivi dhe thotë e shikojë gjithë oborrin, ku deshti të kalojë murin e I.-në oborr të I., por baba i kishte ndaluar dhe i kishte thënë që nuk ki nevojë të hysh aty, ku D. kishte bujtur një natë me babin në S., dhe pastaj babës i kishte thënë se ti mund të largohesh të shkosh në Gjermani, po ashtu shtojë se baba i kishte larguar

qenët, dhe i kishte shikuar kamerat të cilat kanë qenë të këputura nga qenët. Para se të ndërrojë jetë babai për herë të fundit kishte qenë në fshatin S., një javë para ditës kritike, ku edhe ka fjetur në shtëpi në fshat, ku ka qëndruar vetëm në shtëpi, pasi që nëna dhe gruaja e G. kanë qenë në banesë. Pasi që ka ndodhur vrasja, i ka thirr djemtë e I. për me ardh e me marrë dhe me dërgu në S., por askush nuk është përgjigjur dhe e ka thirr kunatin e saj A. K., dhe ka ardh me marrë, para se të shkonte në S., i ka shkruar D., duke e akuzuar se i ka vrarë babën, dhe për me i zhdukur gjurmët pasi që burri i saj i dinë të gjitha të vërtetat dhe njihet me D., ke dashur me ma vra edhe burrin, po ashtu prej momentit kur i ka shkruar, e më ka pyetur se kur e ka prerë baba biletën, D. më nuk ka shkruar dhe nuk ka qenë në rrjete sociale, dhe i ka shkruar, se ti je vrasësi i babës tim dhe ke dashur me ma vra edhe burrin, pastaj kam shkruar në S., ka qenë rreth orës 09:30/h, baba kishte qenë i shtrirë por policia nuk e kishte lënë që të afrohet, ka shkruar në oborr të I., por aty nuk kishte rrjet-internet, isha shumë e shqetësuar për të shikuar nëse D. ka hyrë në rrjete sociale dhe a kishte rrjet, por meqë nuk kishte rrjet nuk ka arritur që ta shoh, mesazhin e tillë D. ja kishte shkruar për arsye se e dinte se D. e kishte kryer vrasjen, dhe ishte paraqitur se gjëja është prishur në pazar me babën, pastaj ka shkruar tek familja e burrit në fshatin Brekoc, rreth orës 12:00/h, aty kishte rrjet dhe ka hyrë në Facebook, por në faqen e D. nuk kishte dal se ka hyrë në rrjet e as që është mbushur pika që ka qenë i kyçur në rrjet deri në orën 16:00/h. Pas orës 16:00/h, D. insistonte me anë të shkrimit, që të vinte tek dera e banesës së të dëmtuarës, por nuk ka ardhur, pasi që e dëmtuara kishte frikë se mos po i bënte ndonjë gjë, për atë arsye nuk e ka lejuar. Ky nuk ishte kontakti i fundit që ka komunikuar me D, pasi që D. ka shkruar edhe pas rastit të vrasjes rreth 1 muaj e gjysmë, dhe e kërcënonte se nuk e ka kryer vrasjen, dhe kërkonte të mos shkonin në polici, se e ka akuzuar e njëjta se e kishte paraqitur në polici dhe prej frikës që kishte i kishte thënë se në polici kanë shkruar të gjithë, dhe nuk ka shkruar vetëm e dëmtuara. Ditën kritike ka dhënë deklaratë në polici, dhe posa ka dal nga policia, D. përsëri e kërcënonte se, përse ka shkruar në polici dhe ka dhënë deklaratë. Sipas të dëmtuarës i pandehuri D. e kishte kërcënuar me fjalët: se ti mua ma ke borxh jetën, ndërsa pasi që ka dhënë deklaratë në polici dhe ka dal nga SP, e kërcënonte dhe i dërgonte disa plagë që e kishte bërë shpinën operacion duke i thënë se ti me burrin tënd keni me pësuar pasi që më keni lajmëruar në polici, dhe më keni borxh jetën, duke shtuar se e ka kërcënuar me jetë dhe i ka thënë se nëse dënohet nga organet e shtetit të Kosovës, do t'i rrezikohet jeta, ashtu që nga frika e këtyre kërcënimeve që tre vite nuk ka shkruar në Shqipëri dhe banesën e ka të siguruar me kamera. Me D. së pari ka shkruar në llogarinë "Mirdita D." në Facebook, pastaj i kishte thënë, që kurrë më mos më shkruaj në këtë llogari dhe i kishte dhënë adresën tjetër ". . .", pastaj përmes asaj adrese e njëjta dhe babai i saj kanë kontaktuar me D, e cila llogari ka qenë në Facebook. Me babain thekson se i ka pasur raportet shumë të mira dhe para se të vritet babai me D. nuk ka pasur kontakte të drejtpërdrejta, përveç rrjeteve sociale, pasi që babai i kishte thënë, se i është ofruar një shok i A., nga Shqipëria, për ta kryer vrasjen e B., e njëjta ka shkruar sepse ka cituar se me babën e kanë pasur një Facebook dhe kur shkruante D., e njëjta ia kthente, pasi që i njëjti pyeste çdo herë për babën, llogarit në Facebook "H.B." dhe . . ., kanë qenë llogari të babës dhe përmes këtyre dy llogarive ka komunikuar me të akuzuarin D. Gj..

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar t/ të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: Përveç të dhënave për të akuzuarin D. Gj., se është nga Shqipëria dhe faqet e internetit të lartcekura, e di se njëjti ka jetuar në V., këtë e di sipas babait

të saj, adresën nuk e di, por e di që shtëpinë e ka pas në V., dhe në kohën kur ka ndodhur rasti, vëllai i saj G.ka qenë në burg. Kur ka shkuar në burg nuk i kujtohet por e di se ka shkuar pasi që i njëjti ka gjuajtur me e vra B.n, për arsye se prej vitit 2013 me B.n janë në hasmëri, kurse D. kishte ardh për ti ndihmuar babin për ta nxjerrur gjakun e A., ku fillimisht G. nuk ka pranuar me u dorëzua, mirëpo baba me D. kishin bërë plan për vrasjen e B.t, dhe baba i kishte thënë se, D. ka insistuar që të mos jetë G. në shtëpi, që të jetë vendi i lirë dhe G. të dorëzohet në polici. E njëjta shton se, pas dyshimit në D., e ka lut babin që ti vendosi kamerat, dhe ai i ka thënë se jo, nuk bënë një herë, por pa e pyetur i ka thënë burrit dhe ai shkojë dhe i ndreqi kamerat, kjo ka qenë 3-5 ditë para ditës kritike, ndërsa qentë fillimisht i ka qar në pllacin tonë në Q., pastaj në S., po prapë në Q., në insistuam që qentë të kthehen përsëri në S., mirëpo e di se qenët i ka helmuar dikush dhe kishin cof, por nuk e di a kanë cof në S. apo Q., por pastaj baba e ka marr një qen tjetër, ku ditën kritike ka qenë në shtëpi vetëm ai qen.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj, e dëmtuara* ka deklaruar: dyshimin se babën e saj e ka vrarë D. Gj., e bazon në faktin se si një njeri i panjohur për babën e saj, nuk e di si afrohet për të vrarë një njeri, në këtë rast B. për shokun e vet (A. A.), duke theksuar se nuk është takuar fizikisht me D. para se me ndodhur vrasja, adresa e përdorur në Facebook prej fillimit ka qenë “Gjakova”, ajo adresë, ka qenë e njëjta adresë por baba ia ka ndërru emrin në “B.H.”, para se të vdiste, ndërsa pas vdekjes së babës citon se përveç me D. nuk ka shkruar me askënd tjetër. Ndërsa në ballafaqimin e mbrojtësit të të pandehurit se kur ju ka kthyer përgjigjen personi me të cilin ka kontaktuar në facebook, me datën 21.07.2020, ka deklaruar se është lajmëruar në orën 16:00/h, kurse me datën 21.09.2021, ka deklaruar se është lajmëruar në orën 18:00/h, e njëjta pohon se e vërteta është se ka qenë ora 16:00/h, por D. vazhdimisht ka shkruar dhe ka kërcënuar deri sa e kanë njoftuar policinë e kjo ka zgjatur rreth një muaj, nuk e di saktë se sa ditë pas rastit të babës ka kërkuar D. për të shprehur ngushëllime, por ndoshta pas një apo dy dite, e që ka kërkuar atë ditë që të vjen te banesa, por ka vazhduar edhe të nesërmen pas varrimit të babës, por nuk ka pranuar. Se ditën kritike D. ka qëndruar në Gjakovë dhe e ka kryer vrasjen, e bazon me vet faktin se i njëjti ka kërkuar me këmbëngulje me ardh për ngushëllime, kurse sa i përketë faktit se ky person ka përdorur dy llogari të facebook, por ka pasur edhe disa llogari të tjera, e dokumentojë duke u bazuar në shokët që i ka pasur shokë në facebook, përveç adresës “. . .”, ku kanë qenë emra të ndryshëm të shokëve, shokjet, etj. Po ashtu në ballafaqimin e mbrojtësit të të pandehurit me bisedat e zhvilluara të dëmtuarës me të pandehurin D., lidhur me pretendimet se e shfajëson D. për vrasjen e babait, O jo, ti jo, për B. horin kam thënë. E njëjta këtë pretendim e ka arsyetuar se pasi që është kërcënuar nga D, edhe policia i kanë thënë që për ta hequr barrën i ka thënë këto fjalë, se do e vriste me gjithë burrin, ndërsa lidhur me deklarimin se ka pasur kërcënime tre muaj pas vrasjes së babës së saj, kur e ka kuptuar se njëherë ka qenë mjalta, banesa për mu shitë dhe nuk ka qenë në dijeni për vrasjen e B., dhe kur e kishte kuptuar, D e kishte kërcënuar se nëse zbulohet ndonjëherë, e njëjta ka e mu vra me burrë e me fëmijë, duke shtuar i njëjti i ka kërkuar edhe fotot e fëmijëve, ku ia kam dërguar, e po ashtu kishte kërkuar edhe foton e djalit të A., ndërsa këto prova nuk i ka ruajtur me arsyetimin se D. e ka pasur passwordin dhe asnjë gjurmë nuk e ka lënë, veç gjurmët që kanë mbetur pas vrasjes, ndërsa se personin që ka kontaktuar në adresën “. . .”, ka qenë D., e vërteton me faktin se burri i saj A. e ka qar në Prizren, ku përmes atij facebookut i ka thënë, se



thuaj burrit le të vjen në këtë vend dhe të më dërgon në Prizren, i cili i kishte shkruar në adresën “Gj.-Gj”, si dhe të gjitha shkrimet i kanë pasur nëpërmjet kësaj adrese të facebookut.

*Duke i ’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të pandehurit, D. Gj., e dëmtuara ka deklaruar se: të njëjtin nuk e ka parë në varrimin e A., sepse nuk e kanë traditë me shku në varrim femrat, rastin e kërcënimit me jetë nuk e ka paraqitur në polici, me siguri nuk jeni ndaluar nga policia në kufi. Kurse lidhur me pretendimin se familja e saj ka bërë bisedë për të kryer një vrasje me babain e saj, e njëjta pohon se ka qenë në dijëni dhe atë tre muaj para vrasjes së babës, mirëpo më përpara nuk ka qenë në dijëni, dhe pohon se burri i saj nuk është takuar ndonjëherë me të pandehurin pa e ditur e njëjta, dhe shuma për këtë vrasje ka qenë, 250.000,- 300.000,-€, këto të holla nuk ja ka dhënë sepse nuk i ka kërkuar, por e di se i ka marrë dy herë nga 100 euro për shpenzime të rrugës, si dhe nuk ka dijëni se G. është takuar me D. për këtë vrasje. Pas ditës së ngjarjes, policia ka kërkuar sekuestrimin e telefonit dhe të njëjtit i kanë nxjerrë të gjitha të dhënat përmes kompjuterit, kurse telefoni i të ndjerit A. nuk ekziston, kurse për kërcënimet e marra pas vrasjes së babait, Policia ka qenë në dijëni.*

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës, e dëmtuara ka deklaruar se: e din që në shtëpinë e babait të saj në S., D. e kishte dërguar një torbë me fishekë dhe një kallash, por çka ka vepruar nuk e di, por baba i ka thënë se pas një kohe i njëjti ka hyrë dhe e ka zhdukur kallashin dhe fishkët, e më nuk kanë qenë aty, e njëjta pretendon se përderisa e ka njohur A., S, shokët e A, po si se ka njohur edhe B., nuk e din se si është planifikuar me e vra B. në S., nuk i kanë treguar, ka ardhur 3-4 ditë para se me ndodhur vrasja dhe ka insistuar se pse ke shkuar në S., por i ka treguar se D. i kishte thënë me e pritë në S., sepse baba pas vdekjes së A. kurrë nuk kishte fjetur në S., përveç G.. Tutje shton se, burri i saj e kishte dërguar në Prizren për mjaltë H., kurse lidhur me atë se një i afërt i saj i ka treguar se B. po planifikon me e vra babën tuaj (H.), por, nuk e di emrin, si person e njeh, por emrin mund ta di vëllai i saj G., e njëjta i kishte thënë disa herë babait të saj dhe më ka thënë se meqë jemi në hasmëri njerëzit flasin edhe të pavërteta, po as policinë nuk e ka informuar për këtë informatë, dhe për dyshimet se po donë me e vra babën, këto dyshime i ka pasur para vrasjes dhe e ka njoftuar babanë për këtë, por edhe familjarët tjerë e kanë njoftuar, por ai ishte përgjigjur, “Se e di vetë këtë punë”. D. kërkonte për të shkuar për ta ngushëlluar dhe në të njëjtën kohë e kërcënonte, në adresë të njëjtë, por pasi që nuk e ka pranuar për ngushëllime ai e kishte kërcënuar, duke i thënë së nëse zbulohet për vrasjen e B.t, e njëjta do të vritej, e po ashtu duke ju drejtuar më fjalët “ti je ka ma shkatërron jetën, ti je tradhtare, ti ke me jap përgjegjësi nëse unë dënohem nga organet e shtetit”, pasi që e njëjta i kishte shkruar se ti ma ke vra babën, ku i pandehuri i përgjigjet, duke i thënë “a je në tokë të bukës ti, si ta vras unë babën e shokut më të mirë”. Ndërsa lidhur me shprehjen e thënë nga e dëmtuara “O, jo, ti jo, por B. horin”, deklaroi se pasi e kryer dhënien e deklaratës në polici, D. i kishte shkruar, kush nga ju po më akuzon për vrasjen e babës së shokut më të mirë, dhe këtë shkrim ia ka dërguar policisë së krimeve dhe i kanë thënë thuaj: “se të kanë akuzuar motrat dhe nëna”, qëllimi ka qenë që ta largonte barrën nga vetja, lidhur me këto kërcënime të D, shkrimet të cilat i ka pasur ia ka dorëzuar policisë në Gjakovë, ndërsa passwordin (fjalëkalimin) e adresës me të cilën ka komunikuar në facebook nuk e ka ndryshuar asnjëherë. Po ashtu, D. kishte kërkuar që tokën që e babai i saj e ka në fshatin Q. ta ketë të lirë një muaj ditë, dhe pasi qëndroi një muaj aty tha: Këtu jam në rrezik nga policia, se munden të më kapin dhe për këtë kishte shkuar në S. atë natë*

dhe i kishte kërkuar çelësat për shtëpinë në S., pasi një muaj ka qëndruar në Q, por ka qëndruar edhe në S., sepse ky plan ka zgjatur rreth një vit, ndërsa një muaj para se të vritet baba, ishte plan i D. që ajo me burrin ta mendojnë se D. me babën tim janë prishur në pazar, kjo ka ndodhur një herë, por e vërteta është se asnjëherë nuk janë prishur, nuk e din nëse ndonjëherë babai i saj ta ketë shoqëruar me veturë D., por e di se kur babai i saj e ka pasur kontaktin e fundit me këtë personin nga Shqipëria, i ka thënë që ta qojë deri në Stacionin e Autobusëve në Gjakovë, dhe kur e ka dërguar deri në stacion babai është larguar dikund fshehurazi për ta parë se nëse po shkon me autobusë, ai u dal nga stacioni, ku kjo gjendje ka qenë dikund 2-3 javë para se të vritej babai dhe këtë informacion e ka siguruar nga prindi i saj.

2.b.2. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 10.01.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuarit G. A., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se: mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori, duke shtuar se babai i tij kishte shkuar për ta vizituar në burg tre ditë para se me u vra, dhe i kishte thënë se D. Gj. është ka don me e vra, dhe se e kishte lajmëruar rastin në polici se po e ndjek një kerr dhe i ka thënë se D. ka mem vra, se ai ka dhënë dorëheqjen me e vra B., pastaj është kthyer dhe kishte thënë se nuk po muj, e pastaj baba e ka ditur se D. është ka don me e vra, se D. u kon punëtor i B., babai i kishte treguar se D. ka hyrë në oborr të B. për këtë ja kishte treguar foton dhe ja kishte kap baba telefonin dhe ja ka gjuajtur në ujë.

*Përfaqësuesit i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, nuk ka parashtruar pyetje.*

*Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të dëmtuarës F. A., ka deklaruar se: është e vërtetë se ishte dënuar për B. A., lënda është bërë e plotfuqishme dhe D. i kishte thënë babës qoje djalin në burg, dhe është vetë dorëzuar në Dubravë, për shkak se D. ka pas me e vra B.n. Në shtëpinë në S. i kishin pasur katër qenë, dhe i kishte treguar se i ka helmuar D. Gj. qenët dhe kanë ngordh, ndërsa në vitin 2017 apo 2018, D. kishte shtënë me armë derisa i njëjti kishte qenë me djemtë e axhës I., A., D. A. dhe D.S., ndërsa babai i kishte thënë se D në vitin 2008 e kishte gjuajtur për ta vra edhe vëllain e tij tani të ndjerë A. A.n.*

*Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj, ka deklaruar se: kurrë më parë nuk e kishte njohur D. Gj., dhe nuk është takuar ndonjëherë me të, derisa ishte duke u shoqëruar me babain e tij, ndërsa dyshimi se D. mund të jetë kryerësi i vrasjes, ishte për shkak se i ndjeri A. A. e kishte pas marr D. me gjuajt në gjueti, dhe sipas shoqërisë së gjuetarëve, A. e kishte marr D. me qëllimin që t'ia nxjerr fjalët se kush e kishte shti për me e gjuajt A., edhe për atë arsye A. u vra, e për këtë arsye është vra vëllai pasi që, kur kishte shkuar në shtëpinë e A. i kishte thënë se gati e zbulova se kush e ka shti D. me më vra, pra, i kishte thënë se djali i yt i ka bërë këto, kurse kur kishte ndodhur gjuajtja ndaj të njëjtit nuk i kujtohet saktë, por kishte qenë muaji Mars i vitit 2017, ndërsa dëshmi se i pandehuri është kryerës i mundshëm i vrasjes së babait nuk ka, përpos dëshmitarëve që janë propozuar, pasi që babai e kishte ndjerë vetën të rrezikuar dhe një javë pa vdekë e kishte lajmëruar rastin në polici për D., duke e mohuar deklarinimin e dhënë në prokurori lidhur me faktin se nuk i dijë rrethanat e rastit, ndërsa D. nuk e njeh, pasi që nuk ka ndejtur me të dhe as që e ka njohur, i njëjti në deklarinimin e tij pohon se gjatë një gjykimi babai i tij publikisht është kërcënuar nga B. A..*

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të pandehurit, D. Gj. ka deklaruar se: a e mban në mend se është takuar me të pandehurin tek shtëpia e K., në oborr të tij, ku kishte qenë me djalin e M. G., ndërsa i pandehuri kishte qenë me A. M., nuk e mban në mend se atë ditë ja ka shëndosh kryet për vëllain e ndjerë, pasi deklaroi se të njëjtit kishin qenë duke dal, ndërsa i pandehuri me A. kishin qenë duke hyrë në dyert e shtëpisë, po ashtu deklaroi se nuk e mban në mend të ja ketë dhënë dorën. Se i ndjeri - vëllai i të dëmtuarit-dëshmitarit ka qenë në gjueti me D. i kishin thënë shokët që kanë dal me ta për gjueti, S. B., L. A., M. G. dhe D.-vëllai i Gj. P., ku thekson se ka edhe foto për këtë, dhe pohon se e di se është ngritur aktakuzë për të pandehurin pasi që i ka vra babën. Ndërsa lidhur me deklarin se i kishte thënë Gj. P., se D. ishte duke ndejt me B.n, kishte deklaruar se nuk dëshiron të përgjigjet në këtë pyetje, kurse shton se, vëllai i B. A. - S.e kishte thirr babën në telefon në Gjermani dhe sipas nënës dhe motrës i kishte thënë “*ruaju baca H. se janë ka dojin me të vra*”, B. me një të Shqipërisë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, ka deklaruar se: lidhur me deklarin të dëmtuarës F. A., motrës së tij, gjatë marrjes në pyetje, kishte thënë se G. e dinë emrin e personit i cili i kishte thënë babës se D. po don me e vra H.n, i njëjti e ka mohuar se e di emrin e personit në fjalë, ndërsa në deklarin e dhënë lidhur me pyetjen e anëtarit të trupit gjykues se ai person a bënë pjesë në rrethin tuaj familjar i njëjti kishte deklaruar se ai është vëllai i B. A.t, me emrin S. A., duke shtuar se kur kishte shkuar në burg për ta vizituar i kishte thënë se e ka jetën në rrezik, i njëjti nuk e kishte ndërmarr ndonjë veprim apo informuar oficerët korrektues se babai i tij e ka jetën në rrezik, pasi që vetë babai i tij, një javë pa vdekë e kishte lajmëruar policinë se e ka jetën në rrezik, me çka shton se nuk e dinte se D. kishte qëndruar një muaj në shtëpinë e tyre në S., kurse lidhur me faktin se baba i tij kishte dashur me e vra B., thekson se ishte njoftuar vetëm tre ditë para se me vdekë baba, ndërsa, para se të shkonte në burg nuk kishte pasur njohuri se babai e kishte planifikuar ta vras B.. Lidhur me atë se D. njihet me B. dhe se a i ka parë duke qëndruar diku bashkë, pohon se më parë nuk i kishte parë, por kishte dëgjuar prej të tjerëve – Gj. P., dhe dyshon se i njëjti ka hyrë në oborr të B.t ku i njëjti i ka 50 kamera dhe se D ka fjetur te Gj. P. tetë vjet, e po ashtu lidhur me rastin se D. e ka gjuajtur me armë kur kishte qenë me kushërinjtë e tij, e ka ditur që e ka gjuajtur dikush por jo me emër të tij, pasi që nuk ia kishte ditur emrin, si dhe në polici nuk e kishte paraqitur rastin me emër, pasi që nuk ja kishte ditur emrin, por pas vrasjes së babait e kishte parë fytyrën e tij. Tutje, ka deklaruar se ju kishte drejtuar organeve të shtetit, të njëjtit nuk janë marr fortë me atë punë, ku pas gjuajtjes ndaj tij nuk i kishte rënë me dëgjuar se D. po qëndron në Kosovë, nuk e kishte takuar ndonjëherë në rrugë, qytet apo kudo qoftë. Tutje, e mohon faktin se nuk është e vërtetë pohimi i dhënë në deklaratën e dhënë në Prokurori se kishte thënë që babai i kishte treguar se D. ia ka dhënë 10.000.00 Euro. Ndërsa në ballafaqimin e të dëmtuarit- dëshmitarit me pyetjen e prokurores së shtetit se a qëndroni pranë deklaratës së dhënë në polici dhe prokurori, fillimisht i njëjti ka deklaruar se qëndron pranë të njëjtave, ndërsa tutje e kishte mohuar një pjesë të deklaratës së dhënë në prokurori, duke theksuar se nuk ka thënë. Kurse para se të shkonte në burg nuk kishte pas informacion se H. ka qenë duke e planifikuar vrasjen e B.t nëpërmjet D. Gj., përveç tre ditë para vrasjes e ka kuptuar se D. po don me vra babanë e tij.

2.b.3. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 10.01.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari A. K., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga

ana e *prokurorit të shtetit* ka deklaruar se: i kujtohet çka ka deklaruar në prokurori dhe polici dhe mbetet pranë atyre deklaratave, për të shtuar se në momentin kur është vrarë H. A., ka qenë prezent dhe në momentin kritik ka qenë vetëm kur ka shkuar në S., rreth orës 08:00/h, kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së H., në fshatin S., ku e kishte thirr H., i njëjti kishte qenë në oborr pas shtëpisë së vet, i njëjti kishte ardhur, janë takuar në oborr, dhe kanë pasur për të shkuar në fshatin S., ose B., pasi që kishin për të blerë pastërm, dhe kur kanë dal prej oborrit, i njëjti kishte dal i pari, H. mbas tij, fillimisht ishin nisur kah kerri i tij, H. derisa e ka mbyll derën me qelës, i kishte bërë me shenjë duke i treguar si i kishte rregulluar kamerat, pasi që të njëjtat kanë qenë të prishura më herët, thekson se ia kishte gjetur mjeshtrin dhe dërguar për ti rregulluar kamerat, arsyen e prishjes së kamerave nuk e di, përveç se e din se kabllot të cilat kanë qenë nëpër oborr kanë qenë të këputura, por, kush e si i ka këputur nuk e din, ku në atë moment ishte ndier një zhurmë e madhe – eksplodim, i njëjti shton se nuk ka parë kurrgjë, ka pasur tym, dhe e kishte parë H. të shtrirë në tokë, kishte bërtit njëherë ose dy me emër duke e thirr H., H., nuk është përgjigjur, pastaj kishte shkuar tek shtëpitë e vëllezërve të tyre, kishte bërtitur shumë, i kishte thirr me emra djemtë e vëllezërve të H., të cilët kishin dal menjëherë të gjithë kush kishte qenë në shtëpi, dhe kishin ardhur tek vendi ku kishte qenë i shtrirë H., e në të cilin shpërthim ka pasur dhimbje të kokës dhe veshit të majtë, e po ashtu e ka pasur edhe një pjesë të vogël të metalit në kokë, por nuk është mjekuar për këtë lëndim. I njëjti e pohon faktin se e njeh D., e me të cilin ishte njoftuar në fund të vitit 2017, ku gjatë deklaramit ka pohuar se njëherë janë takuar në Shqipëri dhe disa herë në Kosovë, gjatë bisedave me të njëjtin D. kishte deklaruar se si pasion e ka gjuetinë, dhe punon si kasap ndërsa ushtrinë e ka të kryer si marinar. Me të njëjtin nëpërmjet rrjetit social Facebook, kishte komunikuar dhe i kishte shkruar në mesengjer, i kishte shkruar një mesazh, me kërkesë të H., duke i thënë se është dhëndër i H. A. t nga fsh. S., dhe deshti me bisedu H. me ty, në Facebook, kishte biseduar me adresën e quajtur E. Gj.j, i cili ishte këtu i akuzuari D. Gj., por atëherë e kishte njohur me emrin E., i njëjti nuk është përgjigjur, pas disa muajve kishte komunikuar me H., në atë periudhë kur kishte shkruar me të, sipas të pandehurit kishte qenë në burg nuk kishte mundur me i'u përgjigj H. i kishte kërkuar që të shkonte të takohen në fshatin . . . , para se të shkonin tek plazha e V., kjo kohë ka qenë në mes të muajit Dhjetor 2017 ose Janari i vitit 2018, përmes komunikimit nëpërmes Facebook-ut, kishin pasur edhe kontakte të drejtpërdrejtë fizike me të, në periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, ku kishin shkuar me H. A.n, në vendin ku ju kishte thënë E., kur kishin shkuar në atë kafe, iu kishte thënë se kishin ardhur me e taku T, K. ju kishte thënë që të presin, dhe i njëjti e ka lajmëruar T. ku kishte ardhur pas 5-6 minutave, atëherë ishin takuar dhe e kishin pirë nga një kafe, kjo kishte qenë hera e parë që ishin takuar me të, prej aty ishin ngritur dhe kishin shkuar tek një shtëpi, për të cilën ju kishte thënë se është shtëpia e tij, e kishin lënë veturën e H. në oborr të tij, ku e kishte thirr një person për të cilin E. e kishte prezantuar se ishte një mik, vjen dhe na dërgon deri me një restorant, të mos dalim me kerr të tij (E.), sepse është në arrest shtëpiak dhe ia njohin kerrin. Kishte ardhur miku i tij me veturën “. . .”, kishin hyrë në veturë dhe kishin shkuar tek një restorant, aty kanë drekuar, H. dhe E.. Para se me ardh dreka H. i kishte kërkuar që ta lirojë tavolinën, pasi që, kishte për të folur diçka me E.. Ata kanë biseduar rreth 20 - 30 minuta, derisa është përgatitur ushqimi, e pastaj ju është bashkangjitur, pasi që kishin ngrënë drekë, ishin kthyer prapë të shtëpia, për të cilin E. ju kishte thënë se është shtëpia e vet, kishin hyrë në oborr të tij, ku i dëmtuari - dëshmitari sqaron se ka ndejtur në oborr, këta të dytë kishin shkuar në një shtallë apo ahur, rreth 5-10 minuta kanë ndejt vetëm, përveç kësaj herë me D. janë takuar rreth 2 muaj pas rastit të parë, ku janë

takuar në dalje të autostradës në një lokal në Prizren, në drejtim të daljes së autostradës në drejtimin Prishtinë – Prizren, para se me hy në Prizren. Aty kishin hy në lokal, D. kishte qenë vet i dyti, ndërsa i njëjti kishte qenë më H., D. kishte ardh dhe kishin dal prej lokalit dhe kishin hyrë në kerrin e tyre, dhe kishin shkuar në një lokal, i cili është larg rreth 1 km, nga ura e L. në drejtim të fsh. . . ., aty H. dhe D. kanë hyrë në një restorant, i njëjti kishte qëndruar në veturë, ku edhe kishte pritur rreth 1/h, kanë hip në veturë prapë, që të tre, dhe kishin ardhur në Gjakovë tek banesa e H., H. i kishte kërkuar çelësat e shtëpisë të fshatit S., dhe ja kishte sjellur poshtë tek kerri, aty i dëmtuari-dëshmitari ishte përshëndetur me ta, ata kishin vazhduar me kerrin e H. dhe kishin shkuar në fsh. S., siç i kishte thënë H. Atë natë kishin qëndruar në fsh. S., të nesërmen H. e kishte dërguar deri në stacion të autobusëve, H. për këto takime me E. ose D. Gj. i kishte thënë se është shok i djalit të vet-A.. Po ashtu, sqaron se diku rreth një muaj pas takimit në Prizren, ishin takuar edhe njëherë me D. në Prishtinë. H. me D. ishin takuar në shtator të vitit 2018, në prezencën të dëshmitarit kishin biseduar ku kanë ardh deri te një punë që janë prishur në mes veti, i njëjti deklaroi se ky person ka pasur sipas H. me i ndihmu në një vrasje të cilën ka dashur me e krye H. ndërsa D. me i ndihmu, nuk e din nëse në bashkëkryerje apo si ka pasur me krye vet D. punën dhe pasi ta kryen punën kishte pasur me ja dhënë një shumë të parave, kurse përse janë prishur, apo pse nuk është kryer kjo punë nuk e din, por siç i ka treguar H., kjo punë ka pas që të kryhet me herët dhe për atë punë janë prishur, pos H., E. Gj., pra, D. Gj. se a ka pasur kontakte edhe me anëtarët tjerë të familjes së H., për kontakte fizike nuk është në dijeni, ndërsa, për mesazhe H. e kishte përdorur Facebook-un të cilin e ka kontrolluar edhe qika e H.-F. A., e cila është bashkëshortja e të dëmtuarit – dëshmitarit, ku kanë komunikuar për të organizuar takimet dhe po ashtu pas vdekjes së H., bashkëshortja e tij kishte kontaktuar nëpërmjet mesazheve, ku nëpërmjet këtyre mesazheve ka kërkuar sqarime pse akuzohet për vrasjen e H., kishte qenë periudha menjëherë pas vrasjes së H. Një natë para se të vritet H., F. e kishte parë një shkrim, në mëngjes ku D. kishte shkruar në mbrëmje se “a mundet H. dhe dhëndri me ardh me më taku. I njëjti deklaroi se eksplodimi ka ndodhur në shtëpinë e H. A.t, ku ka qenë i strehuar një kohë i pandehuri, edhe pse ka qenë dëshmitar okular në vendin e ngjarjes para, gjatë dhe menjëherë pas eksplodimit, por nuk ka parë ndonjë person.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: D. prej periudhës pas Qershorit deri në Shtator, në ditën që janë prishur në mes veti me H., e ka pas çelësin e shtëpisë kurse sa kohë ka qëndruar nuk e din, ku në atë shtëpi H. i kishte mbajtur qentë, në kohën derisa D. e ka pasur çelësin e shtëpisë, qentë kishin qenë te shtalla, për shkak të D. sepse e ka pasur të lirë që të shkon në shtëpi kur të don, kurse prej kohës që janë prishur deri tek vrasja ka kaluar rreth një muaj, përveç në shtëpinë në S., D. ka qëndruar në shtallën e H., të cilën e ka pasur në fshatin . . ., në dalje të Gjakovës dhe gjatë kësaj kohe kur ishin takuar, nuk e kishte shoqëruar ndonjë person tjetër D., në Dhjetor 2017-Janar 2018, kishte ardhur D. në Prizren, dhe ishin takuar, mirëpo nuk e din çfarë automjeti ka pasur, por kur ishin takuar në fsh. . . ., me D., aty ka qenë herën e parë me veturën . . e herën tjetër me veturën . . , ngjyrë hiri. Përveç këtyre rasteve thekson se është takuar edhe një herë, në hyrje të fsh. . . , atë natë kishte qenë vetëm, ja kishte dërguar një letër të cilën e kishte hapur dhe e kishte lexuar gjatë rrugës, pra e kishte ditur përmbajtjen e saj, e po ashtu D. kishte qenë vetëm kur ia kishte dorëzuar letrën, e që këtë letër e kishte shkruar vet, derisa H. i ka cituar fjalët, gjersa ishte duke folur në telefon, mirëpo në prezencë të njëjtit H. nuk ka biseduar me D. lidhur me

vrasjen e B.t, kurse kur e kishte pyetur H. se përse po takohej me D., i kishte thënë se po bisedonte lidhur me shitjen e një banese, i njëjti ka shtuar, se në rastin kur ia kishte dërguar letrën, e kishte kuptuar se këto takime kanë të bëjnë diçka me vrasje, e jo që i kishte thënë direkt, por në letër kishte qenë e shkruar “kujdes se veturën e B.te vozisin edhe familjarët”, H. nuk i ishte sqaruar lidhur me përmbajtjen e letrës duke i thënë se është punë për mua, ku kjo letër është shkruar 3-4 muaj para se me u vra H., ndërsa rreth 10 ditë, para se me u vra H., gjatë bisedës kishte thënë që është ka frikësohet që mundet me i ndodh diçka, dhe çfarë do që më ndodh vjen prej B. A., për shkak se D. e njihke vendin, shtëpinë, terrenin. H. i kishte dhënë para D., por jo në shuma të mëdha 50-100 Euro sa për rrugë. Në vitin 2017 prej B. A. kishte marr kërcënim, pas konfliktit që kishin pasur G. me B. në fsh. S., pasi që B. e kishte akuzuar se i kishte ndihmuar G., ku është gjykuar dhe shpallur i pafajshëm, gjatë kësaj periudhe e kishte thirr vëllain e tij A. K., ku ishin takuar në fsh. . . , B. i kishte kërkuar A. që ti thotë se çka kemi unë dhe H. në mes veti, mos të intereson ty, A. le ta bënë me be S. dhe mos të rrinë më me H., ndërsa pas vrasjes se H. nuk ka pasur ndonjë kërcënim.

*E dëmtuara F. A., nuk ka parashtruar pyetje.*

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar se: H. në orën 07:00/h, në mëngjes, e kishte thirr për me shku në . . . për me ble pastërm, personin të cilit kishin pasur për ti blerë viçin e njeh, quhet J. ndërsa numrin e telefonit nuk e di, nuk e din nëse H. ka biseduar edhe me dikënd tjetër për të shkuar në . . . , në atë mëngjes afër shtëpisë nuk kishte vërejtur ndonjë automjet apo diçka të dyshimtë të shtëpia në fsh. S., përveç një traktori i cili kishte qenë para se me shku te shtëpia e H., në drejtim të fshatit dhe kishte qenë në lëvizje, kurse në deklarinimin e dhënë në prokurori kishte deklaruar se kur ishte takuar me të ndjerin në . . . , H. i kishte thënë se po rrinë një automjet i dyshimtë, i cili kishte qenë në formë të kombit, për të cilin rast H. i kishte thënë se e ka lajmëruar rastin, ndërsa i dëmtuari - dëshmitari jo. Në mëngjesin e ditës tragjike kur kishin hyrë në shtëpi të H., nuk kishte vërejtur diçka në kutin e postës, nga shtëpia e H., nëse largohesh nga muri rrethues, rreth 100 m mund të shihet ndonjë pjesë e oborrit. Ndërsa sa i përketë ballafaqimit me pyetjen e prokurores se gjatë dhënies së dëshmisë në Gjakovë, se a e njihni personin D. Gj., është përgjigjur se nuk e njeh, i njëjti ka deklaruar se në atë periudhë nuk e kishte ditur emrin e tij të saktë e kishte njohur me emrin E.dashj, nuk i ishte prezantuar ndonjë foto, por, në deklaratën e dhënë në polici pas deklaratës së dhënë në prokurori, i ishin ofruar disa foto dhe aty e kishte identifikuar E., në ditën kritike se a ka qëndruar D. në Kosovë, pikërisht në Gjakovë, nuk kishte njohuri, pasi që atë ditë i kishte shkruar F. se a mundem me ju taku, ndërsa se nga rrjedh dyshimi që D., mund të jetë vrasës i të ndjerit H. A. nuk ka përgjigje, dhe se nuk kishte dëshmi tjetër se i pandehuri është kryes i mundshëm i vrasjes së H., thekson se siç ka deklaruar me lartë H. me këtë person ishte takuar për shitblerjen e një banese, në këto takime kishte qenë vetëm me H., por bisedën në mes të pandehurve nuk e kishte dëgjuar. I njëjti deklaroi se përveç mesazheve që kishte kërkuar sqarim se kush e ka iniciuar rastin, të njëjtin nuk e kishte kanosur askush, tutje thekson se nuk e din se ekziston ndonjë informator.

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: disa herë kishin qenë në V., për pushime dhe e njeh mirë qytetin, ndërsa kur kishte qenë për herë të

parë tek D., kishin qenë në një vend, ku e kishte prezantuar si shtëpinë e tij, me familje të ngushtë, në atë vend ku kishin qenë, miku i tij përdorte një telefon të thjeshtë dhe një telefon për rrjete, dhe kishte ditur të përdor mesengjerin, ndërsa me të kishte komunikuar përmes viber-it, personalisht nuk e ka pas numrin e telefonit të D, se D. ishte në burg, i njëjti i kishte thënë kur ishin takuar në V., mund të ketë qenë muaji Gusht ose Shtator. Që ti shkruajnë të njëjtit kishte qenë ideja e H., ndërsa E.-D. nuk e kishte njohur më përpara, për rrugëtimin nga Gjakova deri në V., ishte në rolin e shoferit por vetura kishte qenë e H., ndërsa arsyeja pse H. dëshironte të shkonte të takonte D. për shkak se ishte shok i djalit të tij, me të njëjtin kishin drekuar që të tre në restorantin në V., që ishte rreth 5 km larg restorantit nga shtëpia ku ishin takuar me D., dhe ku kjo drekë kishte zgjatuar rreth një orë, shënime rreth takimeve me D., nuk kishte, me arsyetimin se nuk e kishte parë të arsyeshme, sepse nuk ishte përgjigjur dhe e kishte shlyer atë tekst, ndërsa për herë të fundit me D. ishte takuar në shtator të vitit 2018, në fshatin . . . , ku kishte ardhur në këmbë, dhe kishte thënë se është duke qëndruar te pompa “. . .”, e cila është afër stallës. Nuk kishte dijeni se D. kishte kryer vjedhje banese. I njëjti deklaroi se nuk ka njohuri se në shtator 2018 nusja e tij është kërcënuar nga i pandehuri dhe nuk ishte në dijeni për këto kërcënime. Në ditën e ngjarjes është intervistuar në cilësi të dëshmitarit, ndërsa telefoni nuk i është sekuestruar nga ana e policisë, i njëjti dyshon tek D. për arsye se edhe më herët kishte qenë në vendngjarje, kishte pas qelësat e shtëpisë dhe askush nuk e ka njohur atë vend më shumë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës, e dëmtuara ka deklaruar se: gjithsej me D. kishte pasur pesë takime dhe nuk kishte parë ndonjëherë eksploziv, në shtëpinë e H., kur letrën e kishte shkruar, H. kishte qenë në Gjermani, kurse i dëmtuari- dëshmitari në Gjakovë, ndërsa e kishin përdorur aplikacionin viber, pas herës së parë që kishte shkruar me E.-D. ka qenë hera e fundit që kishte shkruar në Facebook të tij, po ashtu ka qenë në dijeni se bashkëshortja e tij ka komunikuar me E. nëpërmjet Facebook-ut, si para vrasjes ashtu edhe pas vrasjes, ku para rastit nuk i kishte lexuar mesazhet, ndërsa pas vrasjes së H. i kishte lexuar. I njëjti shton se është e vërtetë se B. i kishte qar fjalë nëpërmjet vëllait të A. që të mos shkoj më në S., por këto fjalë nuk i kishte respektuar dhe kishte vazhduar të shkoj në S., sepse i kishte thënë H.e ka mik dhe me të nuk kishte asgjë, B. nuk i ka rastis me e pa në fshatin S., por shton se, në qytet nuk është i sigurt nëse e ka takuar. Tutje sqaron se H. ishte prish me D. rreth një muaj para vrasjes, me pretekstin që kishte qenë çështja e afateve për kryerjen e vrasjes, por që mendon nuk kishte qenë vërtetë prishje e marrëveshjes por vetëm për tu dukur si prishje para të njëjtit, kurse H. para vrasjes, ndoshta një javë ditë kishte qëndruar në fshatin S..*

*2.b.4. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.02.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar G. B., me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se: i kujtohen kryesoret çfarë ka deklaruar dhe mbetet pranë deklaramit të dhënë në prokurori, D. e njeh që kur kishte ardhur në shtëpinë e tij në fshatin . . . , me A. A. për gjueti, që kishin me shiku zagar, ku kishte qenë prezent edhe babai i tij S. A., si dhe në Shqipëri e kishte vizituar D., së bashku me Gj. P., i fsh. . . , Komuna e Gjakovës, me një shok të vetin, nuk e dijë saktë kush kishte qenë kur e kishin ftuar për vizitë tek shtëpia e D., për ti parë qentë dhe delet që i kishte në shtëpinë e tij, ku përveç këtyre dy takimeve, nëpërmes telefonit ose llogarive në rrjetet sociale nuk kishte pasur kontakte me D. Gj. dhe as pas vdekjes se H. nuk kishte pasur kontakte me të pandehurin, shton se këtë të fundit nuk e kishte parë*

ndonjëherë në shoqëri me B. A. dhe pas këtyre dy takimeve nuk ka as njohuri se a ka qëndruar D. në Kosovë, ndërsa për herë të fundit D. e kishte parë pasi kishte vdekur A. A. por kohën, çfarë date kishte qenë nuk e di, e kishte takuar me një qebaptore “. . .” në Gjakovë, derisa ishte në pauzë të punës duke ngrënë drekë, e kishte përshëndetur D. i cili kishte qenë vetëm në lokal, pasi e ka kryer drekën kishte vazhduar dhe kishte dal prej lokalit, ndërsa i njëjti kishte qëndruar derisa e kishte kryer drekën. Po ashtu shton se gjatë kohës derisa D. kishte qenë duke ngrënë drekë, jashtë lokalit kishte qenë F. A. e cila është vajza e H. A. se çka ka bërë nuk e din, por i kishte rënë në sy se e njëjta ishte aty. Ndërsa në ballafaqimin e dëshmitarit me deklaratën e dhënë në prokurori me dt.28.09.2021, ku kishte deklaruar, se “D. e kishte pasur në fcb, nuk i kujtohet si është quajtur llogaria e tij në fcb, por, ....”, ndërsa në deklarin e thënë në shqyrtim gjyqësor kishte deklaruar se nuk e ka pasur D. në fcb, i njëjti ka sqaruar se nuk është i sigurt se si e ka thënë në prokurori, por edhe në gjykatë deklaroi se nuk e din a e ka pasur në Facebook, apo jo, por e din se me emër personal nuk e ka pasur.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: nuk i kujtohet afërsisht viti kur ishte njoftuar me D., duke shtuar se në prokurori kishte thënë se me të njëjtin është njoftuar diku në vitin 2014, por, këtë e kishte thënë pasi që nuk kishte qenë i sigurt për vitin, por, është bazuar në atë që i ka ofruar policia sa i përket kalimit të kufirit së bashku me D, tek shtëpia e D i kujtohet se kishte qëndruar një natë, ndërsa kishin fjetur tek një shok i D, kurse tek shtëpia e D nuk kishte fjetur ndonjë natë. Në ballafaqimin e deklaratës së dhënë në prokurori se “kishin shkuar në V., kishin qëndruar një natë në shtëpinë e D”, i njëjti deklaroi se e vërteta është se kishte fjetur tek një shok i D, e jo në shtëpinë e D, por që nuk e din personin, ja kishte harruar emrin, ndërsa vendi kishte qenë në rrethinë të V., por nuk e din saktë se ku. Nuk e di se gjatë kohës që kanë qëndruar me D, a e kanë quajtur D me ndonjë pseudonim apo emër dhe nuk i kujtohet saktë se si është dukur shtëpia e D. Gj., pasi që ishte i koncentruar për ti shkuar qentë dhe delet të cilat i kishte në oborrin e tij, me sa i kujtohet shtëpia kishte qenë një kat e gjysmë apo dy nuk është i sigurt dhe nga shtëpia e D. nuk ka mundur të vërehet deti.

*Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të dëmtuarit A. K.*, ka deklaruar se: nuk e din, e as nuk i kujtohet se ku ka jetuar H. A. në Gjakovë, ku e ka pasur banesën.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar se: me D. Gj. e ka njoftuar A. A., raportet me D. kishin qenë të mira, ku kishin biseda të gjuetisë dhe të qenve, dhe dallimi në mes të asaj me e pas dikënd në facebook, friends, dhe me komunikua në fcb, sqaron se e di që dallimin por në fcb kishte pasur shumë frends, ndërsa, nuk e din nëse ka pasur ndonjë facebook me emër apo llogo të gjuetisë, por me emrin D. nuk kishte pasur shokë-friends.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: i kujtohet se kur D. kishte shkuar në shtëpinë e tij për herë të parë dhe kur i kishte thënë të njëjtit mos u merr me zagar se nuk ka gjë prej zagave.



*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: babai i tij e ka H. A. djalë të hallës, dhe i njëjti kishte marr pjesë në varrimin e A. dhe H. A., nuk i kujtohet nëse D. ka marr pjesë në varrimin e A. A., në shtëpinë e D. kur kishte qenë mysafirë ka pasur edhe persona tjerë, ku njëri ka qenë i Kosovës, ndërsa të tjerët kanë qenë të Shqipërisë. D. shtëpinë e ka pasur në një pjesë pa dal tek plazhi, në krahun e djathtë të rrugës, para se të shkohet tek plazha. E ka pasur një veturë mercedes, model i vjetër, në rastin kur e ka parë në qebaptoresh “ . . .”, kurse me F. a kanë komunikuar diçka mes veti nuk e din, pasi ka qenë duke drekuar dhe nuk ka pasur ndonjë koncentrim për ta shikuar se a kanë komunikuar apo jo, e cila kishte qenë edhe hera e fundit që e ka takuar D. ndërsa viti nuk i kujtohet por ka qenë pas vdekjes së A. A.t, por viti nuk i kujtohet saktë.

2.b.5. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.02.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar S. B., me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se: me siguri i kujtohet çfarë ka deklaruar në prokurori dhe mbetet pranë asaj deklarate, dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, ka deklaruar se: e ka njohur D. Gj., përmes të ndjerit A. A. pasi që, merret me gjueti edhe D. është marr me gjueti, viti apo koha kur janë njohur nuk i kujtohet, kontakt për herë të fundit me D. Gj., kishte pasur shumë kohë para se me u vra i ndjeri H. A., ndërsa pas vdekjes së A. A.t nuk i kujtohet që ka pasur kontakt me D, kurse në vizitë te D. në Shqipëri, kishte qenë pasi që kishin shkuar, kishin fjetur aty dhe kishin dal në gjueti, ku ishin së bashku L. A. dhe N.P.. Po ashtu shton se e njeh B. A. por kurrë nuk e ka parë në shoqëri me D. Gj., në varrimin e A. A.t kishte marr pjesë por nuk e dijë a ka mundur ta vërej se a ka qenë D. Gj. në varrim, duke shtuar se nuk i kujtohet nëse me të njëjtin ka pasur kontakt, pasi që, ishin prishur kur kishin shkuar tek një shok në Istog, për ti shikuar zagarët dhe prej atij momenti më nuk kishin pasur kontakte.

*I dëmtuari A. K.*, nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj, ka deklaruar se: me D. kishte pasur raporte të gjuetisë, dhe në atë kohë ka qenë kontakti me telefon, por nuk i kujtohet numri i telefonit të D, e kishte parë disa herë, pasi që në gjueti kishin dal së bashku, me të ndjerin H. A. ka pasur raporte familjare por që i njëjti nuk i ka thënë ndonjëherë se e njeh personin me emrin D. Gj..

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të pandehurit, D. Gj. ka deklaruar se: nuk ka dijeni se kishte pasur ndonjë keqkuptim me A. derisa i njëjti ka qenë gjallë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: gjatë udhëtimit për në Istog me D., A. A. nuk kishte qenë në Istog, dhe meqenëse kishte qenë në shtëpinë e D., i kishte treguar se është marr me bujqësi, me dele.

2.b.6. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.02.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar L. A., me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e

*prokurorit të shtetit* ka deklaruar se: nuk i kujtohet çfarë ka deklaruar në prokurori, e njeh D. Gj. kur kishte shkuar në lokal me A. prej S. dhe N.P., por data dhe viti nuk i kujtohet, se në cilin lokal në . . . apo . . . , se kanë ndenjur në këto dy lokale. A. është prej . . . , e ka pasur mbiemrin A. dhe të njëjtin e kishte pasur shok, me D. ishin takuar edhe në Shqipëri, ku kishin qenë te shtëpia e tij, si mysafirë dhe kishin dal për gjueti, së bashku me S. B.n dhe N.P., ku me aq sa i kujtohet N. e kishte lënë për të shkuar me gjuajt, i kishte thënë a po vjen dhe kishin shkuar. Me D. kishte kontaktuar përmes Facebook-ut, duke sqaruar se sigurisht përpara vdekjes së H., por pas vrasjes së H., D. e kishte thirr një herë në fcb, - mesengjer dhe kanë folur me zë, ku D. e kishte kërkuar numrin e I. A., i cili është vëllai i H. A., i kishte thënë nuk e kam, shikoj dhe ta gjejë, i njëjti më nuk e kishte thirr e as ky i fundit nuk ia kishte gjetur numrin, por sigurt nuk e dinte a i ka treguar arsyen apo jo pse i duhet numri i telefonit të I., nuk e din a ka qenë D. në Kosovë, më vonë pasi ishin takuar së bashku dhe në kohën kur kishte qenë i gjallë H. A.. Pas ballafaqimit nga ana e prokurores se në pyetjen në fq.5 të procesverbalit në përgjigjen tuaj në pyetjen e 5, në atë faqe se a keni kontaktuar ju personalisht me D. përmes telefonit apo rrjeteve sociale, ndër të tjera keni theksuar se: “kjo bisedë ka ndodhur pasi që është vrarë H. A., unë i tregova D. se nuk e kam numrin e I. A., i kujtohet se D. i kishte thënë që numri i telefonit të I. i duhet për të biseduar me të, pasi që policia e Shqipërisë i kishte parashtruar pyetje lidhur me vrasjen e H. A., ndërsa në shqyrtim gjyqësor në pyetjen e parashtruar lidhur me arsyen e kërkesës së D. për këtë numër të telefonit deklaruar se keni qenë i përgjumshëm dhe nuk iu kujtohet, i njëjti ka deklaruar se ajo që ka deklaruar në Prokurori është e saktë, sepse kur ju lexua deklarata i kujtohet.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: nuk e di sigurt me çfarë emri ka kontaktuar D. Gj., por i duket se e ka pasur . . . , duke shtuar se ka komunikuar vetëm me këtë adresë, por, i njëjti ka mundur ndoshta edhe me e ndërruar emrin, mirëpo, biseda është e njëjtë, viti kur kanë qenë në Shqipëri për të fjetur në shtëpinë e D., nuk i kujtohet, por vetëm i kujtohet se kanë dal në foto, nuk i kujtohet kur ishin për herë të fundit fizikisht me të dhe nuk i kujtohet a ka pasur automjet D.

*I dëmtuari A. K.*, nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar se: raportet e tij me D. kanë qenë të mira dhe kishin mbajtur kontakte me anë të Facebook, ku kishin shkuar për gjueti, ndërsa se a ka qëndruar D. në Kosovë, nuk e din.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: ditën që kishin qenë në gjueti, ka pasur edhe disa djem të tjerë dhe të njëjtit i kishin takuar në bjeshkë, me sa i kujtohet edhe dy të tjerë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: një herë kanë qenë tek D. për gjueti, ku armët për gjueti i ka siguruar D, ndonjë armë karakteristike nuk ka pasur, ka pasur automat dhe pushkë gjuetie. Në shtëpinë e D. kishin qenë dëshmitari S. B. dhe N. P., shtëpia e tij ka qenë shtëpi njëkatëshe, oborr ka pasur bukur shumë, e din se ka qenë diku kah . . . , por ka sqaruar se edhe sot me shku nuk mundet me e gjetë sepse nuk e ka drejtuar automjetin, e po ashtu e di se prej shtëpisë së D. nuk ka mundur me e pa detin, se çka ka punuar përveç bujqësisë nuk e di me arsyetimin se nuk ka pasur bisedë më shumë dhe nuk e di se a është takuar ndonjëherë D. me B. A..

2.b.7. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023, në cilësi të dëshmitares është dëgjuar F. A. P., me ç'rast e njëjta duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se: i kujtohet çka ka deklaruar në prokurori dhe mbetet pranë asaj deklaratë.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, ka deklaruar se: i kujtohet kontakti i fundit kur e kishte pasur me të ndjerin H. A.n, kishte qenë një javë para se me ardhëbabi në Kosovë, saktësisht datën nuk e di, por, me sa e di kishte qenë fundi i muajit Shtator dhe fillimi i muajit Tetor, dhe nga kontakti i fundit me prindin, por nuk i kujtohet saktë por rreth dy javë pasi është vrarë. Gjatë kohës kur babai i saj ishte në Gjermani ka banuar tek dëshmitarja, gjatë kohës para se të vritej, ka qenë i shqetësuar gjithmonë, se ka me e vra B., probleme nuk kishte pasur me askënd tjetër, dhe gjithmonë e kishte thënë se vetëm me pagesë ka me e bë vrasjen. E njëjta ka deklaruar se D. Gj. nuk e njeh.

I dëmtuari A. K., nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të dëmtuarit G. A., ka deklaruar se: babën pak para se me u vra e kishte thirr në telefon vëllai i B.t, S. A., i cili jeton në Gjermani, në telefonin e dëshmitares, dhe i kishte thënë babin se B. po don me të vra me pagesë, e ka përmendur një emër, emrin e të cilit nuk e kishte mbajtur në mend në ato momente, por, pastaj, kur e kishte dëgjuar emrin E., e ka ditur se ky emër është përmendur. Tutje shton se, babai para se me u vra kishte qenë i shqetësuar dhe kishte thënë se B. ka me më vra me pagesë.

E dëmtuara H.A., nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj, ka deklaruar se: kurrë nuk kishte kontaktuar me D. përmes telefonit apo Facebook-ut.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të pandehurit, D. Gj. ka deklaruar se: nuk do të përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga i pandehuri dhe me arsyetimin se e ka dhënë deklaratën e saj dhe qëndron pranë saj, si dhe nuk dëshiron t'u përgjigjet pyetjeve tjera.

Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës, dëshmitarja ka deklaruar se: nuk i kujtohet saktësisht por ndoshta ka qenë rreth 1-2 muaj para vrasjes së babait të saj, kur vëllai i B.t, S, e kishte telefonuar në Gjermani, dhe i kishte thënë "ruaju se B. po don me të vra me pare", dhe se personi për të cilin kishte thënë S. do ta kryej vrasjen me pagesë e ka emrin E, e ka kuptuar pas vdekjes se babait të saj, por sqaron se me njoft nuk e njeh dhe nuk i kujtohet se në deklaratën e dhënë në prokurori ta ketë përmendur emrin e E-D. Tutje ka shtuar se prindi i saj nuk e ka njoftuar asnjëherë se është në bashkëbisedim me një person për ta kryer vrasjen e B., por vetëm ka qenë i brengosur se B. ka me e vra.

2.b.8. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023, në cilësi të dëshmitares është dëgjuar L. LL., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e

*mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj* ka deklaruar se: D. Gj. e njuh në V., djali i saj 13 vjeç ka punuar në V. tek D., me datën 14.10.2018, D e kishte takuar në Shkodër tek ura e “. . .”, lokali ku ka punuar si sanitare, në ora 08:43/h, ose nëntë pa një qerek, të cilin e kishte takuar pasi që kishte biseduar në telefon nga numri i sajim . . . , numri i D. komplet, por aq sa e mban në mend në fund e kishte 280 dhe i njëjti kishte ardhur për të bërë pagesën e punës së djalit të saj, sepse ishte në moshë të re dhe kishte hallin e pagesës, ku kishin qëndruar rreth një orë te lokali me D, e pastaj, i njëjti ishte nisur në drejtim të Malësisë së Madhe, për të marr dërrasa për të rregulluar lokalin në V..

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: nuk i kujtohet nëse të njëjtin e kishte takuar edhe një ditë përpara dhe a ka qenë paradite apo pasdite, por shton se mund të jenë takuar sepse tanimë janë 5 vite nga ajo kohë, e mban mend se e ka pyetur për emrin e një fshati në Dukagjin, i kishte thënë për në Malësi të Madhe, sepse ka pasur me marr materialin, ku komuna e Dukagjinit është . . . , . . . , ndërsa, kjo tjetra është në Malësi të Madhe (baza materiale), e di se ku ndodhet fshati Nën . . . , sipër urës së . . . , ndërsa lagjja Bregu i Lumit, është qendra e aty është edhe shkolla, në fshatin Nën . . . ka gështenja, ditën kur ishin takuar tek lokali në Shkodër djali i saj kishte shkuar me D., ku rreth orës 10:00/h, ishin nisur nga lokali bashkë me djalin për të shkuar për material, ndërsa, ishin kthyer rreth 2-3 të pasdites dhe atë ditë D. kishte makinë . . . , me ngjyrë të kaltër të mbyllët, gati e errët.

Duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *prokurorit të shtetit* ka deklaruar se: është e vërtetë se me D. ishin takuar lidhur me marrjen e pagës së punës të djalit të saj të mitur i cili ka punuar në lokalin e D., 7 ditë të javës sepse kishin qenë pushimet verore e mandej kishin ardhur ditët e shkollës, ku në shtator fillon sezoni i shkollës në Shqipëri por që ka vite që ndryshojnë datat, duke pohuar se është e vërtetë se me D. ishte takuar me dt.14.Tetor 2018, por nuk i kujtohet cila ditë e javës ka qenë, por që ka qenë fundjavë, ku data i kujtohet pasi ka qenë dy ditë para datës së aksidentit të djalit.

*Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, nuk ka parashtruar pyetje.

*I dëmtuari A. K.*, nuk ka parashtruar pyetje.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitarja ka deklaruar se: djali te D. kishte punuar banakier dhe pica men, në lokalin i cili ishte në qendër të V.s, tek Lulishtja, ndërsa D. në Malësi kishte shkuar për me marr material për lokal, për të rinovuar lokalin dhe për të shti gjëra të reja në lokal, përveç punës në lokal D. në shtëpi të vet ka mbajtur dele, pula, atë ditë e njëjtë deklaroi se kishte qenë në punë tek lokali i cili kishte qenë e punësuar çdo ditë të javës “. . .”, ndërsa dyqanet e materialeve ndërtimore punojnë të dielave sepse i sheh me sy pasi që 27 vite jeton në Shkodër, si dhe në . . . i ka parë dyqanet nëse shkon.

2.b.9. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar *L. Sh.*, me ç’rast i njëjti duke i’u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj* ka deklaruar se: në bazë të tabulatit kishte folur me D. në ora 06:30/h të mëngjesit, ditë e Diele, për çështje pune e kishte marr në telefon me dal

në punë për atë ditë, por i njëjti i kishte thënë se ditën e Diele nuk punoi, përjashtim të shoqërisë në marrëdhënien e punës. Tutje ka shtuar se e kishte fikur telefonin me të, por i njëjti i kishte shkuar tek shtëpia, pas 20-30 minutave pasi që ishin në të njëjtin fshat, erdhi dhe i kishte thënë se do të dalë sot në punë, për me e ofruar një banak, me e marr një dërrasë me e krye një banak, ndërsa, ai i kishte thënë se do të dal deri në Shkodër për punë të kësaj dërrase.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: emrat e fshatrave të V.s, prej . . . e deri në breg të detit, fjala është për rrugën kryesore, janë fshati i parë . . . , i dyti . . . , i tretë është . . . , e katërta . . . , e pesta është . . . , e gjashta është . . . , e shtata . . . , e teta . . . , ndërsa tek lokali i D. i cili quhej “. . .”, ka dhomë gjumi tek lokali, ku banaku i këtij lokali është i gjatë rreth 4 metra e diçka, ndërsa trashësia e dërrasës është 20 cm dhe aty kishte punuar edhe vëllai i dëshmitarit kishte kryer punë të ndryshme, si me hidraulik, mure, me dërrasa pra kishin punuar punë të përgjithshme, në çatinë e lokalit kishin vendosur dërrasat dhe kalldrëmet, ashtu që nga çatia shihet deti dhe është larg diku rreth 100-150 m, ngjitur lokalit ka parking dhe ballë për ballë lokalit është komuna e V.s, po ashtu, aty afër ka treg frutash ku nëna e të njëjtit kishte punuar, dëshmitari shton se gjatë vitit 2019-2020 e kishte dërguar nënën tek tregu, ku thotë se gjithmonë e kishte parë D. duke punuar tek lokali të cilin lokal e mirëmban personalisht. Para se të punon tek lokali i D. fillimisht kishte punuar tek babai i D. me dele, i cili jeton në fshatin . . . , në vitin 2016 rreth 4 muaj. I njëjti ka deklaruar se ditën kur D. kishte shkuar tek shtëpia e tij, kishte ardhur me makinë “. . .” forestrad jeshile, ku dëshmitari së bashku me vëllezërit e tij kishin qenë duke punuar në fshatin . . . , tek E. T., kurse gjatë vitit 2016 ka pasur . . . të verdhë, Tutje ka shtuar se, pas deklaratës së dhënë në Shkodër, nuk i kishte ardhur ndonjë fletëthirrje nga Prokuroria e Prizrenit, numrin e telefonit e kishte ndërruar një vit pasi e kishte dhënë deklaratën noteriale e të cilin numër gjatë vitit 2018 e mban mend se si e kishte . . . D. kopshtin me një kontejner e kishte tek lagjja . . . , V. dhe gjatë kohës sa D. kishte qenë në burg, dëshmitari kishte shkuar dhe kishte futur brenda koshere bletësh.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *prokurorit të shtetit* ka deklaruar se: me D. ka raporte pune, dhe po ashtu kishte qenë në Kosovë, ku e mban mend se një herë kishte qenë por kishte qenë shumë kohë përpara, në vitin 2016, në Prizren dhe kishte kaluar në Tropojë ku edhe i ka dajat pra, pra ka kaluar transit.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: D. e kishte thirrur ditën e Diele për të punuar tek ai në lokal, por nuk e mban në mend se për cilën ditë, muaj, dhe vit bëhet fjalë, sepse ka vite, ndërsa në vitin 2018 nuk kishte qenë në Kosovë.

*I dëmtuari A. K.*, nuk ka parashtruar pyetje.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të dëmtuarës F. A.*, ka deklaruar se: kishte punuar në plazh – qadra dhe në vitin 2018 nuk kishte qenë në Gjakovë.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: ditën kur e kishte ftuar D. kishte shkuar dhe kishte punuar deri në ora 3 pasdite, por më sa i duket nuk ishte kthyer .D në lokal, L. LL. nuk e njeh, djalin e saj e njeh por nuk ja di emrin, veçse e di se ka punuar tek D. në

lokal, atë ditë kur kishte shkuar në lokal kishte qenë duke filluar sezoni, nuk i kujtohet nëse djali i L. kishte qenë aty. Numri i telefonit të D. i kujtohet i cili është . . . , por nuk i kujtohet se prej cilit vit e posedon këtë numër dhe as nuk e di nëse ka pasur numër tjetër përpos këtij numri.

2.b.10. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar P. B., me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj ka deklaruar se: në Tetor të vitit 2018 e kishte takuar D tek shtëpia e tij, i cili kishte ardhur me “. . .” foristradë, me ngjyrë jeshile dhe ka marrë dërrasa gështenje për një banak, por i kishte thënë se i duhen të thata, një ditë përpara e kishte marrë në telefon D. dhe e kishte pyetur për dërrasa, i njëjti i kishte thënë se nëse nuk mund ti gjesh, eja merri te unë se më kishin tepruar prej shtëpisë, po ashtu i njëjti i kishte thënë se është duke shkuar për ti kërkuar dërrasat në fshatin . . . , po nuk i gjeta a mund të vijë ti marr tek ti.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e të pandehurit, D. Gj., ka deklaruar se: fshati ku i ka miqtë D. quhet . . . , para se me ardh me marr dërrasa, një ditë përpara e kishte marrë në telefon dhe e kishte pyetur se ku është, i kishte thënë “se jam te magazina” , e pastaj ishin takuar. Në ditën përpara kur ishin takuar kishte qenë rreth mesditës, sa ishte duke punuar tek magazina, ku D. kishte shkuar vet i dyti, por emrin e personit të dytë nuk e mban mend, ndërsa personit të cilit ja ka blerë makinën quhet G., i njëjti person është edhe ai i cili ka qenë ditën e parë tek i njëjti dhe ditën kur kishte marr D. dërrasa kishte qenë mëngjes, nuk i kujtohet sa dërrasa gështenje i kishte marr por i kishte thënë se më mjaftojnë për banak, të cilat të gjera kanë qenë 30-50 cm, ndërsa të trasha rreth 10cm, kurse të gjatë kanë qenë rreth 3m., përveç këtyre dërrasave të gështenjës, nuk i kujtohet edhe çfarë materiali tjetër kishte marrë, por e din se kur e kishte bërë shtëpinë i kishin mbetur materiale, por për dërrasat e gështenjës e di sepse ato i kishte kërkuar me ngulm, a po ashtu atë ditë kishte pasur njerëz për vizitë se e kishte nënën të sëmur, dhe ka qenë ditë e Diele, pasi që, ditën e premte nëna e tij kishte pësuar infarkt. Andaj, për këtë arsye e mban në mend, tutje shton se dërrasat e gështenjës i ka pasur atë ditë te shtëpia dhe në magazinë, me sa ka njohuri dërrasat i kishte marr tek shtëpia, e kishte lënë duke u marr me fëmijët e tij sepse i njëjti kishte njerëz në vizitë, ku D. kishte kërkuar vetëm njëherë dërrasa gështenje, pas marrjes së dërrasave kishte qenë njëherë tek lokali i D., i cili është afër 250-300 m larg detit, e që është afër . . . tek lulishtja. Nuk i kujtohet se kush ka qenë me të në Spitalin e Shkodrës kur kishte shkuar për ta vizituar D., por e di se kishte qëndruar dy javë në Spital, dhe kishte shkuar së bashku me F., F. dhe kanë qëndruar rreth 2-3 orë, ku kishte qenë 2-3 herë në vizitë, por e kishte vizituar natën se ditën nuk kishte pasur kohë që të shkonte, ndërsa te dhoma në spital kanë qenë dy policë, njëri prej tyre e ka pasur emrin S. dhe për periudhën dy javore sa herë ka shkuar në vizitë D. nuk e ka gjetur vetëm. Në shtëpinë e D. kishte shkuar disa herë, por një herë me disa njerëz prej Kosove, të cilët më parë kishin punuar me një vendas të tyre, dhe ai iu kishte mbetur borxh, atyre e të njëjtit mu ankuan mua, dhe unë iu thash se e njoh një mik i tyre dhe ndoshta mund t' iu ndihmojë. I njëjti deklaroi se nuk ka marrë ndonjë fletëthirrje nga Prokuroria Themelore në Prizren dhe ditën kur kishte dhënë deklaratën në Shkodër e ka dhënë adresën e saktë, sepse deklaratën e kishte dhënë me kartë identiteti dhe nuk e ka ndërruar adresën e banimit.

*Prokurorja e shtetit, nuk ka parashtruar pyetje.*

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: në Tetor të vitit 2018, D. kishte qenë te shtëpia e tij për ti marr dërrasat, ku me dt.12.Tetor 2018 nënës i kishte rënë infarkt, e kjo ka qenë dy ditë pas, që i bie të jetë dt.14 Tetor 2018. D kishte shkuar paradite por ora nuk i kujtohet sepse ishte ditë e Diele, nuk kishte ndonjë plan për me e këqyr orën por e din se ka qenë mëngjes, duke shtuar se është e saktë se nënën e kishte pasur të sëmurë dhe këtë mund ta vërtetojë edhe me letra të mjekut sepse kishte probleme me të që nga ajo ditë, ku sqaron se nënën e kishte dërguar të Klinika e cila ishte te Komuna, e kanë mbajtur atë ditë dhe e kishte marr pas mesnate, kurse përveç datës kur ka marr i akuzuari dërrasa, i akuzuari kishte marr edhe drunjë për nxehje-ngrohje.

*Të dëmtuarit A. K. dhe F. A.*, nuk kanë parashtruar pyetje.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: kur i akuzuari kishte shkuar me i marr dërrasat në shtëpi, kishte qenë vet i dyti, por, ka qenë i moshës së mesme, në lokal të D. nuk e ka parë sepse ka deklaruar se nuk shkon shpesh nëpër lokale. D. dërrasat e gështenjës i kishte marr në vjeshtë por koha kur kishte qenë i shtruar D. në spital nuk i kujtohet.

*2.b.11. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 13.03.2023, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar G. S.*, me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj* ka deklaruar se: nuk i kujtohet në cilin vit, as në cilin muaj kishte shkuar D. tek ai, por e di se i ka qarë dërrasat në sharrën e tij, për këto dërrasa kontaktin me të e kishte bërë një P. P. që jeton afër tij dhe përmes P., e së bashku me të D. kishin shkuar tek i njëjti, për të qarë dërrasat me arsyetimin se i duhen për lokal dhe D. kishte shkuar tek ai me makinën “. . .” foristradë.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *të pandehurit, D. Gj.* ka deklaruar se: P. e njeh që disa vite por nuk e di se sa, pasi që janë afër dhe nëse i kërkon gjykata mundet me kontaktua me P. me anë të Skype, e di, se dërrasat të cilat i kishte sjellë tek i njëjti, kishin qenë rreth një kubik dërrasa apo një e gjysmë, nuk e mban mend fiks, e nuk e din as llojin, sepse ka kaluar një kohë e gjatë, vendi i punës dhe shtëpia nuk kanë qenë edhe as sot nuk ka kamera, por i kujtohet se pas ditës që i ka qarë dërrasat P. ka biseduar me të, lidhur me kamerat, por i kishte thënë se nuk ka, por numrin e telefonit të P. nuk e ka të regjistruar por vetëm nëse ka mbetur ndonjë thirrje që ka bërë ai.

*Prokurori i shtetit*, nuk ka parashtruar pyetje.

*Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, dhe të dëmtuarit *A. K. dhe F. A.*, nuk kanë parashtruar pyetje.

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës*, dëshmitari ka deklaruar se: kur ka punon çdo ditë, kurse kur kishte shkuar D., ka qenë fundjavë por dita nuk i kujtohet dhe e di se ka qenë paradite, pasi i kishte lënë dërrasat aty, i njëjti ja kishte qarë dërrasat dhe ai i kishte marr po atë ditë, ku D. kishte shkuar me P. P., nuk i kujtohet çfarë dimensione kanë pasur dërrasat që kishte qarë atë

ditë, me arsyetimin se dërrasa qajnë përditë dhe nuk e mban në mend, kanë qenë lëndë, të qara me motor sharrë, të njëjtit ia ka qarë dhe ia ka bërë dërrasë.

2.b.12. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.06.2023, gjykata së bashku me palët në procedurë, ka dal në vend të ngjarjes dhe është bërë konstruksioni i vendit të ngjarjes, me ç'rast është dëgjuar edhe *zyrtari i krim teknikës*, me ç'rast i njëjti duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar se: pas ofrimit për shikim të skicës së përgjithshme të vendit të ngjarjes, sqaron se matja është bërë në formën e metrit të shtrirë ku skaji i djathtë ka qenë pika A, skaji i majtë ka qenë pika B e objektit B, ndërsa pika X është katër metra larg pikës A, që i bjen në perimetrin e skajshëm të rrugës. Dhe të gjitha matjet pastaj janë bërë në mënyrë koordinatave duke marrë për bazë vijën bazë dhe pastaj duke vazhduar me matjen e dëshmimeve nga vija bazë, për të ditur distancën nga prova 45 (detonatori) deri te kutia postare, këto lloj matjesh i kanë bërë në formë koordinative dhe matja është bërë nga vija bazë e nuk është bërë nga shenja numër 45 e deri tek kutia postare. Pas matjes se bërë me metër nga ana e ekspertit, distanca nga numri 45 deri tek kutia postare (Nr.58) është 3 metra e 70 cm, në bazë të foto dokumentacionit shihet që edhe gjendja e rrugës prej rrugës kryesore ndahet për tek shtëpia dhe vendi ku ka ndodhur incidenti ka qenë zhavorr. Detonatori nr. 45 i evidentuar si remote kontroll e ka aktivizuar eksploziven e vendosur në kutinë postare, ku në bazë të vendit të ngjarjes ku ka ndodhur shpërthimi dyshohet se ka qenë materie eksplozive TNT, i cili inicohet me detonator elektrik ose mekanik, pavarësisht, por duhet të jetë detonator për të cilin në këtë rast dyshohet se ka qenë detonator elektrik, pasi e kishin lehtë me identifikuar për shkak se i ka telat e cila i duhet një energjie elektrike për ta iniciuar, duke sqaruar se në rastin në fjalë bomba nuk përbehet veç prej eksplozivit dhe detonatorit por ka pasur edhe një pajisje që pranon frekuenca të caktuara që i shtin në veprim dhe ajo pajisje e liron një energji elektrike e cila e inicon detonatorin dhe detonatori e aktivizon eksplozivin, ku distanca e këtij aktivizuesi të detonatorit, në bazë të hulumtimeve për pranuesin e frekuencave apo marrësin del të jetë deri në një kilometër.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *prokurorit të shtetit* ka deklaruar se: nuk ka pas mbetje të detonatorit dhe nuk mund të konstatohet se kush ka qenë prodhues i këtij detonatori, sepse detonatori pas shpërthimit dëmtohet dhe nuk kanë mundur të bëjnë identifikimin. Po ashtu prokurorja e shtetit i kishte propozuar gjykatës që i dëmtuari t'i përshkruaj lëvizjet e tij nga momenti kur kishte dal nga dera e oborrit e deri në momentin e shpërthimit, ashtu që i dëmtuari A. K. me veprime konkludente i ka përshkruar të gjitha lëvizjet të cilat i ka bërë ditën kritike, nga momenti që ka dal nga dera hyrëse (oborrit), ku ka qenë në momentin kur ka ndodhur eksplozimi, si dhe çka ka vepruar pastaj, ku për këto lëvizje të dëmtuarit- dëshmitarit A. K. gjykata i ka njoftuar të pranishmit se do të bëhet video-incizimi i tij.

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola*, ka deklaruar se: në rastin konkret janë përdorur frekuencat, janë përdorur dërguesi dhe marrësi, në rastin konkret marrësi e ka liru një energji elektrike për ta vendosur në lëvizje detonatorin ndërsa detonatori e ka vendos në lëvizje eksplozivin, se për distancën prej 1km ndikojnë objektet (pengesat) në frekuencë, pra duhet të këtë shikim vizual dërguesi dhe pranuesi.

*Të dëmtuarit G. A., F. A. dhe A. K.*, nuk kanë parashtruar pyetje.



*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës, dëshmitari ka deklaruar se: marrësi i frekuencave ka qenë i vendosur në masën e eksplozivit, dhe për të inicuar eksplozivin detonatori duhet të jetë i vendosur në eksploziv, por sa ka qenë rrezja e veprimit të këtij eksplozivi nuk ka mundur të jap përgjigje të saktë sepse varet prej sasisë dhe llojit të eksplozivit.*

*2.b.13. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.10.2023, është dëgjuar edhe ekspertja Sh. G. F. nga IEDD, me ç'rast e njëjta duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana prokurorës së shtetit, ka deklaruar se: me urdhëresën e Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, ka përpiluar raportin e ekspertimit me numër referues AKF-2023-0291 të përfunduar me dt.18.08.2023, ku pasi që ka pranuar lëndën ka filluar me ekzaminimin e raportit, të diviar-it, në bazë të kërkesave që i është drejtuar nga Gjykata, në urdhëresë është kërkuar që nga dt.08.10.2018 nga ora 07:00/h deri në fillimin kur policia mbërrin në vendin e ngjarjes të nxjerrën të gjitha video incizimet të cilat gjenden në pajisje, i ka nxjerr video incizimet që i takojnë kësaj periudhe kohore, mirëpo është bërë edhe një kërkesë që të nxirret një video incizim i cili ceket edhe në raport i cili ndodhet në kamerën nr.5, po e njëjta datë është koha e precizuar edhe në raportin final 02,03 minuta, janë disa imazhe ku një i dyshuar vendos diçka ku shihet edhe në video, për të njëjtën është e panjohur. Në f.3 të ekspertizës e kemi figurën nr.2, e cila është e përshkruar si pamje nga kamera 5, e kemi imazhin apo sekuencën ku shihet personi me çadër dhe me fytyrë të kthyer nga kamera, këtë imazh e kishte dërguar edhe në raportin elektronik si video incizim i cili video incizim është i pastruar dhe i qartësuar aq sa e ka lejuar programi Forenzikë të cilin e kanë në përdorim dhe thekson se mund të jep mendim për programin që e përdor dhe që është i licencuar nga AKF-ja, që ju lejohet për ekzaminime forenzike, në AKF ekziston ky, ndërsa se a mund të ketë të tjerë nuk e din.*

*Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, nuk ka parashtruar pyetje.*

*Të dëmtuarit G. A. dhe F. A., nuk kanë parashtruar pyetje.*

*Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e mbrojtësit të të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj, ka deklaruar se: softueri amped five, përdoret për pastrimin e pamjeve dhe qartësimin e pamjeve, ky softuer është i licencuar nga AKF-ja, është e vërtetë që ka filtera, por të cilët përdoren në raste të ndryshme, sepse disa përdoren varësisht prej kërkesave të rastit dhe jo të gjithë filterat përdoren në një rast të vetëm. Ndërsa se a mund të nxjerrën tiparet individuale për identifikim bazuar në parimet e antropologjisë fizike, e njëjta ka sqaruar se nuk është në domenin e saj, mirëpo, mendon se duhet të jap një sqarim, të gjitha ekspertizat që i kryejnë i kanë të rregulluara me procedura, ndaj kjo nuk është e rregulluar me procedurat e AKF-së, e që nënkupton se kjo ekspertizë nuk kryhet në kuadër të AKF-së.*

*I pandehuri D. Gj., nuk ka parashtruar pyetje.*

*2.b.14. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 20.10.2023, është dëgjuar edhe eksperti S. S. nga IEDD, me ç'rast prokurorja e shtetit, nuk ka parashtruar pyetje.*

*Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, nuk ka parashtruar pyetje, duke shtuar se pyetjet të cilat i ka pasur i ka konsumuar me rastin e daljes në vend të ngjarjes.*

*Të dëmtuarit G. A. dhe F. A., nuk kanë parashtruar pyetje.*

Duke i'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ana e *mbrojtësit të të pandehurit, av. Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar se: lloji i eksplozivit TNT, si dhe çdo eksplozivi tjetër drejtimin e shpërthimit e ka në 360 shkallë, mirëpo nëse është i vendosur afër ndonjë muri apo ndonjë pengese siç ka qenë në rastin e caktuar vala goditëse shkon në drejtimin e kundërt të pengesës, shpejtësia e shpërthimit të eksplozivit TNT është rreth 7000 metra në sekond, ndërsa, eksplozivi matet me shpejtësi të shpërthimit e jo me forcë, pas shpërthimit largësia në të cilën vepron TNT pa pengesa varet prej sasisë, nëse kemi sasi të vogël nuk mund të bëjë dëme shumë larg, mirëpo, nëse kemi sasi të madhe dëmet janë shumë të mëdhaja. Ashtu që, distanca e personave të pranishëm në raport me bombën ka qenë e ndryshme, i ndjeri ka qenë shumë afër bombës, ndërsa, tjetri person ka qenë më larg, edhe tjetra është bomba e cila është punuar në atë lokacion ka pasur edhe sfera metalike për të shkaktuar lëndime në njerëz dhe kjo varet se si dhe ku e godet trupin e njeriut. Tutje ka shtuar së në raportin pas operacional është marr në provën nr..., një remote kontroll detonator dhe një trak ngjitëse, temperaturën që zhvillon TNT pas shpërthimit nuk e din mirëpo, në shpërthim përveç temperaturës ka edhe valë goditëse shumë të mëdha, ku për të prodhuar një bombë në këtë rast kanë përdorë remote kontroll ose teledirigjim që e ka përdorur kryesi prej një distancë për ta iniciuar bombën. Po ashtu, ka shtuar se e kemi dërguesin por duhet me pas edhe pranuesin që të funksionoj pajisja dërgues-pranues, në atë pranuesin lidhet detonatori, detonatori vendoset në eksploziv, pra, detonatori e dhezë eksplozivin dhe në këtë mënyrë krijohet bomba me teledirigjim. Po ashtu ka shtuar se remote kontroll i cili është gjetur është pranuesi, i cili ka qenë i vendosur së bashku me mjetin shpërthyes – eksplozivin dhe asnjëherë nuk ndodh me u djeg të gjitha pjesët dhe asnjëherë nuk ndodh me u zhduk detonatori nga temperatura. Pra, zakonisht kur shkojmë në vend të ngjarjes e gjejmë detonatorin, pjesa e cila nuk shpërthen dhe telat dhe për me i iniciuar një eksploziv të këtij lloji duhet të kemi patjetër detonatorin të vendosur në eksploziv, për arsye se për iniciimin e këtij eksplozivi nevojitet një goditje e menjëhershme me një temperaturë shumë të lartë për iniciim të eksplozivit.

*I pandehuri D. Gj., nuk ka parashtruar pyetje.*

*Duke u përgjigjur në pyetjet e Gjykatës, eksperti ka deklaruar se: ngjitësi mund të jetë special por mund të jetë edhe i zakonshëm, por në rastin konkret ka qenë i thjeshtë.*

### *2.c. Provat materiale*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 08.05.2023, është bërë administrimi dhe vlerësimi i provave, si:

*2.c.1. Nga raporti i autopsisë MA 18-311, të datës 14.10.2018, gjykata ka konstatuar se: në trupin e viktimës H. A. janë konstatuar 18 plagë të jashtme në formë të djegieve lëkurore, plagëve të shumëfishta të natyrave të ndryshme si qarëse eksploduese, shpuese, gërvishtje, plagë masive eksploduese etj. Po ashtu, janë konstatuar edhe dëmtime të brendshme e pikërisht shtatë dëmtime*

të brendshme në kokë, në dërrasën e gjoksit, klavikulën dhe brinjët në regjionin e majtë të gjoksit, shqyerje të sistemit arterial etj. Nga ky raport i autopsisë i punuar nga Dr. N.U. është konstatuar se shkak i vdekjes është si rezultat i gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme, si pasojë e plagëve të shumëfishta eksplozive në regjionin e gjoksit dhe thyerjeve të shumëfishta kockore.

2.c.2. Nga Raporti i ekspertimit të gjurmëve daktiloskopike me nr. AKF/2019-0545/2019-484, të dt. 25.06.2019, gjykata ka konstatuar se: është bërë ekzaminimi i dëshmisë së gjetur në vendin e ngjarjes e evidentuar si E#2 një bateri me mbishkrim Fujifilm, rezulton se në sipërfaqen e baterisë nuk ka pasur nxitje të vijave papilare.

2.c.3. Nga Raporti i ekspertimit të ADN-së me nr. AKF/2019-0545-483, të dt. 16.10.2019, gjykata ka vërtetuar se: nga e njëjta bateri nuk është identifikuar ADN me origjinë njerëzore.

2.c.4. Nga Raporti i ekspertimit balistik të Laboratorit të AKF-së për analiza zjarrvënie dhe eksploziv me nr. AKF/2019-0070, gjykata ka konstatuar se: është bërë ekzaminimi i mostrave të mbledhura nga vendi i ngjarjes, në dëshminë #1 ka treguar se ka mikro grimca unike me përmbajtje të elementeve kimike me prejardhje nga kapsolla e armës së zjarrit, po ashtu edhe dëshmia #2 ka rezultuar si dëshmia #1, ndërsa në dëshminë #4 është evidentuar prania e eksplozivit TNT.

2.c.5. Nga Raporti i ekspertimit të AKF-së, AKF/2019-0545/2019-485, të dt. 07.03.2019, gjykata ka konstatuar se: është bërë ekspertimi i armëve të gjetura në trupin e pa jetë të viktimës H. A., kështu pistoletë Sigsauer me nr. serik A157955 është pistoletë funksionale dhe nuk është zbuluar përputhshmëri me raste të tjera të librarisë së rasteve të hapura. Nga raporti i autoriteteve të Shqipërisë lidhur me telefonin e të pandehurit D. Gj. është siguruar Imei për numrin e telefonit . . e Operatorit Vodafone për periudhën kohore nga dt. 01.09.2018 deri me dt. 30.10.2018. nga ky raport rezulton që me dt. 11.09.2018 në ora 11:18 minuta ka figuruar që është kyçur në antenën në jug të Peshkopisë, në ora 14:49 minuta, në . . , në afërsi të aeroportit të Kukësit.

2.c.6. Nga Raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës, gjykata ka konstatuar se: D. Gj. me dt. 11.09.2018 në ora 10:32 minuta ka hyrë në territorin e Rep. së Kosovës përmes pikës kufitare të Vërmicës. Me dt. 30.09.2018 në ora 14:33 minuta D. Gj. ka hyrë në territorin e R. së Kosovës.

2.c.7. Nga Procesverbali për identifikimin e të dyshuarit i dt. 06.10.2020 vërtetohet se: A. K. personin në fotografinë me nr.5 e ka identifikuar si D. Gj..

2.c.8. Nga Komunikimi nga llogaria e FB-së “. . .” vërtetohet se, e dëmtuara-dëshmitarja F. A. ka pas komunikim me D. Gj..

2.c.9. Nga Raporti i Sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së, me nr. të dosjes 168-FVTI-2018 dhe nr. i dosjes së hetimit 2018-EA-1124, gjykata ka konstatuar se: Sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së i Policisë së Kosovës sipas urdhëresës së prokurorisë ka nxjerrë nga 2 DVR video incizimet nga dt. 08.10.2018-14.10.2018 duke filluar nga ora 07:00 deri në ora 10:00.

2.c.10. Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124, dhe raporti shtesë i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës NJETK-EA-32 dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124, gjykata ka konstatuar se: ngjarja ka ndodhur në fshatin S., Komuna e Gjakovës, në rrugë përpara dyerve të oborrit të

shtëpisë së viktimës H. A.. Provat e listuara në Listën e dëshmive policia i ka mbledhur nga vendi i ngjarjes, ku ndër të tjera ka sekuestruar edhe një armë zjarri nga trupi i të dëmtuarit.

*2.c.11. Nga Raporti pas operacional i Njësisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive me nr. ref./04/2-01E/216-A/2018, gjykata ka konstatuar se: me datën 14.10.2018, IEDD kishte dalë në vendin e ngjarjes lidhur me një shpërthim që ishte bërë afër derës së hyrjes së shtëpisë së viktimës H. A.. Bazuar në shikimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes nga operatorët e kësaj njësie, mjeti shpërthyes – bomba artizanale ka qenë e vendosur në kutinë postare e cila ishte e vendosur në murin afër derës së hyrjes së oborrit dhe është iniciuar nga distanca-me remote kontrol. Për përgatitjen e mjetit shpërthyes janë përdorë pjesë elektronike të cilat përdoren në pajisjet elektronike si psh. vetura, anije dhe helikopter, lodra. Si lëndë eksplozive bazuar në gjurmët që kanë lënë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të analizimit të testit fushor del të jetë TNT i iniciuar nga detonatori elektrik. Gjithashtu në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe sfera metalike të cilat kanë qenë të vendosura në mjetin shpërthyes e që shërbejnë për shkaktimin e dëmeve më të mëdha tek njerëzit dhe gjësendet.*

*2.c.12. Nga shikimi i CD-së me video incizim 2018-EA-1124, të dt.14.10.2018, gjykata ka vërtetuar se: ky video incizim është marrë nga kamerat e sigurisë së shtëpisë së viktimës, në këtë video incizim vërtetohet se me dt. 14.10.2018 rreth orës 02:03:02 sek., një person i gjinisë mashkull vendos diçka në kutinë postare të shtëpisë së të dëmtuarit, ky person shihet nga video incizimi se çalon dhe ka të veshura pantallona që veshin ushtarët.*

*2.c.13. Nga shikimi i Foto dokumentacioni nga dosja e forenzikës NJRTK-18-32, nga i cili vërtetohet se ky njësit kishte dal në vend të ngjarjes me dt. 14.10.2018, me ç’rast edhe kishte bërë fotografi të vendit të ngjarjes.*

*2.c.14. Nga Tabela e matjeve të vendit të ngjarjes dhe skica e vendit të ngjarjes gjykata ka vërtetuar se: është bërë skicimi i provave, respektivisht vendeve ku janë gjetur provat materiale dhe ku është gjetur trupi i viktimës, si dhe vendi ku është kryer vrasje.*

*2.c.15. Nga Lista e dëshmive me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124, gjykata ka vërtetuar se: provat prej E#1 deri E#63 janë marrë nga vendi i ngjarjes, nga ana e krim teknikës.*

*2.c.16. Nga Raporti i sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së, gjykata ka vërtetuar se: Sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së i Policisë së Kosovës, ka nxjerrë nga 2 DVR video incizimet nga data 08.10.2018 deri me datë 14.10.2018 duke filluar nga ora 07:00/h deri në ora 10:00/h.*

*2.c.17. Nga Raporti i ekspertimit i bërë nga AKF, me nr.AKF-2023-0291, i dt. 18.08.2023, gjykata ka konstatuar se: dëshmia DVR- H.A, një (1) DVR “. . .”, modeli: DH-XV XVR5108HS-X, me numër serik: 4DOO9BBPAZ6d8f8, pas procedimit standard të dëshmisë, fotografimit, kontrollimit të përmbajtjes dhe ekzaminimit me programin Forenzik DVR Examiner është konstatuar se kjo pajisje pas filtrimit të kërkesës në urdhëresë përmban përafërsisht 74 GB video regjistrime. Pas filtrimit për video regjistrimet për datën 08.10.2018 nga ora 07:00 deri me datën 14.10.2018, kërkimi rezulton me 8100 video regjistrime, të cilat janë gjeneruar në raportin final. Pastrimi i video regjistrimeve për datë 14.08.2018 është bërë nga disa kamera me numër: 2, 5 dhe 6 ku pastrimi, filtrimi, qartësimi dhe zmadhimi i këtyre imazheve është bërë me programin*

Amped FIVE. Ku disa nga pasqyrimet e këtyre ekzaminimeve janë pasqyruara si: pamje nga kamera 5 pamja e vendosjes së pajisjes eksploduese (02:03:02 2018), dhe nga e njëjta kamerë, shihet një person gjatë vendosjes së pajisjes eksploduese (02:03:02 2018), por nuk mund të identifikohet dhe të shihet fytyra e tij, pasi që i njëjti mban ombrellë, si dhe ka të vendosur maskë në fytyrë, kurse pamje nga kamera 2 shihet pamja para shpërthimit (07:49:02 2018) si dhe pamja pas shpërthimit (07:49:06 2018).

2.c.18. Nga *Raporti i ekspertimit i lëshuar nga Instituti Forenzik në Cyrih të Zvicrës*, gjykata ka konstatuar se: cilësia e imazhit të sekuecës së videos që është vlerësuar nuk ka lejuar që të bëhet ndonjë deklaratë në lidhje me identitetin e personit në fjalë të shfaqur (fotografuar). Prandaj, një ekzaminim krahasues me njerëz të njohur nuk lejon të nxirren përfundime, ku është cekur nëse rrobat, këpucët, dorezat dhe/ose një çadër (ombrelle) mund të sigurohen, një ekzaminim krahasues mund të jetë i dobishëm (të çojë në drejtimin e duhur). Edhe nëse në rastin e objekteve individuale do të rezultonte më së shumti vetëm një lloj barazie (njëjtësi tipi/lloji), në kombinim-d.m.th. nëse disa objekte të njëjtit lloj i janë sekuestruar të njëjtit person - hipoteza e identitetit mund të ketë një vlerë të lartë besueshmërie. Vlerësimi i përgjithshëm i gjetjeve përfshin besueshmërinë (gjasën), për të gjetur pikërisht këtë kombinim rastësisht tek një person, nëse sendet e sekuestruara nuk do të ishin sendet e paraqitura në videon e inkriminuar.

#### 2.d. Marrja në pyetje e të pandehurit

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.10.2023, i pandehuri D. Gj. ka paraqitur mbrojtjen e tij, në lidhje me këtë rast, me deklaram.

2.d.1. I pandehuri D. Gj., në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i'u përgjigjur pyetjeve të avokatit *Xhemajl Ademaj*, ka deklaruar, se: në pranverë të vitit është thirr nga komandanti i postës së policisë të asaj kohe në Postën e Policisë në V., dhe me një bisedë krejt të shkurtër jashtë ambienteve të komisariatit të policisë, i kishte kërkuar numrin e telefonit, e ka pyetur çfarë mjeti vozitë dhe çfarë targash ka makina, i kishte prezantuar të gjitha, dhe shton se e kishte pyetur a ja jep dikujt tjetër makinën, pra, a e përdor dikush tjetër, dhe i kishte thënë se nuk ia lë askujt tjetër, pas, këtij rasti është ndarë nga ky person, duke i lënë këshillën se mos ia le kujt makinën tënde se janë kryer disa vjedhje dhe po dyshohet për makinën tënde. Pas një periudhe afërsisht dy muaj, në një bisedë në mbrëmje me shtetasin A.K., i cili është vëllai i administratorit të Komunës së V.s në atë kohë, në një bisedë pa prezencën e tij me të njëjtin shef policie që e kishte marr në pyetje për numrin e telefonit dhe autorësinë e veturës shefi ia kishte shprehur se D. dyshohet për vrasje në Gjakovë, dhe A. i kishte thënë se dyshohet për babën e A.. Pas kësaj bisede është interesuar me personat që i ka njohur, duke e përfshirë shtetasin L. A., djalin e M. G., që e kishte takuar në një rast bashkë me G. tek shtëpia e K. në Gjakovë.

Me datën 14.10.2018, i njëjti ka shtuar se nuk i kujton asgjë, por, mbasi i ishte bastisur restoranti në mesin e muajit Korrik 2020, është vënë në lëvizje dhe kishte marr dijeni se është person në kërkim ndërkombëtar, dhe e vetmja mënyrë kishte qenë me iu drejtu kompanisë Vodafon, të cilës i kishte kërkuar tabulatet telefonike të numrit personal . . . nga dt. 01 Shtator 2018 deri me dt. 30 Tetor 2018, gjatë kohës kur ka qenë në kërkim ndërkombëtar, kompanisë Vodafon i është drejtuar tri herë me kërkesë, pas kërkesës së tretë kishte arritur ti sigurojë tabulatet telefonike, ku ishte marr me verifikimin e numrave të personave të dt.14.10.2018, dhe i kishte telefonuar shtetasit L. Sh. diku rreth orës 7.00/h të mëngjesit, e ka hapur telefonin i përgjumur dhe i kishte kërkuar për ta ndërtuar një mur me tulla aty te banaku i restorantit, i cili ja kishte mbyll telefonin pa e kuptuar përgjigjen, pasi kishte pirë kafe është drejtuar direkt dhe e ka takuar fizikisht te

shtëpia e tij, ku punon në ndërtim bashkë me vëllain dhe babin e vet. Pasi ia ka dhënë porosinë e punës atij personi ka rrugëtuar drejt Shkodrës, afërsisht në ora 08:00-08:30/h, të mëngjesit ka takuar shtetasen L. LL., pasi ka pirë kafe te një restorant, që punon si sanitare, i cili është në qendër të qytetit, i kishte dhënë një shumë lekësh, pasi djali i saj kishte punuar në orar të shkurtër tek i njëjti, e ka marr djalin e L. me veti, i ka telefonuar shtetasit P. P.t dhe i kishte kërkuar për të ja punuar do dërrasa, është takuar me P. fizikisht, së bashku me P.dhe J. kishin shkuar tek G. të cilin e ka takuar për herë të parë atë ditë dhe as nuk kishte pasur numër kontakti me të, përveç përmes P., ia kishte shpjeguar se si duhet punuar dërrasat dhe i njëjti i ka thënë: “ që ti sjellë se do të punojë deri në darkë”, duke shtuar se pastaj është nisur drejt fshatit . . . . së bashku me J., ku kishin shkuar tek shtëpia e shtetasit P. B., dhe i kishte thënë se i duhen dy lloj dërrasash, disa ja kishte kërkuar gështenje që ta punoj kapakun e banakut dhe disa tjera ia kishte kërkuar me gjatësi 4m. P. i kishte thënë merri qunat e mijë dhe dërrasat e gështenjës ke për ti ulë nga kulmi i shtëpisë (ka qenë kati i III), ku i kishte marr afërsisht katër dërrasa në gjatësi 2m, gjerësi 40cm, trashësi 7cm, të njëjtat kanë qenë të qara me motor sharr. Sqaron se i kanë zbritur dhe i kanë ngarkuar në foristrad, te stalla e bagëtive të këtij personi në largësi 200 m, prej shtëpisë i kishte marr edhe disa dërrasa tjera, ato kanë qenë plep i egër me trashësi 10-12 cm, me gjatësi 4 m, i ka ngarkuar të gjitha në foristrad, këto i kishte marr dhuratë nga ky person, bashkë me J. kishin shkuar tek punishtja e G., dhe aty i kishte telefonuar shtetasit P. P., ku kishte shkuar për herë të dytë prapë tek punishtja e G., dhe ka ndejt derisa i kishin përpunuar por nuk ka pasur shumë vonesë, pasi edhe G. i kishte përfunduar shumë shpejt. Atëherë është nisur drejt stacionit të trenit, e kishte dërguar J. tek shtëpia e tij dhe është nisur në drejtim të V. I njëjti ka deklaruar se mbasi e kishte parë foton e foristradës, mban mend se Foristrada ka qëndruar në Prizren tek një servis, pronari i një servisi quhet S. P., e kishte marr përsipër për me e rregulluar karroserinë, e dijë që kishte shkuar në Kosovë dhe kishte shkuar te servisi, foristrada ka qenë e pa punuar, pra, mendon se data e fundit që ka hyrë në Shqipëri ka qenë fillimi i muajit Tetor, por data nuk i kujtohet, por pas datës 06.10.2018 deklaroi se nuk ka ardhur asnjëherë tjetër në Kosovë, Ndërsa, sa i përketë faqes së FCB “. . .”, ka theksuar se nuk është adresa e tij, duke shtuar se e ka vetëm një adresë dhe ajo është “. . .” dhe është hap me email të numrit . . . , dhe këtë adresë e kishte hapur diku në vitin 2013-14, dhe kurrë nuk e ka mbyll si adresë, duke sqaruar se çdo shtetas i Shqipërisë e njeh me emrin E. Gj.j, dhe shumë e thirrin edhe “. . .”. Në vitin 2001 pasi kishte mbaruar shërbimin ushtarak është pagëzuar në kishën e Shëngjinit dhe e kishte vendosur emrin e gjyshit të tij D. Gj., dhe që nga ajo periudhë me vendim komune e kishte ndërruar edhe në pasaportë edhe në patentë edhe në dokument identiteti, këtë gjë nuk e kishte mohuar asnjëherë, të njëjtat i kishte deklaruar edhe në policinë e Gjakovës, kurse në vitin 2001 deri në vitin 2006, e kishte pasur një dyqan mishi në Shëngjin, pas vitit 2006 është shpërngul në V., ku është marr me blegtori, me dele shumicën e kohës, kishte mbajtur edhe dhi deri në vitin 2019, në Qershor të vitit 2019 i kishte hequr delet e fundit dhe e kishte hapur një bar kafe në vitin 2019, të regjistruar në emër të nuses së tij për vitin 2019, pasi nusja me fëmijët janë larguar në Itali në vitin 2019, atëherë në vitin 2020 këtë e ka kthyer në piceri në emër të biznesit “. . . . .”, afërsisht në vitin 2013-2015, kishte pasur 2-3 takime ndoshta edhe 4 takime gjithsej me të ndjerin A. A., nuk e di datën e sigurt se kur ka vdekur por i kujtohet se 7-8 ditë para se me vdek ka ndejt me të, kishte ngrënë drekë pasdite vonë në një restorant në një rrugë që është në dalje të Gjakovës në drejtim të Prishtinës, aty afër këtij restoranti ia kishte treguar edhe disa zagar, pëllumba dhe e kishte pasur edhe një punëtor të vjetër që kujdeset për to afërsisht 55-60 vjeç, gjatë kohës kur kishte ngrënë drekë kishin biseduar për me e bo një rrugë drejt Belgjikës, ka qenë i interesuar me ble pëllumba garash e të cilët quhen postiera, dhe e kishte pyetur se a ke të drejtë me shku në Evropë, i kishte thënë po, i kishte marr numrin e telefonit dhe e kishte regjistruar në telefonin e tij personal, nuk e din a e ka shënuar D. V., apo D. jarani. Ndërsa pohoi se e ka lexuar raportin e ekzaminimit të bërë nga Instituti i Cyrihut dhe e ka pritur këtë raport lidhur me mendimin e dhënë në të.

2.d.2. Duke u përgjigjur në pyetjet e *prokurores së shtetit*, i pandehuri kishte deklaruar se: deri në momentin kur është sjell me polici në Kosovë, kishte hyrë edhe vet privatisht në territorin e Republikës së Kosovës, afërsisht 20 herë, ndoshta më shumë apo edhe më pak, ndërsa arsyeja pse në Tetorin e vitit 2018 i kishte ndërprerë vizitat në Kosovë, kishte qenë largimi i bashkëshortes së tij në Itali dhe barra e punës në shtëpi dhe në familje sepse kishte mbajtur bagëti, dhe nuk ka pasur kush me u kujdes kur kishte ikur nusja, kurse ditën e diele e kanë ditë pushimi.

2.d.3. Duke u përgjigjur në pyetjet e *përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola, ka deklaruar se*: prej datës 01.01.2018 e deri me datë 14.10.2018, ka pasur shumë lloje makinash, kishte pasur mercedes, polo, smart i cili ka qenë i bashkëshortes, sepse kishte qenë më ekonomik, ku kishin jetuar me familje të shumtën e kohës, në pranverë të vitit 2018, për periudhën Mars – Qershor ka jetuar në zonën e Opojës, Komuna e Dragashit, te shtetasi B.S., pasi në Qershorin e vitit 2018 kishte pasur garat e kuajve, dhe kalin e tij e kishte lënë në shtëpinë e B.S.t, pasi kishin mbaruar garat, kalin e tij e kishte kthyer në Shqipëri dhe e ka mbajtur në V.. Pjesën tjetër kishte jetuar në V., Shëngjin e kishte një banesë në qendrën e qytetit dhe tek hoteli “. . .”, ndërsa në V. e ka vetëm një dhomë e cila është te restoranti i cili ndodhet në rrugën nr.8 në qendër të V.s, duke sqaruar se tjetër pronë nuk ka në V.. I njëjti ka deklaruar se para datës 14.10.2018 nuk e ka njohur A. K.n, po ashtu para kësaj datë nuk e kishte njohur të ndjerin H. A. dhe të dëmtuarën F. A., as nuk i kishte takuar e as nuk ka pasur kontakte me ta, kurse para datës 14.10.2018, ka qenë në Kosovë, por kurrë në jetë nuk kishte qenë në fsh. S., e as nuk nje askënd të këtij fshati, kurse më aq sa i kujtohet me dt. 23.11.2019, i kishte lindur vajza e vogël dhe kishte qenë në Itali, tek spitali, e kjo i kujtohet se atë natë ka ndodhur edhe tërmeti në Shqipëri. Tutje, sqaron, prej Janarit e deri me dt.14.02.2018 nuk kishte hyrë asnjëherë në Kosovë e as dal sepse kishte qenë në arrest shtëpiak, pas Shkurtit të vitit 2018, periudha Mars – Qershor 2018 kishte qenë i përqendruar në Opojë, e din vetëm emrin e personit në shtëpinë e të cilit kishte qëndruar. Pra, pranvera e vitit 2018 kishte qenë periudha kur ishin marr me përgatitjen e kalit në Opojë, ndërsa, në Gushtin e vitit 2018 bashkë me shtetasin S. P., kishin blerë rreth 200 krerë dele, i kishte blerë S., delet i kishte blerë te shtetasi L.K., i kishte pastruar këmbësh, i kishte bërë vaksinat, për pjesën të cilët i kishte mbajtur për mbarë, ndërsa, pjesën tjetër i kishte prerë për kurbanat. Kurse sa i përket raportit të ekspertimit se a i është marr ndonjë foto apo ndonjë matje nga ana e policisë apo dikujt tjetër, ka treguar se matjet, fotot dhe të gjitha të dhënat i ka dhënë ditën që është arrestuar e deri më tani i janë bërë pesë herë matjet, mirëpo, nga data 17.11.2023, nuk i janë bërë foto e as matje.

2.d.4. Duke u përgjigjur në pyetjet e *të dëmtuarës F. A.*, ka deklaruar se: kishte biseduar me të dëmtuarën vetëm në periudhën kur kishte vdekur A., sepse kishte bërë koment në çdo person i cili e ka shpërndarë profilin e tij. I njëjti pas ballafaqimit të pyetjes se a është e vërtetë që ju keni biseduar me mua në fcb, dhe i kishte thënë se nxirrma gjakun e vëllait se ju keni pare sa të doni, e këtë pyetje ja kishin bërë atë ditë kur kishte dhënë dëshminë në Gjykatë, i njëjti ka deklaruar se nuk është pyetja e tij, duke shtuar se përveç kohës kur ka vdekur A. e për të cilën deklaroi se ka komentuar por nuk është i sigurt nëse ka kontaktuar me këtë person, herë tjetër nuk kishte komunikuar asnjë me juve, e as nuk është takuar asnjëherë fizikisht me ju. Ndërsa për mesazhin e dërguar, një natë para natës kritike kishte qenë ora një e natës, me adresën “. . .”, duke i kërkuar që ti thotë burrit dhe plakut le të vijnë anej sepse është duke e ndrequr një çati, i njëjti thekson se nuk kishte komunikuar kurrë.

2.d.5. Duke u përgjigjur në pyetjet e *të dëmtuarit A. K.*, ka deklaruar se: vetura Smart kishte qenë e bashkëshortes së tij, nga fillimi i shtatorit të vitit 2017 e deri me dt. 14.02.2018 nuk ka vozitur asnjë lloj mjeti për arsye se kishte qenë në arrest shtëpiak, me byzylyk nga Gjykata e Shkodrës, ndërsa pas 14 shkurtit 2018 e deri te vrasja e H. gjatë kësaj kohe i ka pasur tre apo katër makina,

e nuk e përjashton faktin që mund ta ketë vozitur ndonjëherë edhe veturën Smart, ndërsa adresën e banimit e ka pasur tek lagjja . . ., fsh. . ., kurse fshati . . . nuk ka lidhje fare njëra me tjetrën, në Shtator të vitit 2018, kishte qenë në Prizren.

2.d.6. Duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga *gjykata*, ka deklaruar, se: biznesin në vitin 2019 e kishte hapur në emër të bashkëshortes ndërsa, në vitin 2020 e ka bartur në emrin e tij dhe e kishte emërtuar në emrin “. . .”, në vitin 2008 i kishte pasur tri banesa në plazh, mbasi është bërë rregullimi i shëtitores, i është dëmtuar një pjesë e banesës dhe i ka mbetur vetëm një banesë 18 metra e gjatë, nga viti 2008 deri në vitin 2018 të cilën e kishte kthyer si dyqane të vogla dhe i kishte lëshuar me qira verës. Pas sezonit të vitit 2018 pikërisht në muajin gusht, me kurajën e shokëve i kishin thënë ri konstrukto dhe bëje lokal për veti dhe në vitin 2019 është hap në emër të gruas si “. . .”, edhe pse i njëjti kishte punuar vazhdimisht në atë bar, ku në vitin 2018 ka qenë e ndarë në copa të vogla, ndërsa renovimin e kishte filluar pas sezonës saktësisht pas datës 20 gusht kur kishin ikur qiramarrësit e të cilët i kanë edhe shumë borxhe të rrymës.

### 3.e. Fjala përfundimtare

Me datë 05.03.2024, palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

#### 3.e.1. Prokurorja e Shtetit Ervehe Gashi, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të rast vë në rrezik jetën e të dëmtuarit A. K., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri D, rreth orës 02:30 min., ka vendosur një materiale eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., në momentin kur tani i ndjeri rreth orës 08:02 min, del nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll dyert e oborrit, i pandehuri nga një largësi e panjohur, përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., dhe më parë ka siguruar dhe gjerë me datë 14.10.2021, pa autorizim, ka poseduar materie eksplozivi të tipit dhe natyrës së panjohur në shkëlje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla e të cilin eksploziv ditën kritike rreth orës 08:02 min, i pandehuri e aktivizon në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi duke privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës.

Me deklaratën e të dëmtuarës F. A. u provua fakti se me të pandehurin, e njëjta së bashku me babain e saj kishin pasur komunikime përmes rrjetit social Facebook, të cilën adresë e kanë përdorur bashkërisht, ku në këtë adresë para se të ndërronte jetë babai i saj, i pandehuri i kishte shkruar dhe ka pranuar një mesazh nga i akuzuari D. Gj. me përmbajtje që ti tregoj babës dhe burrit që të vijnë në Shqipëri pasi që është duke e ndrequr një çati dhe nuk mund të vjen në Kosovë, ajo ka dyshuar në këtë ftesë të D. dhe i është përgjigjur se babai nuk mund të shkojë në Shqipëri, në mëngjesin e ditës kritike një orë para se të bëhet vrasja e kishte parë mesazhin nga D. me përmbajtje "kur e ka prerë (nxjerrë) biletën H. për tu kthyer në Gjermani", ndërsa ajo ishte përgjigjur se nuk e dinë. Pas këtij momenti, e deri në orën 16:00/h, D. Gj. nuk ka hyrë në rrjetin social. Ajo D. e ka njohur si E. Gj.j, ndërsa babai i saj i kishte treguar se E. është D. Gj.. D. e kishte njohur përmes babait të saj, babai i saj kishte shkruar në Prizren për ta takuar një shokë të A. për të shitur mjaltë, pastaj ai kishte shkruar edhe në Shqipëri tek D., D. kishte ardhur në Gjakovë dhe fillimisht ka qëndruar te pllaci në fshatin . . ., nga babai kishte kuptuar se D. do ti ofronte ndihmë për vrasjen e B.. Ai kishte qëndruar në S. dhe një ditë babai i saj i ka kërkuar gelësat e shtëpisë në S. dhe i ka thënë që D. nuk ka qejf që ta sheh njeri, kështu nga fakti se kishte dyshime, ka dal në ballkon, e ka fikur dritën e ballkonit dhe ka parë D. i cili në atë kohë ka qenë



pak më i plotë se tash, e ka pasur të veshur një vinjak të zi, me kapulaq me lesh, kështu së bashku me babën e saj janë nisur në drejtimin e S., kjo ngjarje ka ndodhur dy muaj para se të vritet babai i saj, në shtëpinë e tyre në S. D. ka qëndruar një muaj, kishte kërkuar nga babai i saj ti largoj qentë prej S.s dhe të sigurohet që kamerat mos të punojnë, babai i saj një javë para ditës kritike për herë të fundit kishte qenë në S. dhe kishte ndenjur një javë aty. Pasi që ka ndodhur vrasja, e para se të shkojë në fshatin S.. Edhe më vonë deri një muaj pas vrasjes së babait të saj ka pranuar mesazhe kërcënuese nga D, i kishte treguar se ai nuk e kishte kryer vrasjen, kishte kërkuar nga ajo që mos të shkojë në polici, e ditën kur ajo ka dhënë deklaratën në polici, menjëherë ka pranuar mesazh nga D. me përmbajtje se pse ka shkuar në polici për të dhënë deklaratë, kërcënimet nga ai kanë qenë të tilla si mua më ke borxh në jetë dhe i ka dërguar disa foto me shpinën e tij me plagë operative. Po ashtu, e ka kërcënuar me fjalë se ti së bashku me burrin tënd keni për ta pësuar pasi që e kanë lajmëruar atë në polici. Me D. Gj. ka kontaktuar nëpërmes llogarisë së Facebook-ut "Mirëdita D.", pastaj me kërkesën e D. që mos të shkruaj në këtë llogari, kanë kontaktuar nëpërmes adresës tjetër në facebook ". . .", ndërsa llogaritë e Facebook-ut me të cilat ka kontaktuar ajo me D, kanë qenë nëpërmes llogarive "H.B." dhe . . . që kanë qenë llogari të babait të saj. Për D. e dinë që është nga Shqipëria dhe jeton në V., në kohën kur është vrarë babai i saj, vëllai i saj ka qenë në burg. Ajo e bazon dyshimin e saj që vrasjen e babait të saj e ka kryer D. Gj., nga fakti se një njeri i panjohur për babën e saj nuk e di si të afrohet për ta vrarë një njeri, është e sigurt që ditën kritike ka kërkuar D. të shkojë për ngushëllime te ata dhe ka vazhduar edhe ditët e tjera në vazhdim, e pikërisht pas varrimit të babait të saj. Është e sigurt se D. ka kontaktuar nëpërmes adresës ". . ." pasi që njëherë bashkëshorti i saj A. kur ka qenë së bashku me D. ka kontaktuar me dëshmitaren nëpërmes asaj adrese. Ajo që nga fillimi ka pasur dyshime që D. mund ta vret babanë e saj.

*I dëmtuari A. K., në deklarinimin e tij të deponuar në gjykatë me dt.10.01.2023, ka mbetur në tërësi pranë deklaratave të dhëna në prokurori me dt.18.06.2020, 22.09.2021 dhe deklaratës së dhënë në polici me dt. 06.10.2020, duke theksuar se në momentin kritik ka qenë vetëm duke shkuar në fshatin S., diku rreth orës 08:00, ka hyrë në oborrin e shtëpisë së H. në fshatin S., dhe së bashku me H. kanë dal prej oborrit me qëllim që të shkojnë në fshatin . . ose . . . për të blerë një pastërm. Nga oborri ka dal ai i pari, H. ka dal pas tij, është nisur kah automjeti i tij, në atë kohë H. ka qenë duke e mbyllur derën e oborrit me qelës, i ka bërë me shenjë që të shikojë se si i ka rregulluar kamerat pasi që më herët ato kanë qenë të prishura dhe pas atij momenti ka dëgjuar një eksplozim, nuk ka parë asgjë, vendi ka qenë me tym dhe e ka parë H. të shtrirë për toke, ka bërë titur një ose dy herë me emër duke thirrë "H., H." i njëjti nuk është përgjigjur. Pas shpërthimit ai ka pasur dhimbje të kokës dhe të veshit të majtë, si dhe një plagë nga një pjesë e vogël e metalit në kokë, për këtë nuk ka kërkuar trajtim mjekësor. Kamerat e shtëpisë në fshatin S. një kohë kanë qenë të prishura, ai ka siguruar mjeshtrin për ti riparuar kamerat, është në dijeni se kabllot e kamerave të cilat kanë qenë nëpër oborr kanë qenë të këputura, por pse kanë qenë të këputura nuk e dinë arsyen. Ai e ka dërguar mjeshtrin për ti rregulluar kamerat, me D. është njoftuar në fund të vitit 2017 nëpërmes rrjetit social Facebook, me ç'rast i ka shkruar në Messenger me kërkesën e H. duke i treguar se është dhëndri i H. nga S. dhe që H. ka dashur të bisedojë me të, këtë komunikim e ka bërë me adresën e Facebook-ut e quajtur "E. Gj.j". Nuk është përgjigjur, ndërsa pas disa muajve ka komunikuar me H., e nga ai vet ka kuptuar se në atë kohë ka qenë në burg dhe nuk ka mundur të përgjigjet. D. ka kërkuar nga H. që ta bëjnë takimin në fshatin S. i cili gjendet para se të shkohet te plazhi i V.s, sa i kujtohet data e këtij komunikimi ka qenë në mes të muajit dhjetor 2017 Ose janar të vitit 2018. Po ashtu ka pasur kontakte fizike me D. Gj., kështu në periudhën kohore dhjetor 2017 janar 2018, ai së bashku me H. kanë shkuar në vendin ku ka thënë E., kur kanë arritur atje në atë kafene ku kanë pasur për ta takuar E. dhe K. i ka thënë që donë me u taku me E., pas 5-6 minutave janë takuar. Ndërsa dy muaj para se të vritet H. A. janë takuar me D. Gj. edhe njëherë në një restorant në dalje të autostradës në Prizren,*

aty, kanë hyrë në lokal, D. ka qenë në shoqëri me dy persona, ndërsa me dëshmitarin ka qenë H., ku dëshmitari ka qëndruar në veturë dhe pas një ore H. është kthyer në veturë dhe së bashku me D. janë nisur në drejtim të Gjakovës. Kur kanë arritur te banesa e H. në Gjakovë, ai i ka kërkuar celësat e shtëpisë të fshatit S., aty dëshmitari është përshëndetur me këta të dy, ndërsa me automjetin e H. D. dhe H. kanë shkuar në fshatin S. ku edhe kanë qëndruar një natë, të nesërmen H. e ka përcjell D. deri te stacioni i autobusëve në Gjakovë, pasi që D. është kthyer në Shqipëri. Nga H. ka kuptuar se D. ka pasur ti ndihmojë për ta kryer një vrasje, po ashtu ka treguar se nëse D. do ta kryente vrasjen, atëherë do ta paguante H. për punën e kryer. Ka pohuar se kontaktet e H. së me D. Gj. janë bërë edhe nëpërmes mesazheve në Ilogarinë e Facebook-ut, të cilën e ka kontrolluar F. A., e cila është bashkëshortja e tij, mesazhet kryesisht kanë qenë lidhur me organizimin e takimeve. Bashkëshortja e tij ka këmbyer mesazhe me D. Gj. edhe pas vdekjes së H., kështu D. ka kërkuar sqarime se pse po akuzohet për vrasjen e H., një natë para se të vritet H., F. e ka pa një shkrim me përmbajtje "a mundet H. me dhëndrin me ardh me' m taku", mesazhi ka qenë i dërguar prej D.. Nga informacionet që ka marrë prej D. e dinë që D. e ka pasion gjuetinë, punon si kasap dhe ushtrinë e ka kryer si marinar. Vendi ku ka ndodhur eksplodimi është shtëpia e viktimës H., shtëpi kjo në të cilën ka qëndruar D. Gj..

Dëshmitari G. A. në dëshminë e tij të deponuar në Gjykatë me dt. 10.01.2023, ka mbetur pranë deklaratës të dhënë në Prokurori, duke theksuar se tre ditë para se të vritet babai i tij, ai e ka vizituar në burg, i njëjti pra viktima i ka treguar se D. Gj. është ka donë me e vra atë dhe se e ka lajmëruar rastin në polici pasi që ishte duke e ndjekur një automjet, po ashti i ka treguar se marrëveshja e tij me D. nuk do të realizohet pasi që D. qenka punëtori i B.t. Kurse dëshmitarët G. B., S. B. dhe L.A. kanë deklaruar ngjashëm si në prokurori, duke treguar se të akuzuarin D. Gj. e njohin, ka qenë shok i A. dhe është marrë me gjueti, atë e kanë njohur lidhur me çështjet e gjuetisë.

Në shqyrtimin kryesor e dt. 13.03.2023 dëshmitë e tyre kanë deponuar edhe dëshmitarët e mbrojtjes L. LL., L. Sh., P. B. dhe G. S., të cilët kryesisht kanë dëshmuar rreth alibisë së D. Gj., kështu dëshmitarja L. LL. ka dëshmuar se me dt. 14.10.2018 e ka takuar D. tek ura e D. B. diku rreth orës 08:43 minuta pasi që ka biseduar me të me telefon lidhur me punësimin e djalit të saj 13 vjeçar në lokalin ku ka qenë pronar D. Gj., po ashtu ka treguar se me D. ka qëndruar një orë dhe nga ai ka kuptuar se nga aty do të niset për në Malësi të Madhe. Ka deklaruar se gjatë pushimeve verore djali i saj ka punuar shtatë ditë të javës te D., ndërsa viti shkollor fillon në shtator, e me dt. 14.10.2018 nuk i kujtohet cila ditë e javës ka qenë, por i kujtohet se ka qenë fundjavë. I kujtohet data 14.10.2018, pasi që dy ditë pas kësaj date djali i saj ka pësuar aksident. Djali i saj në restorantin e D. ka punuar si banakier dhe picamen. Ndërsa dëshmitari L. Sh. deklaroi se në bazë të tabulatit të telefonit, rezulton se në orën 06:30 të mëngjesit, ditën e diel, ka biseduar me D. Gj. me telefon dhe pas 20-30 minutave D. ka shkuar në shtëpinë e tij dhe ka kërkuar që të del dëshmitari në punë për ta punuar një banak dhe nga D. ka kuptuar se do të shkojë në Shkodër për punën e dërrasës së banakut. Dëshmitari P. B. deklaroi se në tetorin e vitit 2018, D. e ka takuar në shtëpinë e tij, D. ka shkuar te ai me një foristradë dhe e ka marrë një dërrasë gështenje për një banakë. I kujtohet se është takuar me te akuzuarin D. Gj. me dt. 14.10.2018 pasi që me dt. 12.10.2018, nënës së tij i kishte rënë infarkti. Edhe dëshmitari G. S. ka deklaruar se nuk i kujtohet se në cilin vit ka shkuar te ai D., por i kujtohet se ai ka shkuar te ai për ti qarë dërrasat në sharrën e tij.

*Nga raporti i Autopsisë MA 18 — 311, dt. 14.10.2018, rezulton se në trupin e viktimës H. A. janë konstatuar 18 plagë të jashtme në formë të djegieve lëkurore, plagëve të shumëfishta të natyrave të ndryshme si qarëse eksploduese, shpuese, gërvishtje, plagë masive eksploduese etj. PO ashtu, janë konstatuar edhe dëmtime të brendshme, e pikërisht 7 dëmtime të brendshme në*

kokë, në dërrasën e gjoksit, klavikulën dhe brinjët në regjionin e majtë të gjoksit, shqyerje të sistemit arterial etj. Nga ky raport i autopsisë i punuar nga dr. N.U. është konstatuar se shkak i vdekjes është si rezultat i gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme, si pasojë e plateve të shumëfishta eksplozive në regjionin e gjoksit dhe thyerjeve të shumëfishta kockore.

*Nga Raporti i ekspertimit të gjurmëve daktiloskopike me nr. AKF/2019-0545/2019484 dt. 25.06.2019, rezulton se është bërë ekzaminimi i dëshmisë së gjetur në vendin e ngjarjes e evidentuar si E#2 një bateri me mbishkrim Fujifilm, rezulton se në sipërfaqen e baterisë nuk ka pasur nxitje të vijave papilare.*

*Nga Raporti i ekspertimit të ADN-së me nr. AKF/2019-0545-483 dt. 16.10.2019, rezulton se nga e njëjta bateri nuk është identifikuar ADN ne origjinë njerëzore.*

*Nga Raporti i ekspertimit balistikor të Laboratorit të AKF-së për analiza zjarrvënie dhe eksploziv me nr. AKF/2019-0070, rezulton se është bërë ekzaminimi i mostrave të mbledhura nga vendi i ngjarjes, në dëshminë ka treguar se ka mikro grimca unike me përmbajtje të elementeve kimike me prejardhje nga kapsolla e armës së zjarrit, po ashtu edhe dëshmia ka rezultuar se dëshmia #I, ndërsa në dëshminë #4 është evidentuar prania e eksplozivit TNT.*

*Nga raporti i ekspertimit të AKF-së, AKF/2019-0545/2019-485 dt. 07.03.2019, është konstatuar se është bërë ekspertimi i armëve të gjetura në trupin e pa jetë të viktimës H. A., kështu pistoleta Sigsauer, me nr. serik A157955, është pistoletë funksionale dhe nuk është zbuluar përputhshmëri me raste të tjera të librarisë së rasteve të hapura. Nga raporti i autoriteteve të Shqipërisë lidhur me telefonin e të pandehurit D. Gj. është siguruar Imei për numrin e telefonit . . . e Operatorit Vodafone për periudhën kohore nga dt. 01.09.2018 deri me dt. 30.10.2018. nga ky raport rezulton që me dt. 11.-09.2018 në ra 11:18 minuta ka figuruar që është kyçur në antenën në jug të Peshkopisë, në ora 14:49 minuta, në . . . , në afërsi të aeroportit të Kukësit.*

*Nga raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës, rezulton se D. Gj. me dt. 11.09.2018, në ora 10:32 minuta, ka hyrë në territorin e R. se Kosovës përmes pikës kufitare të Vërmicës. Me dt. 30.09.2018, në ora 14:33 minuta, D. Gj. ka hyrë në territorin e R. së Kosovës.*

*Nga procesverbali për identifikimin e të dyshuarit i dt.06.10.2020 rezulton se A. K. personin në fotografinë me nr.5 e ka identifikuar si D. Gj..*

*Nga komunikimi nga Ilogaria e FB-së ". . ." rezulton se dëshmitarja F. A. ka pas komunikim me D. Gj..*

*Nga CD-ja me video incizim 2018-EA-1124 dt. 14.10.2018, rezulton se ky video incizim është marrë nga kamerat e sigurisë të shtëpisë së viktimës, në këtë video incizim vërtetohet se me dt. 14.10.2018 rreth orës 02:03:02, një person i gjinisë mashkull, vendos diçka në kutinë postare të shtëpisë së të dëmtuarit, ky person shihet nga video incizimi se qalon dhe ka të veshura pantallona që veshin ushtarët.*

*Nga Raporti i Sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.l.-së, me nr. të dosjes 168-FVTI-2018 dhe nr. i dosjes së hetimit 2018-EA-1124, rezulton se Sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.l.-së i Policisë së Kosovës sipas urdhërësës së prokurorisë ka nxjerrë nga 2 DVR video incizimet nga dt.08.10.2018-14.10.2018, duke filluar nga ora 07:00 deri në ora 10:00.*

*Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës 2018DTK-039 VN-dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124 dhe Raporti shtesë i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës NJETK-EA-32 dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124, rezulton se ngjarja ka ndodhur ne fshatin S., të Komunës së Gjakovës, në rrugë përpara dyerve të oborrit të shtëpisë së viktimës H. A.. Provat e listuara në listën e dëshmimeve policia i ka mbledhur nga vendi i ngjarjes, ku ndër të tjera ka sekuestruar edhe një armë zjarri nga trupi i të dëmtuarit.*

*Nga tabela e matjeve dhe skicimi i vendit të ngjarjes rezulton se është bërë skicimi i provave, respektivisht vendeve ku janë gjetur provat materiale dhe ku është gjetur trupi i viktimës, e ku dyshohet se është kryer vrasje.*

*Nga raporti pas operacional i Njësisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive me nr. ref./04/2-01F/216-A/2018, rezulton se me datën 14.10.2018, IEDD kishte dalë në vendin e ngjarjes lidhur me një shpërthim që ishte bërë afër derës së hyrjes së shtëpisë së viktimës H. A.. Bazuar në shikimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes nga operatorët e kësaj njësie, mjeti shpërthyes - bomba artizanale ka qenë e vendosur në kutinë postare e cila ishte e vendosur në murin afër derës së hyrjes së oborrit dhe është iniciuar nga distanca-me remote kontroll. Për përgatitjen e mjetit shpërthyes janë përdorë pjesë elektronike të cilat përdoren në pajisjet elektronike si p.sh. vetura, anije dhe helikopter; lodra. Si lëndë eksplozive bazuar në gjurmët që kanë lënë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të analizimit të testit fushor del të jetë TNT i iniciuar nga detonatori elektrik. Gjithashtu në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe sfera metalike të cilat kanë qenë të vendosura në mjetin shpërthyes e që shërbejnë Për shkaktimin e dëmeve më të mëdha të njerëzimit dhe gjësendet.*

*Gjatë shqyrtimit kryesor është bërë edhe rikonstruimi i vendit të ngjarjes, e pas së cilës është bërë edhe raporti i këtij rikonstruimi nga ana e krim teknikës dhe raporti pas operacional i njësisë Për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive – IEDD, ku është vërtetuar se distanca e inicimit të mjetit shpërthyes në rastin në fjalë, ka mund të jetë deri në një kilometër, detonatori në këtë rast ka shërbyer për të iniciuar eksplozimin. Mjeti shpërthyes në rastin konkret ka pasur një pranues i cili në momentin e pranimit të sinjalit ka aktivizuar energji elektrike, e cila e ka iniciuar detonatorin, ndërsa detonatori e ka iniciuar eksplozivin, dëshmia nr. 45 ka qenë detonatori i cili e ka iniciuar eksplozivin, ndërsa perimetri i shpërthimit varet nga lloji dhe sasia e eksplozivit, në rastin konkret nuk mund të konstatohet perimetri, detonatori elektronik në këtë rast ka qenë i vendosur me eksploziv, nuk ka pasur mundësi të bëhet identifikimi i detonatorit dhe prodhuesit të detonatorit pasi që i njëjti ka qenë i dëmtuar nga shpërthimi, ndërsa në komunikimin ndërmjet dërguesit dhe pranuesit paraqet problem konfiguracioni i terrenit dhe objektet e ndryshme në atë vend, marrësi dhe detonatori janë në një vend çka do të thotë ato shkojnë bashkë në një vend.*

Me urdhëresën e gjykatës Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka kryer ekzaminimin me nr. AKF-2023-0291, të dëshmisë DVR me specifika si në raport, kështu nga DVR-ja është kërkuar të nxirren pamjet e video incizimeve për periudhën kohore nga ora 07:00, dt. 08.10.2018, e deri në momentin e tërheqjes nga policia, si dhe është kërkuar të bëhet kthimi i incizimeve nga Motion detect në kohën reale pa ndërprerje prej dt.14.10.2018 duke filluar nga ora 00:00 e deri në tërheqjen e DVR-së. Pas tërheqjes së këtyre video incizimeve është bërë edhe pastrimi i imazheve, ndërsa ekspertja e AKF-së Sh. G. F., gjatë dëshmisë së dhënë përpara trupit gjykues, në tërësi e ka mbështetur raportin e saj.

I akuzuari D. Gj., si në prokurori, ashtu edhe përpara trupit gjykues në tërësi ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale, duke theksuar se në kohën kur është kryer vepra penale nuk ka qenë në Kosovë, e po ashtu ka mohuar që i ka njohur personat si të ndjerin H. A. nga fshati S. Komuna

e Gjakovës, A. K., F. A., F. A.n dhe A. K.n. G. A.n e ka njohur e ka parë vetëm një herë tek shtëpia e K. nga Gjakova. Ka mohuar se i ka njohur prindërit e A. A.t duke shtuar se as në varrimin e A. nuk ka qenë. Po ashtu mohon se me dt.14.Tetor 2018 ka qenë në Kosovë. Përndryshe përdor llogarinë e FB, komunikon me këtë llogari, dhe llogaria e tij në FB quhej fillimisht D. Gj., e pastaj Kunora Park. E lidhur me takimet me dëshmitarët F. A., A. K., G. A., dhe kontakteve me ta nëpërmes FB i njëjti ka deklaruar se nuk ka pasur kurrë takime me ta, në pranverën e vitit 2019, pasi që është njoftuar nga Komandanti i Stacionit Policor në V. që është i dyshuar për vrasjen e H. A.t, kështu ka bërë përpjekje për të kontaktuar me ta. Ka pohuar se ka pasur probleme me unazat e boshtit kurrizor dhe është operuar me diagnozën "Here - diskale" e pas operimit nuk ka pasur probleme shëndetësore dhe pengesa në të ecur si çalim ose ecje jo e koordinua. Po ashtu, ka mohuar se ka qenë ndonjë herë në fshatin S. të Komunës Së Gjakovës. Ndërsa ka pohuar se sportin e gjetisë e ka hobi. Lidhur me çështjen se çka ka bërë me dt. 14.10.2018 ka deklaruar se kjo datë nuk i kujton asgjë por pasi që ka kuptuar që është person në kërkim ndërkombëtar i është drejtuar kompanisë Vodafon, me kërkesë për tu pajisur me tabulatet telefonike të numrit të tij personal . . . , për periudhën kohore prej 01.09.2018 e deri me 30.10.2018 pasi që është pajisur me këto tabulate, ka verifikuar se me kë ka biseduar me dt. 14.10.2018, kështu tash i kujtohet se atë ditë është zgjuar herët, ka pirë kafe në hotelin . . . , i ka telefonuar dëshmitarit L. Sh., diku rreth orës 07:00 të mëngjesit, të cilit i ka kërkuar ta mbarojnë një mur me tulla te banaku i restorantit, kështu është nisur menjëherë në shtëpinë e L. Sh. pasi që ai punon në ndërtim ku edhe të njëjtit i ka dhënë porosinë e punës, prej aty është nisur drejtë Shkodrës dhe rreth orës 08:00 — 08:30 është takuar me dëshmitaren L. LL., asaj duke pirë kafënë ia ka dhënë një shumë lekësh, pasi që është ndarë nga Lula e ka marrë djalin e L. me vete, i ka telefonuar P. P. është takuar me të dhe së bashku me djalin e L. dhe P. janë nisur te dëshmitari G. me të cilin ka biseduar lidhur me punimin e dërrasave, prej aty është nisur në fshatin . . . , së bashku me djalin e L., aty kanë shkuar në shtëpinë e P. B.t dhe është pajisur me dërrasa të gështenjës, këto dërrasa i ka ngarkuar në foristradën e tij, është kthyer në punishten e G.t, ku janë përpunuar dërrasat dhe nga aty është nisur drejtë stacionit të trenit për ta dërguar djalin e L. në shtëpi. I kujtohet se me dt. 06.10.2018, ka dal nga territori i Kosovës, ndërsa adresa në Facebook ". . ." nuk është e tij. Disa herë ka ndërruar profesion, fillimisht ka pas një dyqan mishi në Shëngjin, e pikërisht deri në vitin 2006, prej asaj kohe e deri në qershorin e vitit 2019 është marrë me kultivimin e deleve dhe pastaj është marrë me veprimtari hoteliere, e nga viti 2000 e këndeje ka hapur biznes me emrin ". . .". Ndërsa ka deklaruar se nga tetori i vitit 2018 nuk ka hyrë më asnjëherë në territorin e Republikës Së Kosovës, pasi që bashkëshortja e tij ka shkuar në Itali dhe barra e punës i ka rënë atij. Deklaratës së tillë të pandehurit nuk mund ti falet besimi, pasi që nga deklaratat e dëshmitarëve të dëmtuar, rezulton se për periudhën kohore kur ai mohon se nuk i ka njohur këta dhe nuk ka qenë në fshatin S., në realitet i akuzuari E. ka qenë në S.. I njëjti mirë e ka njohur viktimën H. A., mesazhet e H. A. në drejtim të akuzuarit dhe anasjelltas i ka bartë e dëmtuara F. A., edhe atë nëpërmes rrjetit social Facebook me adresën ". . .", po ashtu është vërtetuar edhe nga deklaratat e tyre dhe vetë të akuzuarit që i akuzuari D. Gj. është njohur edhe me emrin E.. Nëse i referohemi deklaratës së F. A., lidhur me çështjen e dorëzimit të çelësave të shtëpisë në S., ajo D. Gj. e përshkruan si personi duke iu referuar të akuzuarit D. Gj., pak më i plotë se tash, me një jakne me kapuq të leshtë. Nëse analizojmë video incizimin e marrë nga kamerat e sigurisë së shtëpisë së viktimës, të cilat tregojnë momentin e vendosjes së eksplozivit në kutinë postare, atëherë vërtetojmë se edhe personi i cili e ka vendos eksplozivin në kutinë postare, i përngjan me veshje personit të cilin dëshmitarja e përshkruan si D. Gj..

Andaj, me mbrojtje të tillë i pandehuri synon të zvogëlojë përgjegjësinë penale pasi që deklaratat e tij edhe në prokurori është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve F. A. dhe A. K. dhe provat materiale të theksuara në aktakuzë, ndërsa pjesën e mbrojtjes që ai pohon se e ka ndërtuar në bazë të tabulateve të telefonit, nuk duhet ti falet besimi nga fakti se në fillim të deklarimit të

tij përpara prokurorit të shtetit nuk e ka dhënë një mbrojtje të tillë dhe gjithë rrëfimin e tij e ka sajuar në bazë të telefonatave që i ka bërë, këtë e them nga fakti se personi në moshën 13 vjeçare djali i dëshmitares L. LL. nuk mund të punojë si picamen Për shkak moshës që e ka, nuk mund të punojë me orar të plotë shtatë ditë të javës e në kohën e njëjtë ta vijojë edhe mësimin në shkollë. Është Për tu çuditur se deklaratat e dëshmitarëve lidhur me datën 14.10.2018 janë të hollësishme dhe u kujtohet çdo detaj, por nuk u kujtohen detajet për ndonjë ngjatje tjetër, nuk u kujtohet cila ditë e javës ka qenë, dhe nga kjo prokurori i shtetit vjen në përfundim se dëshmitarët janë përgatitur për tu deklaruar në favor të mbrojtjes së të akuzuarit D. Gj..

Se i pandehuri D. Gj. ka vendosur eksplozivin në kutinë postare të cekur të viktimës H. A. vërtetohet drejtpërdrejt nga provat materiale të mbledhura nga vendi i ngjarjes, ekzaminimi balistikor, raporti i autopsisë, dëshmia e dëshmitarëve, incizimi nga kamerat e sigurisë së shtëpisë së viktimës dhe provat tjera materiale. Ndërsa sipas listës së dëshmimeve me nr. të dosjes së forenzikës 2018- DTK-039 VN- dhe dosja e hetimit 2018-EA-1124 vërtetohet se provat prej E#1 deri E#63 janë gjetur në vendin e ngjarjes në afërsi të trupit të viktimës, ashtu si është paraqitur në skicën e vendit të ngjarjes të punuara nga krim teknika e policisë. Me akt ekspertimin balistik është vërtetuar se të gjitha provat e gjetura në vendin e ngjarjes, janë si rezultat i eksplozimit të mjetit shpërthyes. Po ashtu, nga raporti i ekspertizës rezulton që nga trupi i viktimës janë nxjerr disa fragmente metalike.

Motivi i kësaj vepre penale është mosmarrëveshja paraprake që e kishte i pandehuri me viktimën - lidhur me pazaret e bëra më herët për një vrasje me pagesë, këtë motiv e vërtetojnë deklaratat e dëshmitarëve të dëmtuar F. A. dhe A. K.. Vepra penale është kryer me veprimin e të akuzuarit - vendosja e mjetit shpërthyes eksplozivit dhe aktivizimi i të njëjtës paraqesin veprimin e kryerjes së të pandehurit, e me këtë rast i pandehuri D. Gj. ka vepruar me dashje direkte. D. direkte vërtetohet nga vendosmëria e tij për ta kryer veprën penale, respektivisht vendosmëria e tij për të ardhur deri te pasoja fatale, fakti se ai është pajisur me eksploziv, e ka vendosur dhe aktivizuar të njëjtën janë prova që tregojnë se këtu i pandehuri ka vepruar me dashje direkte dhe e ka dëshiruar pasojën e shkaktuar, duke e vë në rrezik jetën e të dëmtuarit A. K..

*3.e.2. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës H.A., av. Prek Kola nga Gjakova, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: nga deponimet e dëshmimeve të dëshmitares F. A., G. A. dhe të dëmtuarit A. K. të dhëna në polici, prokurori si dhe në shqyrtim gjyqësor, si dhe provat tjera materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, konsideron se janë vërtetuar në tërësi faktet nga aktakuza nga se i akuzuari, siç është konstatuar në aktakuzë ka kryer veprat penale te vrasjes së rëndë dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve ku për pasojë ka mbetur i vdekur tani i ndjeri H. A.. Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua në tërësi se këtu i akuzuari D. Gj. me dt.14 10.2018 rreth orës 07:48 min, në fsh. S., Komuna Gjakovë ka privuar nga jeta tani të ndierin H. A. dhe me atë rast vënë në rrezik jetën e të dëmtuarit A. K. në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri rreth orës 02:30 min, ka vendosur një materie eksplozive në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë, tani të ndjerit H. A. dhe në momentin kur tani i ndjeri rreth orës 08:02 min, del nga dyert e oborrit dhe pikërisht kur tenton ti mbyll dyert e oborrit, i pandehuri nga një largësi e pa njohur përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K..*

Gjendja faktike sikur në aktakuzë u vërtetua nga dëshmia e të dëmtuarit A. K. i cili në të gjitha fazat si në polici, prokurori, si dhe në këtë shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se i njëjti është takuar disa herë më këtu të akuzuarin D. Gj. i cili më herët para rastit të vrasjes së H. A. t e ka njohur me nofkën si E. Gj. nga kjo dëshmi vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari është kryes i

veprës penale për të cilën akuzohet pasi dëshmia e tij është provuar edhe me prova tjera materiale nga deklarimi i tij vërtetohet se i akuzuari para kohës së kryerjes së veprës penale ka qenë tek shtëpia e të akuzuarit ku i njëjti në fund të vitit 2017 dhe fillim të vitit 2018 ka qenë në arrest shtëpiak në Shqipëri gjendje kjo faktike e vërtetuar edhe nga organet policore të Shqipërisë dhe vet nga dëshmia e të akuzuarit, po ashtu nga kjo dëshmi u vërtetua se i akuzuari ka qenë disa herë në Gjakovë ku është takuar me të ndjerin H. A. dhe ka banuar në shtëpinë e tij, në fsh. S. dhe tek shtalla në fsh. . . . u vërtetua se i akuzuari ka qëndruar në shtëpinë e H. A. t më shumë se një muaj ku i ka pasur edhe qelësat e shtëpisë duke përgatitur vrasjen e B. A. t, ndërkaq një javë para vrasjes së H. A. t i akuzuari me të ndjerin kanë prishur kinse raportet në mes veti me çka ka ardhur edhe deri tek vrasja e të ndjerit H. A., e ku kjo gjendje faktike ka mbështetje në dëshmitë e të dëmtuarve A. K. u vërtetua se para kohës së rastit të vrasjes së H. A. t i akuzuari kishte probleme shëndetësore intervenime në unazat e shpinës të cilën rrethanë e ka vërtetuar edhe vetë i akuzuari, po ashtu u vërtetua se para kohës së vrasjes i akuzuari në atë kohë kishte një vajzë dhe posedonte automjet të tipit Smart me të cilin kishte udhëtuar edhe në Kosovë, u vërtetua se ku kishte shtëpinë e banimit i akuzuari, pra kjo dëshmi e këtij dëshmitari vërteton të gjitha faktet dhe dëshmitë se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale.

Po ashtu nga deponimi i dëshmisë së dëshmitares F. A. është vërtetuar fakti se i akuzuari D. Gj. është kryes i kësaj vepre penale nga dëshmia e saj u vërtetua se i akuzuari e kishte kontaktuar babain e saj tani të ndjerë H. A. përmes rrjeteve sociale Facebook me adresat "Mirdita D." dhe adresën ". . ." dhe të akuzuarin e kishte njohur me nofkën e E. Gj. që tani është këtu i akuzuari D. Gj., nga kjo dëshmi u vërtetua edhe fakti se para vrasjes së H. A. t i akuzuari përmes rrjetit Facebook kishte kontaktuar duke i kërkuar që i ndjeri H. A. dhe bashkëshorti i saj A. K. të shkojnë tek i akuzuari në Shqipëri dhe po ashtu u vërtetua se pas rastit i akuzuari D. Gj. kishte kontaktuar përmes facebook duke kërkuar që të shkojë tek banesa e tyre për ti shprehur ngushëllime dhe në të njëjtën kohë duke i kërcënuar në vazhdimësi se kinse ky nuk është kryes i vrasjes së babait të saj, po ashtu nga dëshmia e saj u vërtetua edhe fakti se i akuzuari D. Gj. para vrasjes së të ndjerit H. A. i kishte dërguar foto në rrjetin Facebook ku komunikonte i ndjeri H. A. ku shihej një plagë në trupin e të akuzuarit se i njëjti është duke pasur probleme me unazat dhe shpinën, pra rrethanë kjo e cila është vërtetuar gjatë këtij shqyrtimi kryesor edhe nga vetë i akuzuari.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar edhe dëshmitarë e propozuar nga mbrojtja L. LL., L.Sh., P. B. dhe G. S., të cilave dëshmi gjykata nuk duhet të u falë besimin pasi këta dëshmitar kanë qenë të përgatitur nga mbrojtja se çka të flasin për të krijuar një alibi rreth ditës kritike dt.14.10.2018, se kinse i akuzuari me këtë datë është takuar me këta dëshmitarë për kryerjen e disa punëve rreth lokalit që kanë të bëjnë më rregullimin e shankit të lokalit, ku L. LL. nuk ka qenë në dijeni për ditën kur është takuar me të akuzuarin, dëshmitari L. Sh. nuk ka qenë në dijeni për datën kur ka qenë takimi me të akuzuarin, P. B. nuk ka qenë në dijeni për orën e takimit ndërsa dëshmitari G. S. nuk ka qenë në dijeni për asnjë gjë, pra këta dëshmitarë kanë qenë kundërthënës me vetveten po ashtu dëshmia e tyre ka qenë kundërthënëse edhe me dëshminë e të akuzuarit, pra gjykata këtyre dëshmitarëve nuk duhet të ju falë besimin. Ndërsa nga deponimi i provave tjera materiale siç janë raportet për hyrjet dhe daljet brenda shtetit të Shqipërisë dhe Kosovës është vërtetuar fakti se i akuzuari D. Gj. nga muaji shkurt 2018 e deri në fund të muajit shtator 2018 ka hyrë dhe dalur mbi 40 herë në pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ndërsa vërtetohet fakti se nga vrasja e të ndjerit H. A. i akuzuari deri në datën e arrestimit të tij në Shqipëri nuk ka bërë asnjë lëvizje duke hyrë në shtetin e Kosovës, mirëpo lëvizjet e tij janë në shtetet e tjera të Evropës, provat tjera materiale siç janë bisedat në rrjetet sociale në facebook është vërtetuar në tërësi se i akuzuari ka biseduar para dhe pas rastit me të ndjerin H. A. dhe po ashtu nga këto biseda në rrjetet sociale facebook ku nga komentet familjare të të akuzuarit është

vërtetuar se i akuzuari D. Gj. ka pasur nofkën E. Gj., më të cilën nofkë e ka njohur edhe familja e të dëmtuarit dhe i ndjeri H. A..

Gjykata mbrojtjes së të akuzuarit D. Gj. nuk duhet të ia falë besimin sepse i njëjti është në kundërshtim me provat materiale dëshmitë e dëshmitarëve e sidomos me dëshminë e të dëmtuarit A. K. i akuzuari në mbrojtjen e tij e mohon në tërësi se i njëjti ka pasur biseda përmes rrjeteve sociale facebook më të ndjerin H. A. dhe se është takuar fizikisht disa herë më të dëmtuarin A. K. në shtëpinë e tij në V. në një restorant në Prizren, tek shtalla në . . . në shtëpinë e të ndjerit H., në fsh. S. si dhe faktin se asnjëherë më parë nuk e ka takuar të dëmtuarin A. K.n. Dëshmia e të akuzuarit D. Gj. është kundërthënëse me vetveten për faktin se i akuzuari në dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor është munduar ti shmanget përgjegjësisë për veprën që e ka kryer duke krijuar edhe dëshmitarë të përgatitur nga mbrojtja të sugjeruar duke u munduar që të krijoj alibi se ditën kritike ka qenë në takim me këta persona se kinse ditën kritike e ka rregulluar shankin e lokalit të tij duke potencuar edhe sasinë e dërrasave gjerësinë dhe gjatësinë e tyre, ndërsa në pyetjet e prokurores nuk ju ka kujtuar se çfarë dite ka qenë ajo kur u taku me këta dëshmitar, po ashtu deklaratës së tij gjykata nuk duhet të ja falë besimin sepse i njëjti është munduar të bëjë mjegulli për gjykatën duke deklaruar se gjitha lëvizjet që i ka bërë të muajit shkurt 2018 e deri në shtator të vitit 2018 në Kosovë i ka bërë për shkak të punës dhe të një kali të tij që e ka pasur në gara tek një person në Kosovë ndërsa nuk e argumenton me asnjë provë materiale pretendimet e tij, dëshmia e tij është e pabesueshme për faktin se të akuzuarit kinse i kujtohet data kritike 14.10.2018 se ku ka qenë dhe më kënd është takuar bazuar në numrat e telefonit të cilat i ka nxjerrë në Shqipëri se atë ditë më cilët persona ka kontaktuar, pra këtë dëshmi i akuzuari deri me sot nuk e ka nxjerrë në gjykatë dhe nuk ka ofru prova se ka bisedu me këta persona ditën kritike, po ashtu dëshmia e tij është edhe në kundërshtim me faktin se i njëjti deklaron se lokalin e ka rregulluar në vitin 2018 në muajin shtator ku në atë kohë përfundon sezona, ndërsa në pyetjen e trupit gjykues deklaron se lokalin në emrin e bashkëshortes së tij e ka hapur në vitin 2019 dhe e ka quajtur me emrin ". . .", dhe po ashtu i akuzuari ka deklaruar se në pyetjen e mbrojtësit të tij se për rastin e vdekjes së të ndjerit H. A. ka kuptuar në vitin 2019 nga një polic i V.s A.K. i cili është vëllai i administratorit të Komunës së V.s i cili pa prezencën e tij me një polic që e kishte marr në pyetje kishte thënë që D. dyshohet për vrasjen e babës së A., pra në pyetjen e përfaqësuesit të dëmtuarit se gjatë kësaj periudhe pse nuk keni ardhur në Kosovë se ju kaq vonë keni kuptuar për vrasjen e H. A. t ndërsa në atë periudhe para vrasjes keni hyrë dhe dal mbi 40 herë në Kosovë i njëjti ka deklaruar se në atë kohë e ka pasur nusen në Itali dhe më është dashur të kujdesem për punët ndërsa kjo është në kundërshtim më atë që i njëjti më lartë deklaron se në vitin 2019 e kam hapur lokalin në emër të bashkëshortes së tij, pra gjykata nuk duhet me ja fal besimin mbrojtjes së tij pasi i njëjti i mohon të gjitha faktet për të ju shmangur përgjegjësisë për veprat e kryera.

Si palë e dëmtuar jemi të bindur se kryerës i veprave penale të përshkruara sikur në aktakuzë është i akuzuari D. Gj., i dëmtuari A. K. e identifikoj të akuzuarin dhe pohoj se është takuar me të mbi pesë herë, një herë ka qenë në shtëpinë e tij, po ashtu edhe dëshmitarja F. A. pohoj se ka biseduar përmes rrjetit facebook me të akuzuarin me adresën e të ndjerit H., e në rast se nuk ka qenë i akuzuari atëherë, shtrohet pyetja se pse të dëmtuarit kanë deklaruar një gjë të tillë sikur të mos e kishin njohur të akuzuarin, pra cili ka qenë interesi i tyre me i deklaruar faktet e tilla, po ashtu shtrohet pyetja se pse i akuzuari hyri në territorin e Kosovës nga muaji shkurt 2018 deri në muajin shtator 2018 mbi 40 hyrje dalje në territorin e Kosovës me atë të Shqipërisë deri një javë para vrasjes së H.së të cilat hyrje përputhen me deklarimin e të dëmtuarit A. K., ndërsa pas vrasjes i akuzuari i shkëputi gjitha vizitat në Kosovë edhe pse në vitin 2019 u vë në dijeni për vrasjen e H. A.t, shtrohet pyetja se pse i akuzuari krijoj alibi me dëshmitarët të cilët ishin kontradiktor në dëshmitë e tyre nuk e dinin datën dhe ditën e takimit dhe po ashtu as i akuzuari



nuk e dinte çfarë dite ishte kur është takuar me këta dëshmitarë pse ishte ditë e veçantë për të akuzuarin data 14.10.2018, ndërsa nuk i kujtohej data 24.12.2018 se ku ka qenë dhe më kënd ka qenë që është ditë me rëndësi, po ashtu shtrohet pyetja se si i dëmtuari A. K. dhe dëshmitarja F. A., e patën të njohur faktin se si quhej me nofkën i akuzuari si "E. Gj.j" po ashtu këta dy dëshmitar e patën të njohur faktin se i akuzuari ka qenë në masën e arrestit shtëpiak në Shqipëri në periudhën dhjetor 2017 fillim të fitit 2018, po ashtu shtrohet pyetja se si e patën të njohur faktin se i akuzuari gjatë asaj kohe ishte i sëmurë nga unazat e shpinës dhe i akuzuari i kishte dërguar foton e plagës, po ashtu shtrohet pyetja se si i dëmtuari A. K. e identifikon të akuzuarin se ku është takuar më të, se gjatë asaj kohe e ka pasur një vajzë dhe ka poseduar edhe automjet të tipit Smart, ndërsa shtrohet pyetja se pse i akuzuari bëri përpjekje përmes facebookut të bind të dëmtuarën F. A. se nuk është kryes i veprës në rast se i akuzuari nuk e ka kryer këtë vepër, pse i akuzuari nuk u paraqit vullnetarisht para organeve të drejtësisë pasi nuk e ka kryer veprën, shtrohet pyetja se si të dëmtuarit e kishin të njohur faktin se B. A. ishte larguar dy ditë para rastit nga Kosova, ashtu siç i kishte thënë i akuzuari D. Gj. të ndjerit H. se ti duhesh me shku në Gjermani kur du me kry vrasjen mos me qenë në Kosovë, pra gjitha këto fakte të cilat i dëmtuari A. dhe dëshmitarja F. A. i kanë deklaruar në të gjitha fazat e deklarimit në polici, prokurori dhe në këtë gjykatë japin bazë të mjaftueshme për të provuar dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe se këto fakte dhe deklarime janë të mjaftueshme për gjykatën për të provuar aktakuzën.

Andaj, konsideron se prokuroria ka ofruar prova të mjaftueshme, me anën e të cilave është argumentuar gjendja e fakteve nga aktakuza dhe kërkon që i akuzuari të shpallet fajtor për veprat penale të përshkruara sikur në aktakuzë dhe të dënohet sipas ligjit, dhe njëherit kërkojnë kompensimin e dëmit.

3.e.3. *Mbrojtësi i të pandehurit, av. Xhemajli Ademaj*, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Lidhur me pretendimet të ngritura nga Prokuroria, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për akuzën e cila i ngarkohet. Janë mbajtur disa seanca, gjatë të cilave janë dëgjuar shumë dëshmitarë, ekspert dhe janë administruar provat materiale lidhur me këtë çështje penale, para se të elaborojnë provat e administruara dhe dëshmitaret e dëgjuar, konstatojnë disa vërejtje të përgjithshme lidhur me parimet që e udhëheqin një procedim penal. Prezumimi i pafajësisë dhe parimi in dubio pro reo - janë artikuluar në të gjitha konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe janë të cekura po ashtu në nenin 3 dhe 7, paragrafi I të Kodit të Procedurës Penale. Ky prezumim, është paraparë edhe me nenin 6, paragrafi 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në nenin 31, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ashtu që sipas këtij parimi, barra e provës i takon Prokurorisë, që ajo të provojë fajësinë e të akuzuarit - përtej dyshimit të bazuar. Ashtu që, e gjithë përmbajtja e kësaj aktakuze në raport me të pandehurin D. Gj., është e mbështetur në pretendime të pabaza dhe të paargumentuara. Prokuroria duke vepruar në mënyrë të njëanshme, aktakuzën e mbështet në deklaratimet dhe deponimet e disa dëshmitarëve (kryesisht familjar të viktimës).

Dëshmitarja F. A. ka deklaruar se në momentin kur i është vlarë baba, ajo ka dyshuar se atë e ka vra D. Gj.. Kështu të njëjtit i ka dërguar SMS përmes FB, e i njëjti nuk ju është lajmëruar deri në 18:00 të mbrëmjes, ndërsa në deklaratën e vitit 2020 të dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Gjakovë ajo ka deklaruar se personi të cilit i ka shkruar SMS nuk ju është lajmëruar deri në ora 16:00. Në bazë të provave që i disponon, nuk është e qartë dhe nuk mund ta vërtetoj se me kë ka biseduar në të vërtetë dhe kënd e ka akuzuar për vrasjen e babait të saj. Prokuroria si provë ka paraqitur një bisedë të bërë në FB nga ana e dëshmitares F. A., e cila ka përdorë një llogari të paverifikuar me emër B.H., me një person të pa njohur i cili ka përdorë adresën e FB ". . .". Në fillim të bisedës në tabulate, ku mungon faqja e parë, supozohet se ka

drejtuar akuzë për vrasjen e babait të saj, mirëpo kur ky person i përgjigjet me fjalët: "qa thua oj motër a je në terezi". Më pas ajo e shfaqëson atë duke i thënë: "jo ti jo, për B. horin kam thanë, na tradhtoi apet", duke e drejtuar akuzën për vrasjen e babit të saj ndaj një personi të quajtur B. i cili është djali i axhës së saj me të cilin janë në hasmëri për shkak se para disa viteve në vitin 2013 axha i saj A., i cili është baba i B.t, kishte vrarë vëllain e saj, A. A.n. Në këtë tabulat shihet se biseda e zhvilluar në mes dëshmitares F. A. (B.H.) me personin X përmban në vete elemente ngushëlluese ndaj dëshmitares, nuk përmban elemente kërcënuese nga ana e personit X në drejtim të dëshmitares. Po ashtu dëshmitarja pretendon se ka pranuar kërcënime nga personi X para dhe pas vrasjes së babait, ndërsa këto biseda ka thënë se nuk i ka ruajtur. Shtrohet pyetje se përse ka ruajtur një bisedë kurse të tjerat i ka fshirë? Nëse shohim deklaratat e dhëna nga dëshmitarja pranë prokurorisë në dt. 22.07.2020 dhe 22.09.2021, aty mund të gjejmë shumë kundërthënie pasi që në pyetjet e njëjta të parashtruara nga prokuroria ka dhe përgjigje të ndryshme, edhe pse në 2020 ngjarjen e ka pasur më të freskët dhe e ka kujtuar ma mirë. Në deklaratën e saj të vitit 2020, ajo asnjëherë nuk mund të vërtetoj se e ka njohur personalisht të pandehurin, se është takuar, se ka komunikuar me të, kurse në deklaratën e vitit 2021 ka ndryshuar deklaratën e saj dhe ka shtuar me siguri të plotë dhe të vetëdijshme se ka komunikuar me të pandehurin D. Gj..

Dëshmitari A. K. në dëshmitë e tij të dhëna në prokurori, me datën 18.06.2020 në pyetjen meqenëse jeni shoqëruar shpesh me H., a të ka treguar ndonjëherë për kontaktet e tij me ndonjë person nga Shqipëria. I njëjti është përgjigjur: Jo nuk ka pas asnjë bisedë për ndonjë person e që ka mundur të jetë nga Shqipëria, ai ndoshta ka pas ndonjë kontakt, por thënë të vërteten mua nuk më ka treguar ngase ai ka pasur sekretet e tij. Në deklaratat e dëshmitarit A. K. mund të gjejmë shumë kundërthënie pasi që në pyetjet e njëjta të parashtruara nga prokuroria ka dhënë përgjigje të ndryshme. Dëshmitari ka deklaruar se në ditën kritike kur është vrarë H. A. nuk është në dijeni se D. Gj. ka qenë në Kosovë, pikërisht në Gjakovë, andaj dyshimi i tij se D. Gj. ka kryer vrasjen nuk është bazuar në asnjë provë të vetme. Dëshmitari ka deklaruar se bashkëshortja e tij, dëshmitarja F. A., ka pranuar mesazhe para dhe pas vrasjes së viktimës H. A. dhe atë në mesnatë të dt. 13 dhe 14 Tetor, po ashtu edhe pas vrasjes. Ai deklaron me siguri të plotë se bashkëshortja e tij ka biseduar me "D. Gj." i cili ka kërkuar të takohet me të dhe ka kërkuar sqarim se pse e kanë denoncuar në polici si vrasës të mundshëm. Në tabulatet nga biseda e zhvilluar në FB në mes dëshmitares F. A. e cila ka përdorur llogarinë me emrin "B.H." dhe një personi X i cili ka përdorur llogari me emrin ". . ." ajo zhvillon bisedën me një person të panjohur dhe në asnjë moment nuk përmendet emri i të pandehurit D. Gj.. Kurse për të pandehurin D. Gj. ka deklaruar se: "Ai nuk e ka kanosur askënd dhe nuk i ka shënuar askujt fjalë".

Sa i përketë deklarimeve të dëshmitarëve G. A., F. A. P. ka konsideruar se të njëjtave nuk duhet falur besimin sepse nuk provojnë asgjë dhe se deklarata e dëshmitarit G. A. duhet të vlerësohet si e njëanshme dhe e pabazuar: pasi që e tërë deklarata nuk ka asnjë kuptim dhe nuk mund të bazohet në asnjë provë dhe ti falet besimi. Ndërsa deklarata e dëshmitares F. duke mos qenë personalisht në dijeni mbi zhvillimet e ngjarjeve të cilat kanë qar deri të vrasja e babait të saj, është e bazuar në tregime të treguara nga familjaret e saj lidhur me ngjarjen. Andaj, mbrojtja e D. Gj., konsideron se dëshmitarët: F. A., A. K., G.A. dhe F. A.-P., në këtë çështje penalo-juridike e kanë vetëm cilësinë e palës së dëmtuar. Dëshmia e tyre për ngjarjen e ditës kritike bazohet krejtësisht në atë që e kanë dëgjuar nga të tjerët dhe në rrethanat para ndodhjes se ngjarjes së ditës kritike dhe pas saj.

Deklaratat e dëshmitarëve G. B., S. B. dhe L. A. nuk kontribuojnë asgjë për çështjen penale, përveç një përpjekje e prokurorisë që të krijoj huti dhe humbje kohe për tërë procesin gjyqësor, andaj propozimi i këtyre dëshmitarëve nga prokuroria e shtetit nuk i kontribuon fare zbardhjes së çështjeve kontestuese dhe në asnjë moment nuk e mbështet përshkrimin faktik të akuzës e që është objekt i kësaj çështje penale.

Dëshmitarët nga Republika e Shqipërisë L. Sh., L. LL., P. B. dhe G. S. dëshmitë e këtyre dëshmitarëve nga Republika e Shqipërisë, janë dëshmi të cilat tregojnë që i mbrojturi i tij ka qenë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe e vërteton takimet fizike dhe teknike përmes telefonave që e vërteton komunikimi i vërtetuar në tabulate të nxjerra nga operatori Vodafon të lëshuar me datën 01.09.2020 për datat 01.10.2018 deri me 31.10.2018, andaj, deklaratat e lartcekura të 4 nga 5 dëshmitarëve, tani veç se janë administruar si prova të pranueshme në këtë gjykatë dhe si të tilla kanë fuqi provuese. Deklaratat e të lartcekurve janë të besueshme, sepse të njëjtat janë nën betim dhe se nuk kanë ndonjë afërsi më të akuzuarin që do të mund të aludohej në njëanshmëri. Për më tepër deklaratat e të lartcekurve kanë lidhmëni mes tyre dhe të gjitha këto deklaratat nxjerrin një përfundim, që ditën kritike i mbrojturi im ka qenë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Dëshmitarja-ekspertja Sh. G. - F., Eksperte në AKF ka sqaruar, se ky softuer përdoret për pasimin e pamjeve dhe qartësimin e pamjeve, ky softuer është i licencuar nga AKF. Ekspertiza e ekspertës Sh. G. - F. nuk ka bërë identifikimin e personit, mirëpo vetëm pastrimin e pamjes, mirëpo edhe pas pastrimit të pamjeve, sipas mbrojtjes nuk mund të identifikohet kryesi i kësaj veprë penale. Andaj, kjo provë është provë pa ndonjë konkludim përfundimtarë dhe nuk mund të faktohet se kryerës i veprës penale është D. Gj.. Provat me të cilat pretendohet të vërtetohen se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale, duhen të jenë të qarta dhe konkrete dhe në bazë të ekspertizës të faktohej në mënyrë decisive që i mbrojturi i tij kishte qenë kryerësi dhe se çdo pa qartësi në kuptim të këtyre provave në asnjë formë nuk mund ti mvishet të mbrojturit të tij, në të kundërtën konsideron se do të ketë shkelje flagrante të parimit bazë të dispozitave të Kodit të procedurës mbi parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimit in dubio pro reo, parime këto të mbrojtura edhe me Kushtetutë dhe me aktet më të larta ndërkombëtare.

Nga Raporti i Autopsisë MA 18-311, dt. 14.10.2018, është përshkruar se viktimi ka pas 18 plagë të jashtme në formë të djegieve lëkurore dhe 7 plagë të brendshme në kokë, të gioksit, klavikulën dhe brinjët në rajonin e majtë të gioksit, shqyerje të sistemit arterialë etj.

Raportet e ekspertimit të gjurmëve daktiloskopike me nr. AKF/2019-0545/ 2019484 DT. 25.06.2019; Raporti i ADN-së me nr. AKF/2019-0545- 483 dt. 16.10.2019/2019; Raporti i ekspertimit balistik të laboratorit të AKF-së për analiza zjarrvënie dhe eksploziv me nr. AKF/2019-0070; Raporti i ekspertimit të AKF-së, AKF/2019-0545 / 2019 (lt. 07.03.2019, Ekspertizat të cilat janë kryer në Agjencionin e Kosovës për Forenzike tregojnë saktësinë dhe realitetin se D. Gj. s'ka qenë fare në vendin e ngjarjes me datën 14.10.2018. Prandaj kërkon nga trupi gjykues që ti pranon këto ekspertiza pasi që në këtë Agjencion punohet sipas standardit më të lart në botë ISSO 17025, dhe ekspertet e këtij Agjencioni janë të testuar çdo vit nga kompania e njohur Amerikane Forensic Proficiency Testing Collaborative Testing Services (CIS).

Nga raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë Rezulton se D. Gj. me dt. 30.09.2018, në ora 14:33 minuta, ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, edhe kjo provë asgjë nuk e lidh të dyshuarin me rastin dhe me 06.10.2018, ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, bazuar në dokumentin e datës 30.10.2023 lëshuar nga Drejtoria e Policisë Shkodër, me nr. prot. 497. Me këtë vërtetohet se D. Gj. nuk ka qenë në Kosovë me datën 14.10.2018.

Procesverbali për identifikimin e të dyshuarit të dt. 06.10.2020 nga A. K., në fotografinë me nr. 5, se gjoja e ka identifikuar si D. Gj., konsideron se kjo provë është marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe është marrë në kundërshtim me dispozitat e kodit të procedurës penale. Se është në kundërshtim me ligjin dhe e sajuar tregon fakti se me datën 18.06.2020, në pyetjen e parashtruar dëshmitarit A. K.: "A e njeh D. Gj.", dëshmitari është përgjigjur: "nuk e njoh". Me rastin e marrjes së një prove të lartcekur dëshmitari duhet ti bëhet me dije se a është e rëndësishme që dëshmitari të specifikoj-identifikoj personin, është po aq e rëndësishme që i njëjti të shpjegoj po që se nuk është i sigurtë e jo të pretendoj të "qëlloj" dhe se dëshmitari në fjalë vetëm ka aluduar, sepse ka kontradikta në mes vete, sepse njëherë e ka identifikuar e pastaj thotë se nuk e njeh, që rrjedhimisht një provë e tillë është kontradiktore, e pambështetshme në prova tjera dhe si e tillë është e pabesueshme për të ja mveshur fajësinë të mbrojturit përkitazi me këtë vepër penale.

Tabulatet e komunikimit nga llogaria e FB në mes të: "B.H." dhe ". . .", mbrojtja i kundërshton këto tabulate, pasi që të njëjtat nuk mund të vërtetojnë me saktësi se cilët kanë qenë personat e vërtetë të cilët kanë shfrytëzuar këto llogari për të komunikuar. Prokuroria ka arritur të dëshmojë se me kë ka biseduar dëshmitarja F. A. e cila pretendon se ka përdorur llogarinë e FB me emrin "B.H.", prokuroria asnjëherë nuk e ka pyetur dëshmitaren se pse ka përdorur një llogari me emër të rremë dhe jo me emrin e saj të vërtetë. Andaj, as dëshmitarja nuk ka arritur të vërtetojë me saktësi se personi me të cilin ka zhvilluar bisedën ka qenë në të vërtetë i pandehuri D. Gj., i cili gjëja ka përdorë adresën e FB ". . .". E që në rastin konkret prokuroria ka mund të marr prova me masa të veçanta hetimore në mënyre që të identifikohet kush ka qenë përdoruesi i userit të FB me të cilin ka kontaktuar e lartcekura dhe në mungesë të një prove të tillë nuk mund të argumentohet se me kë ka biseduar ajo dhe krejt ky argument mbetet vetëm në suaza të supozimeve, ndërsa aktgjykimi i gjykatës mbështetet vetëm në prova konkrete.

Nga CD-ja, me video incizim 2018-EA-1124 dt. 14.10.2018, rezulton se ky incizim është marrë nga kamerat e sigurisë të shtëpisë së viktimës. Në këtë video incizim vërtetohet se më dt. 14.10.2018, rreth orës 02:03:02, një person i gjinisë mashkull vendos diçka në kutin postare të shtëpisë së të dëmtuarit, ky person nga video incizimi dyshohet se çalon dhe ka të veshura një pallto të zezë i mbuluar me kapelë dhe pantallona ushtarake. Në këtë video incizim, nuk mund të identifikohet dhe nuk rezulton se kush është personi i dyshuar dhe që në asnjë formë nuk mund të vërtetohet se ky person është i mbrojturi i tij.

Raporti i Sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.l.-së, me nr. të dosjes 168-FVTI-2018 dhe nr. i dosjes së hetimit 2018-EA-1124, nuk mund të vërtetojë se i dyshuari D. Gj., është kryerës i veprës penale për të cilën dyshohet.

Raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe dosja hetimit 2018-EA-1124, raporti shtesë i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të dosjes forenzikës NJETK -EA — 1124, tabela e matjeve dhe skicimi i vendit të ngjarjes dhe raporti pas operacional i Njësisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive me nr. ref./ 04/2-01 E/2016-A/2018 dhe raporti i rekonstruimit të datës 22.06.2023, nuk nxjerrën asnjë

përfundim për prezencën e D. Gj. në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur eksplozioni. As deklarata e ekspertit të eksplozivëve deklaruar në gjykatë me datën 20.10.2023, S. S. me ç'rast deklararon, se ka qenë një eksploziv i vendosur në kutinë postale dhe i punuar në mënyrë artizanale por të gjitha pjesët e saj nuk kanë mundur të identifikojnë kryerësin e as vendin e tij në momentin e aktivizimit me detonatorë.

Raporti ekzaminues i Institutit Forenzik në Cyrih Zvicër — përpiluar nga ekspertet Dr. R. H., Shef i Departamentit të Biometrisë dhe i kontrolluar nga J.A., Zv. Drejtor i Institutit. Me rast kanë nxjerr përfundim se: Cilësia e imazhit të sekuencës së videos nuk lejon që të bëhet ndonjë deklaratë në lidhje me identitetin e personit në fjalë të shfaqur (fotografuar). Prandaj, një ekzaminim ekzaminues krahasues me njerëz të njohur nuk lejon të nxirret përfundime. Pra, ky ekzaminim dhe dy tjera të bëra më herët nga AKF-së dhe Drejtoria e Teknikës Kriminallistike D. Gj. nuk është vërtetuar që ka qenë në vendin e ngjarjes.

Lista e dëshmimeve me nr. të dosjes së forenzikës 2018-DTK-039 VN- dhe hetimit 2018-EA1124. Në asnjërin raport të ekspertizave të lartcekura nuk është vërtetuar se i dyshuari D. Gj. është kryes i mundshëm i veprës penale për të cilën dyshohet.

Pra, nuk ka prova të drejtpërdrejta e as të tërthorta që argumentojnë fajësinë e të akuzuarit, por vetëm supozime dhe se e gjithë aktakuza është ngritur duke u bazuar në dëshmi të dëshmitarëve të cilat këto dëshmi nuk mundën ti vërtetojnë dhe po ashtu as ekspertizat shkencore nuk e vërtetojnë që kryerës i veprës penale është i akuzuari D. Gj.. Prokuroria e shtetit në aktakuzën PP/I. nr. 249/2020, nuk ka paraqitur një analizë të mirëfilltë dhe gjithë përfshirëse të provave, ku sipas mbrojtjes rezulton me një aktakuzë të pa bazuar.

Nga raporti i autoriteteve të Shqipërisë lidhur me numrin e telefonit të D. Gj. . . është siguruar IMEI për periudhën 01.09.2018 deri me 30.10.2018, ku ka rezultuar se me datën 11.09.2018 në ora 11.18 minuta ka figuruar se është kyçur në antenën në jug të Peshkopisë, në ora 14.49 minuta, në . . . në afërsi të aeroportit të Kukësit. Kjo datë nuk ka kurrfarë lidhshmërie me datën e ngjarjes në fshatin S., KK. Gjakovë, me datën 14.10.2018. Andaj si e tillë zbardh pafajësinë e të mbrojturit.

Andaj, mbi argumentet e lartcekura, mbrojtja i propozon dhe pretë që do të merret Aktgjykim lirues për të akuzuarin D. Gj..

*3.e.3. I pandehuri D. Gj., në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij, dhe ka shtuar dy gjëra që e brejnë dhe e shqetësojnë shumë, e para që e quajnë verë muajin Tetor, dhe e dyta që e paragjykojnë sikur është papa i Romës, dhe nuk duhet të punojë të dielën ku ka deklaruar se është bujk, dhe punon 365 ditë të vitit, duke shtuar se ndihet plotësisht i lirë dhe i pafajshëm.*

### *3.f. Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor*

Me datë 15.03.2024, gjykata e ka shpall të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

### *3.g. Shpallja publike e aktgjykimit*

Me datë 20.03.2024, gjykata e ka shpall publikisht aktgjykimin, në prani të mbrojtësit të të akuzuarit, av. Xhemajl Ademaj dhe të dëmtuarve A. K. dhe G. A., e në mungesë të palëve tjera në procedurë.

#### 4. Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave si dhe vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk është provuar që i pandehuri D. Gj., e ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1, pika 1.5 të të KPRK-së, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i pandehuri me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitiv nën I, të këtij aktgjykimi, me dashje ka privuar nga jeta viktimën – tani të ndjerin H. A. dhe atë përmes vendosjes së një materie eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë tani të ndjerit H. dhe përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi mbetet në vend i vdekur, dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., e po ashtu nuk është provuar ta ketë kryer edhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i pandehuri me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitiv nën II, të këtij aktgjykimi, e ka vendosur materien eksplozive në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë (kutin postare) së tani të ndjerit H. dhe aktivizuar materien përmes teledirigjimit, e nga i cili shpërthim ka marr lëndime trupore i dëmtuari A. K..

#### 4.a Faktet jokontestuese

Gjykata, si fakte që nuk janë kontestuar nga palët dhe kanë mbështetje në prova, ka vlerësuar:

-4.a.1. Faktin se me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv I, të këtij aktgjykimi, pasi që viktimës rreth orës 02:30 minuta, i ishte vendosur një materie eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë (kutin postare) së tani të ndjerit H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, ashtu që i njëjti derisa ishte duke dal nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll derën e oborrit, materia eksplozive përmes teledirigjimit aktivizohet, ku nga ky shpërthim mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., si dhe

-4.a.2. Faktin se me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv I, të këtij aktgjykimi, në vend të ngjarjes është përdorur materie eksplozivi e tipit dhe natyrës së panjohur, e i cili eksploziv ditën kritike rreth orës 08:02 min, aktivizohet përmes teledirigjimit duke privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës.

Faktet e lartcekura, nuk kanë qenë kontestuese ndërmjet palëve. Për më tepër, këto fakte vërtetohen edhe përmes provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pra, nga dëshmia e të dëmtuarit A. K., dëshmitarët F. A. dhe G. A., dhe ekspertet Sh. G. F. dhe S. S. nga IEDD, i cili ka marrë pjesë edhe me datën 22.06.2023 në rikonstruimin e vendit të ngjarjes, të cilët janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve dhe e kanë pohuar faktin se me datë, kohë, vend dhe në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi përmes teledirigjimit është aktivizuar materia eksplozive dhe nga shpërthimi mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K..

Po ashtu edhe mbrojtja, nuk e konteston faktin se rreth orës 02:30 min., është vendos në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., kurse në ora 08:02 min., përmes teledirigjimit është aktivizuar materia eksplozive dhe nga shpërthimi mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K..

Gjykata, faktet e lartcekura i ka marrë si të vërtetuara dhe nuk e ka parë të arsyeshme të lëshohet në arsyetimet e mëtejme, lidhur me këto fakte, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar nga palët, e njëherit kanë mbështetje edhe në provat materiale, të cilat janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cekura si më lart.

#### 4.b. Faktet kontestuese

Gjykata, si fakte kontestuese ka vlerësuar:

-4.b.1. Faktin *nëse* i pandehuri D. Gj., me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv I, të këtij aktgjykimi, ka vendosur një materie eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë tani të ndjerit H., e në momentin kur i ndjeri rreth orës 08:02 min., del nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll derën e oborrit, i pandehuri nga një largësi e panjohur, përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., si dhe

-4.b.2. Faktin se me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv II, të këtij aktgjykimi, *i pandehuri* ka poseduar materie eksplozivi të tipit dhe natyrës së panjohur e të cilin eksploziv ditën kritike rreth orës 08:02 min., e aktivizon në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi duke privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës.

Gjykata, për ta zgjidhur këtë fakt, gjatë procedurës së provave, me propozimin e prokurores së shtetit, në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar dëshmitarët: A. K., F. dhe G. A., G. B., S. B. dhe L. B., si dhe të pandehurin D. Gj..

Po ashtu, gjykata, për ta zgjidhur këtë fakt, gjatë procedurës së provave, me propozimin e mbrojtjes, në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar dëshmitarët: L. Sh., L. LL., P. B. dhe G. S..

#### 5. Vlerësimi i provave nga ana e Gjykatës dhe ndërlidhja e tyre në raport me veprimet e të pandehurit

5.1. Me dëgjimin e të dëmtuarës-dëshmitares F. A., gjykata ka vërtetuar se me dt.14.10.2018, babai i saj e kishte lënë me burrin (A.) me shku për të bërë pazar për pasterm, në fshatin . . . , atë ditë burrin e kishte lutur që mos të shkonte kaq herët se ishte ditë pushimi, kurse bashkëshorti i kishte kërkuar që të vazhdoj të flejë, ndërsa e njëjta i kishte kërkuar që të ja sjell nënën, pasi që nëna ishte në banesë, dhe gjersa isha duke biseduar me nënën se kishte fol e njëjta me babën dhe i kishte treguar se është një sinjal i keq, se B. ka ikur jashtë vendit qe dy ditë, në ato momente e kishte thirr burrin në telefon duke i treguar se, nëna është ka pret për të shkuar, ndërsa i njëjti i kishte thënë: Hajt, hajt, dhe e ka ndalur telefonin, kurse pastaj e kishte telefonuar qika e axhës - qika I., dhe ajo i kishte thënë: “*Se a e dinë çka ka ndodhur në S. ?*”, ku e dëmtuara ia ka ndalur telefonin dhe e ka thirr A., duke i thënë: Se çfarë ka ndodhur me bacën Xhi (H.), i cili është përgjigjur me fjalët: Mina, mina, dhe e kishte pyetur: Se a është gjallë, A. i kishte thënë: Jo, H. ka vdekur. Tutje në deklarinimin e saj ka pohuar se me B.n janë në hasmëri, kurse me D. së pari ka shkruar në llogarinë “Mirdita D” në Facebook, pastaj i kishte thënë, që kurrë më mos më shkruaj në këtë llogari dhe i kishte dhënë adresën tjetër “. . .”, pastaj përmes asaj adrese e njëjta dhe babai i saj kanë kontaktuar me D, pasi që D kishte ardh për ti ndihmuar babait të saj për ta nxjerrur gjakun e A., dhe ishte me arsyetimin se D kishte qenë shok i të ndjerit A. A. - djalit të tani të ndjerit H. A.t dhe shuma për këtë vrasje ka qenë, 250.000,- 300.000,-€, por sipas

dëshmitares këto të holla nuk ja ka dhënë sepse nuk i ka kërkuar, por e di se i ka marrë dy herë nga 100 euro për shpenzime të rrugës. Ndërsa D. kur kishte ardhur në Gjakovë, fillimisht kishte shkuar tek pllaci ku është në . . . për ta shikuar vendin e për ta kryer vrasjen e B.t, kurse më pas ka qëndruar tek shtëpia në fshatin S.. Pretendon se ishte plan i D. që ajo me burrin e saj të mendojnë se D. me babën janë prishur në pazar, kjo ka ndodhur një herë, por e vërteta është se asnjëherë nuk janë prishur, nuk e din nëse ndonjëherë babai i saj ta ketë shoqëruar me veturë D., por e di se kur babai i saj e ka pasur kontaktin e fundit me këtë personin nga Shqipëria, i ka thënë që ta qojë deri në Stacionin e autobusëve në Gjakovë, dhe kur e ka dërguar deri në stacion babai është larguar dikund fshehurazi për ta parë nëse po shkon me autobusë, por i njëjti kishte dal nga stacioni, ku kjo gjendje ka qenë dikund 2-3 javë para se të vritej babai dhe këtë informacion e ka siguruar nga prindi i saj, ndërsa një natë para natës kritike i kishte ardhur një mesazh nga D, duke i kërkuar që ti thotë babës edhe burrit që të vijë në Shqipëri se është duke e ndrequr një çati dhe nuk mund të vijë në Kosovë, dhe para se të ndërrojë jetë babai për herë të fundit kishte qenë në fshatin S., një javë para ditës kritike ku edhe ka fjetur dhe qëndruar i vetëm tek shtëpia në fshat. Gjykata, këtyre deponimeve të dëshmitares - dëmtuarës ia fali besimin, pasi që të njëjtat në tërësi përputhen edhe me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, por edhe me dëshminë e dëshmitarit A. K., por që për çështjen në fjalë nuk kanë ndonjë relevancë sepse një deklaram i tillë ishte i orientuar në shpjegimin e planit që kishte babai i saj për vrasjen e B. A.t në shenjë të gjakmarrjes, e nuk argumentojnë asgjë në lidhje me veprimet e ndërmarra në drejtim të vrasjes së tani të ndjerit H. A..

Mirëpo deklarimeve të saj, se:

- një njeri i panjohur për babën e saj nuk e di si i afrohet për ta vrarë një njeri;
- një natë para natës kritike i kishte ardhur një mesazh nga D, duke i kërkuar që ti thotë babës edhe burrit që të vijë në Shqipëri se është duke e ndrequr një çati dhe nuk mund të vijë në Kosovë;
- pas ndodhjes së rastit dhe para se të shkonte në S., i kishte shkruar D, duke e akuzuar se i ka vrarë babën, dhe për me i zhdukur gjurmët pasi që burri i saj i dinë të gjitha të vërtetat dhe njihet me D., dhe ka dashur me ja vra edhe burrin;
- D. e kishte kërcënuar se nëse zbulohet ndonjëherë, e njëjta ka me u vra me burrë e me fëmijë, duke shtuar i njëjti i ka kërkuar edhe fotot e fëmijëve ku ia ka dërguar, e po ashtu kishte kërkuar edhe foton e djalit të A ndërsa këto prova nuk i ka ruajtur me arsyetimin se D e ka pasur passwordin dhe asnjë gjurmë nuk e ka lënë, veç gjurmët që kanë mbetur pas vrasjes;
- sipas të dëmtuarës i pandehuri D e kishte kërcënuar me fjalët: se ti mua ma ke borxh jetën, ndërsa pasi që ka dhënë deklaratë në polici dhe ka dal nga SP, e kërcënonte dhe i dërgonte disa plagë që e kishte bërë shpinën operacion dhe më thoshte se ti me burrin tënd keni me pësuar pasi që më keni lajmëruar në polici dhe më keni borxh jetën, duke shtuar se e ka kërcënuar me jetë dhe më ka thënë se nëse unë dënohem nga organet e shtetit të Kosovës, do të më rrezikohet jeta, ashtu që nga frika e këtyre kërcënimeve që 3 vite nuk ka shkuar në Shqipëri;
- se ditën kritike D. ka qëndruar në Gjakovë dhe e ka kryer vrasjen, e bazon me vet faktin se i njëjti ka kërkuar me këmbëngulje me ardh për ngushëllime;

Këtyre deklarimeve të dëshmitares - dëmtuarës gjykata nuk ua fali besimin për shkak se deklaramet e saj nuk gjejnë mbështetje në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, fillimisht deklarimi i saj se *një njeri i panjohur për babën e saj nuk e di si i afrohet për ta vrarë një njeri*, është në kundërshtim me deklaramin e dëshmitarit A. K. (bashkëshorti i saj), i cili ka deklaruar se: *“në fund të vitit 2017, i ka shkruar D në Messenger me kërkesën e H.”*, pastaj kur e analizojmë deklaramin e saj të dhënë në prokurori, ku deklaroi se i kishte kërkuar babait të saj që ti lëshoj kamerat e shtëpisë në fshatin S. ngase ato për një vit nuk kanë



funksionuar meqenëse D. i kishte thënë që ti ndalin, ky deklaram i saj është në kundërthënie me deklaramin e dhënë në shqyrtim gjyqësor pasi që pohon se D. tek shtëpia e babait të saj në fshatin S., kishte qëndruar afër dy muaj para vrasjes, ku një muaj përpara i kishte kërkuar, që ti largoj qentë prej S.s dhe me u siguru që kamerat të mos punojnë. Një deklaram i tillë është në kundërshtim edhe me *raportin e sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës*, nga i cili raport është konstatuar se, D. Gj. me dt. 11.09.2018, në ora 10:32 minuta, ka hyrë në territorin e R. së Kosovës përmes pikës kufitare të Vërmicës. Me dt. 30.09.2018, në ora 14:33 minuta, i pandehuri ka hyrë në territorin e R. së Kosovës, e që nga kjo rezulton se nuk ka të dhëna tjera se i pandehuri të ketë hyrë në territorin e Rep. së Kosovës para datave të lartcekura si dhe nga deklarata e dëshmitarit A., ku pohon se nuk ka dijeni se cila ka qenë arsyeja e prishjes së kamerave, por veç e dinë se kabllot të cilat kanë qenë nëpër oborr kanë qenë të këputura, por kush e si i ka këputur nuk e dinë. Pastaj pretendimi tjetër se pas ndodhjes së rastit dhe para se të shkonte në S., e njëjta i kishte shkruar D., duke e akuzuar se i ka vrarë babën, dhe për me i zhdukur gjurmët pasi që burri i saj i dinë të gjitha të vërtetat dhe njihet me D, ka dashur me ja vra edhe burrin, e njëjta duke pretenduar se D. e kishte kërcënuar se nëse zbulohet ndonjëherë, ka me u vra me burrë e me fëmijë, duke shtuar se i ka kërkuar edhe fotot e fëmijëve ku ia ka dërguar, e po ashtu kishte kërkuar edhe foton e djalit të A, ndërsa këto prova nuk i ka ruajtur me arsyetimin se D. e ka pasur passwordin dhe asnjë gjurmë nuk e ka lënë, veç gjurmët që kanë mbetur pas vrasjes dhe se i pandehuri vazhdimisht e kishte kërcënuar me fjalët: *“se ti mua ma ke borxh jetën dhe i thoshte se ti me burrin tënd keni me pësuar pasi që më keni lajmëruar në polici dhe më keni borxh jetën, duke shtuar se e ka kërcënuar me jetë dhe i ka thënë se nëse dënohet nga organet e shtetit të Kosovës, do t'i rrezikohet jeta”*, një deklaram të tillë e ka mohuar dëshmitari A. K. (bashkëshorti i të dëmtuarës- dëshmitares F.), duke sqaruar se përveç mesazheve që ka kërkuar sqarim se kush e ka iniciuar rastin, atë nuk e ka kanosur askush, dhe nuk ka njohuri se nusja e tij është kërcënuar nga D. Gj. dhe po ashtu nuk ishte në dijeni për këto kërcënime, e për këtë nuk ka prezantuar ndonjë provë me të cilat provohet se e ka paraqitur rastin në polici dhe janë njoftuar organet e rendit për këto kërcënime. Pretendimin se ditën kritike D. ka qëndruar në Gjakovë dhe e ka kryer vrasjen, e bazon në faktin se i njëjti ka kërkuar me këmbëngulje me ardh për ngushëllime, por këtë pretendim të dëshmitares – dëmtuarës gjykata e mori si të pabazuar, pasi që nga *raporti i sistemit për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës*, nga i cili raport është konstatuar se, D. Gj. me dt. 11.09.2018, në ora 10:32 minuta, ka hyrë në territorin e R. së Kosovës, përmes pikës kufitare të Vërmicës. Me dt. 30.09.2018 në ora 14:33 minuta, i pandehuri ka hyrë në territorin e R. së Kosovës, e që nga kjo rezulton se nuk ka të dhëna tjera se i pandehuri të ketë hyrë në territorin e Rep. së Kosovës para datave të lartcekura si dhe nga *raporti i autoriteteve të Shqipërisë lidhur me telefonin e të pandehurit D. Gj. është siguruar Imei për numrin e telefonit . . . e Operatorit Vodafone për periudhën kohore nga dt. 01.09.2018 deri me dt. 30.10.2018*, nga ky raport rezulton që me dt. 11.09.2018 në ora 11:18 minuta, ka figuruar që është kyçur në antenën në jug të Peshkopisë, në ora 14:49 minuta në . . . në afërsi të aeroportit të Kukësit, e po ashtu dëshmitari A. për këtë pretendim të bashkëshortes së tij – dëshmitares F. se i pandehuri ka qëndruar në Gjakovë dhe e ka kryer vrasjen nga rrjedh edhe dyshimi që D, mund të jetë vrasës i të ndjerit H. A. nuk ka përgjigje, dhe nuk ka dëshmi tjetër se i pandehuri është kryes i mundshëm i vrasjes së H., e duke u bazuar edhe në *raportin ekzaminues të Institutit Forenzik në Cyrih Zvicer* - përpiluar nga ekspertet Dr. R. H. Shef i Departamentit të Biometrisë dhe i kontrolluar nga J.A. Zv. Drejtor i Institutit, kanë nxjerr

përfundim se: Cilësia e imazhit të sekuençës së videos nuk lejon që të bëhet ndonjë deklaratë në lidhje me identitetin e personit në fjalë të shfaqur (fotografuar). Prandaj, një ekzaminim krahasues me njerëz të njohur nuk lejon të nxirret përfundime. Pra, nga ky ekzaminim dhe dy tjera të bëra më herët nga AKF-së dhe Drejtoria e Teknikës Kriministike, nuk është vërtetuar që personi i cili shihet në kamerat e sigurisë së shtëpisë së tani të ndjerit dhe i cili e ka vendosur eksplozivin në kuti postare, të ketë qenë këtu i pandehuri D. Gj..

Andaj, bazuar në të cekurat si më lart, gjykata ka ardhur në përfundim se mbështetur në dëshminë e të dëmtuarës, nuk janë vërtetuar faktet se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, gjithmonë duke marrë parasysh se të gjitha deponimet e saj argumentojnë faktin se i ndjeri së bashku me A. dhe këtu dëshmitaren-dëmtuarën F., për një kohë të gjatë kanë bërë plane për një vrasje tjetër, dhe dëshmia e saj e dhënë në gjykatë nuk argumenton asnjë fakt sa i përket faktit se i pandehuri ka bashkëpunuar me ndonjë person tjetër (B. A.), për të kryer veprën penale të vrasjes në drejtim të këtu të tani të ndjerit H. A..

5.2. Me dëgjimin e dëshmitarit - të dëmtuarit A. K., gjykata në tërësi ka vërtetuar faktet jokontestuese, të cilat janë cekur si në pikën 4.a, saktësisht në pikat 4.a.1 dhe 4.a.2, dhe në tërësi ia ka falur besimin deponimeve të tij sa i përket këtyre fakteve.

Mirëpo gjykata edhe deponimeve të këtij dëshmitari nuk ia ka falur besimin sa i përket vërtetimit të fakteve kontestuese të cekura si në pikën 4.b, saktësisht në pikat 4.b.1 dhe 4.b.2, pasi që i njëjti gjatë dhënies së dëshmisë ka qenë kontradiktor me deklaratën e dhënë në prokurori, dëshminë e të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit, me provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës, e po ashtu ka qenë kundërthënës edhe me vetveten gjatë dhënies së dëshmisë në gjykatë, pasi që i njëjti ndryshe është përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit, si dhe nga gjykata.

Deri tek një konstatim i tillë gjykata ka ardhur, pasi ka analizuar disa prej deklarimeve të dëshmitarit, si:

- fillimisht i ndjeri H. i thotë “*shiko si i kam rregulluar kamerat*”, ndërsa tutje në deklarinimin e tij thekson se ja ka gjetur mjeshtrin dhe e ka dërguar për ti kontrolluar kamerat;
- pas daljes nga shtëpia e H. së është nisur në drejtim të veturës;
- nuk e ka njohur D. Gj.;
- nuk e ka ditur arsyen e takimeve mes D. dhe të ndjerit H.;
- për letrën e dërguar D në fshatin . . . , të Komunës së Prizrenit fillimisht nuk e ka ditur përmbajtjen e letrës deri në momentin kur e ka lexuar;
- tre-katër muaj para vrasjes së mikut të tij e ka kuptuar për planin që kishin D me të ndjerin H., për vrasjen e B.t.;
- nuk e dinë se si kanë pas për të vepruar D me të ndjerin H. lidhur me vrasjen e B.t, në bashkëkryerje apo si?

Gjykata, këtyre deklarimeve të këtij dëshmitari nuk ua fali besimin, fillimisht për shkak se deklarinimet e tij nuk gjejnë mbështetje në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmia e dëshmitarit ka qenë kontradiktore në vetvete, ku ka deklaruar se pasi që kanë dal prej oborrit fillimisht është nisur kah kerri i tij, ndërsa H.a derisa e ka mbyll derën me qelës, i ka bërë me shenjë për ti treguar se si i ka rregulluar kamerat, pasi që të njëjtat kanë qenë të

prishura më herët, ndërsa këto veprime të përshkruara nga dëshmitari - i dëmtuari, janë në kundërshtim me pamjet e evidentuara nga shikimi i video incizimeve të vendit të ngjarjes, ku fillimisht shihet i dëmtuari – dëshmitari që pasi del prej oborrit nuk shkon në drejtim të veturës së tij, ku ishte e parkuar përballë derës por shkon në anën e majtë të dyerve të oborrit, gjithashtu nga këto video incizime nuk vërehet ndonjë shenjë apo veprim konkludent nga ana e të ndjerit duke i treguar për rregullimin e kamerave, por përkundrazi i njëjti gjatë ecjes vazhdimisht e shikon kamerën e cila është e vendosur në këndin e shtëpisë, si dhe e kthen kokën prapa duke e shikuar të ndjerin derisa ishte duke e mbyll derën e oborrit. Po ashtu një deklaram i tillë është në kundërthënie edhe me deklaratën e dhënë nga bashkëshortja e tij – dëshmitarja F. ku gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *pas dyshimit që kishte në D., e kishte lutur babain e saj që ti vendos kamerat dhe ai i kishte thënë jo, nuk bënë një herë, por e njëjta pa e pyetur, 3-5 ditë para ditës kritike i kishte thënë burrit të saj - dëshmitarit A. që të shkojë dhe ti ndreq kamerat, ku për këtë i kishte gjetur mjeshtrit edhe i kishte rregulluar kamerat e shtëpisë në fshatin S.* Tutje, i njëjti në pyetjen e prokurorit gjatë dhënies së dëshmisë në PTH. Gjakovë, se a e njihni D. Gj., është përgjigjur se nuk e njeh, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e ka ditur emrin e tij, saktë, por e ka njohur me emrin E, nuk i ka prezantuar ndonjë foto, por në deklaratën e dhënë në polici pas deklaratës së dhënë në prokurori, i janë ofruar disa foto dhe aty e ka identifikuar E. Gjykata një deklarami të tillë nuk ja fali besimin për faktin se i njëjti para rastit kritik përpos që ka komunikuar nëpërmjet rrjetit social për të lënë takim, me të pandehurin dhe të ndjerin H., ka pohuar se janë takuar disa herë fizikisht, kur kemi parasysh edhe faktin se me D. janë njoftuar në fund të vitit 2017, si dhe gjykata nuk ja fali besimin kur deklaroi se nuk e ka ditur arsyen e takimeve në mes të D. dhe H., ku ky arsyetim është i pabazë pasi që vetvetiu të krijohet bindja se si i dëmtuari – dëshmitari ka mundur të jetë një person kaq shumë i besuar për të ndjerin H. dhe gjatë çdo takimi me të pandehurin e ka shoqëruar dhe dërguar në Shqipëri dhe në vende të ndryshme në Kosovë, për tu koordinuar rreth planit për vrasjen e B.t dhe të mos e ketë ditur arsyen e këtyre takimeve, e po ashtu dëshmitari ka deklaruar se planin për vrasjen e B.t e kishte kuptuar vetëm 3 - 4 muaj, para vrasjes së mikut të tij dhe nuk e ka ditur se si kishin për të vepruar lidhur me vrasjen, në bashkëkryerje apo si.

Se dëshmitari ka qenë kontradiktor me vetveten gjatë dhënies së dëshmisë e vërteton edhe deklarami i tij, se për letrën e dërguar D. në fshatin . . ., të Komunës së Prizrenit, fillimisht nuk e ka ditur përmbajtjen e letrës deri në momentin kur gjatë rrugës e ka hapur dhe e ka lexuar, për gjykatën një pohim i tillë nuk qëndron, përderisa i njëjti në anën tjetër pohon se gjersa ishte duke biseduar në telefon me të ndjerin përmes diktimit nga i ndjeri e ka shkruar letrën të cilën ka pasur për të ja dërguar D., është e pamundur të mos e ketë ditur përmbajtjen e saj pasi që është shkruar në gjuhën të cilën e flet dhe e kupton dëshmitari, dhe kinse nga ky moment e ka kuptuar se bëhet fjalë diçka për vrasje, me arsyetimin se nuk i ka thënë direkt, gjykata këtyre deklarameve nuk ua fali besimin dhe nuk mund të mbështet përgjegjësinë penale të të pandehurit në një deklaram të tillë të dëshmitarit të lartcekur.

Andaj, deklaramet e të dëmtuarve – dëshmitarëve F. A. dhe A. K., për gjykatën nuk gjejnë mbështetje, edhe nëse kanë pasur komunikim me të pandehurin pasi që deklaramet e tyre kanë qenë të orientuara në shpjegimin e planit që kishte babai i dëshmitares- të dëmtuarës, tani i ndjeri H. për vrasjen e B. A.t dhe nuk gjejnë mbështetje në prova materiale si dhe nuk kanë arritur të provojnë se i pandehuri është kryerës i veprave penale të cilat i vihen në barrë.

5.3. Me dëgjimin e dëshmitarit G. A., gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti me datë 14.10.2018, ka qenë në vuajtje të dënimit me burgim për një rast kundër B. A.t. Babai i tij, tre ditë para se të vritej kishte shkruar për ta vizituar në burg duke i thënë se D është ka don me më vra me arsyetimin se ishte dorëhequr nga plani për të vrasur B. dhe sipas të njëjtit ishte bërë

punëtor i B., mirëpo në deklarin e dhënë në polici me datë 14.10.2019 ka deklaruar se nuk i din rrethanat e rastit. Tutje ka deklaruar se D nuk e ka njohur kurrë më parë dhe nuk është takuar me të ndonjëherë, por ky deklarin ka qenë në kundërtënie me përgjigjet e dhëna gjatë deklarin të tij në gjykatë, pasi që fillimisht mohon se e ka njohur D dhe nuk e ka takuar ndonjëherë, pastaj në pyetjen e parashtruar nga i pandehuri se a është takuar me të, tek shtëpia e K., në oborr të tij, i njëjti e ka pohuar se janë takuar. Tutje ka shtuar se nuk ka njohuri se D. ka ndejt një muaj ditë në shtëpinë në S., dhe kinse tre ditë para se të vritej babai i tij, e ka kuptuar për planin që i ndjeri H. e kishte me D për ta vrasë B., ndërsa para se të shkonte në burg nuk ka pasur njohuri se babai i tij e ka planifikuar ta vras B., ashtu që gjatë gjithë deklarin të dhënë në gjykatë e ka mohuar një pjesë të deklaratës së dhënë në prokurori dhe polici, përkundër faktit se në pyetjen e prokurores se a qëndroni pranë deklaratës së dhënë në polici dhe prokurori, i njëjti ka qëndruar pranë të njëjtave.

Gjykata edhe nga kjo dëshmi nuk ka arritur që ta vërtetoj faktin se i pandehuri i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, sepse në këtë rast dëshmitari vetëm ka treguar se tre ditë para rastit e ka vizituar në burg babai i tij, i cili i ka treguar për planin që kishte për ta vrasë B. dhe tërheqjen e D. prej planit të lartcekur, deklarin i tij ka qenë kontradiktor pasi që i njëjti gjatë kësaj kohe ka qenë në vuajtje të dënimit me burgim, e të gjitha deklarinet e tij janë të bazuara vetëm në informatat të cilat i ka siguruar nga këtu të dëmtuarit, kështu që gjykata nuk ia fali besimin deponimeve të këtij dëshmitari.

5.4. Me dëgjimin e dëshmitares F. A. P., se kontaktin e fundit me të ndjerin e ka pas një javë para se me ardh në Kosovë, me sa i kujtohet ka qenë fundi i muajit Shtator dhe fillimi i muajit Tetor, duke shtuar se babai i saj ka qenë i shqetësuar se ka me vra B., probleme nuk ka pasur me askënd tjetër dhe gjithmonë ka thënë se vetëm me pagesë ka me bë vrasjen. Ndërsa 1-2 muaj para se me u vra e kishte thirr vëllai i B.t, S. A., duke i treguar planin e vëllait të tij, duke i përmendur një emër por sipas dëshmitares nuk e kishte mbajtur në mend emrin e tij, por pastaj kur e kishte dëgjuar emrin E. e din se ky emër është përdorur dhe se kurrë nuk ka kontaktuar përmes telefonit e as rrjeteve sociale me D. Gj., kurse babai i saj, sipas të njëjtës, asnjëherë nuk i ka folur për planin që kishte me D. për ta vrasë B.. Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se një deklarin i tillë përpos që tregon atë çka di dëshmitarja për ngjarjen nuk kontribuon asgjë në zbardhjen e rastit.

Gjykata, bazuar në të cekurat si më lart, ka ardhur në përfundim se nuk janë vërtetuar faktet kontestuese, saktësisht nuk është vërtetuar se i pandehuri ka qenë i shtyrë nga B. A. që ta kryej vrasjen e tani të ndjerit H. A..

5.5. Me dëgjimin e dëshmitarëve G. B., S. B. dhe L. A., gjykata ka ardhur në përfundim se të njëjtit përpos asaj që kanë deklaruar se si e kanë njohur të pandehurin D. Gj., deklarinet e tyre nuk kanë arritur të kontribuojnë në zbardhjen e rastit, për të vërtetuar se D. Gj., është kryerës i veprave penale për të cilat është akuzuar.

5.6. Me dëgjimin e dëshmitarëve L. LL., L. Sh., P. B. dhe G. S., gjykata ka ardhur në përfundim se *dëshmitarja L. LL.*, të njëjtin me datë 14.10.2018, se cila ditë ka qenë nuk i kujtohet por e di se ka qenë fundjavë, duke shtuar se ka qenë dy ditë para datës së aksidentit të djalit të saj, D. e kishte takuar në Shkodër tek “Ura e D. B.” ku punonte si sanitare, aty kishte shkuar me veturën . . . , më ngjyrë të kaltër të mbyllet, gati të errët, për të bërë pagesën e punës së djalit të saj, i cili punonte si banakier dhe picamen, në lokalin e D., shtatë ditë të javës, gjatë pushimeve verore. Aty kanë qëndruar rreth një orë me D., e pastaj rreth orës 10:00/h, së bashku me djalin e

dëshmitares i njëjti është nisur në drejtim të Malësisë së Madhe, për të marr dërrasa për të rinovuar - rregulluar lokalitë në V., tek . . . , ndërsa janë kthyer rreth orës 2-3 pasdite. Një deklarament i tillë ka mbështetje edhe në dëshminë e *dëshmitarit L. Sh.* i cili ka pohuar se në bazë të tabulatit kishte folur me D, në ora 06:30 min., të mëngjesit ditën e diele, për çështje pune duke i kërkuar që të dal në punë atë ditë, por i njëjti i ishte përgjigjur se të dielën nuk punon me përjashtim të shoqërisë në marrëdhënien e punës, por i njëjti me veturën “. . .” Foristradë jeshile, pas 20-30 minutave i kishte shkuar tek shtëpia pasi që jetojnë në të njëjtin fshat, duke i kërkuar që të dal në punë për të rregulluar një banak në lokalitë e tij dhe i kishte thënë se do të dal deri në Shkodër për punën e kësaj dërrase, dhe kishte shkuar për të punuar tek lokalitë i D. deri në ora tre pasdite. I njëjti e ka pohuar se dëshmitaren L nuk e njeh, por djalin e saj i cili ka punuar tek D, e njeh. Tutje *dëshmitari P. B.* pohon se D e ka takuar në vitin 2018 tek shtëpia e tij, ku D. kishte shkuar me foristradë me marr dërrasa gështenje për një banak në lokal dhe një ditë përpara se të takohen për dërrasat, e kishte telefonuar D. në telefon dhe ishin takuar, rreth mesditës derisa ka qenë duke punuar tek magazina, ku kishte shkuar me një person i cili quhej G., ndërsa ditën kur kishte shkuar të merr dërrasat kishte qenë mëngjes, e po ashtu atë ditë shton se kishte pasur mysafirë në shtëpi për vizitë pasi që nënën e kishte të sëmurë, ka qenë ditë e diele pasi që ditën e premte nëna e tij kishte pësuar infarkt e këtë fakt deklaroi se e mbështet dhe mund ta vërtetojë me dokumentacion të mjekut. Ndërsa *dëshmitari G. S.* ka pohuar se D., përmes P. P.t, kishte shkuar tek ai për ti qarë dërrasat në sharrën e tij, i cili kishte ardhur me makinë “. . .” foristradë, por e din se kanë qenë rreth një kubik dërrasa apo një e gjysmë, por llojin nuk e din sepse ka kaluar një kohë e gjatë, por i kujtohet që po atë ditë i ka marr dërrasat.

Gjykata, deklarimeve të këtyre dëshmitarëve plotësisht ua fali besimin, fillimisht për shkak se deklaramentet e tyre gjejnë mbështetje në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe pohimet e tyre kanë qenë në përputhje me njëra-tjetrën duke përshkruar veprimet e të pandehurit ditën kritike e të cilat deklarime e mbështesin plotësisht alibinë se i njëjti kishte qenë në territorin e Rep. së Shqipërisë, e sidomos këto deklarime gjejnë mbështetje të plotë edhe nga raportet për Menaxhimin e Kufirit të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë, me ç'rast është vërtetuar fakti se ditën kritike i pandehuri ka qenë në territorin e Rep. së Shqipërisë.

Andaj, bazuar në të cekurat si më lart, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk janë vërtetuar faktet kontestuese, saktësisht nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

5.7. Me dëgjimin e dëshmitarit S. S. nga IEDD, i dëgjuar në rikonstruimin e vendit të ngjarjes, gjykata ka kuptuar se matja është bërë në formën e metrit të shtrirë ku skaji i djathtë ka qenë pika A, skaji i majtë ka qenë pika B e objektit B, ndërsa pika X është katër metra larg pikës A, që i bjen në perimetrin e skajshëm të rrugës dhe të gjitha matjet pastaj janë bërë në mënyrë të koordinatave duke i marrë për bazë vijën bazë dhe pastaj duke vazhduar me matjen e dëshmitareve nga vija bazë. Tutje ka sqaruar se këto lloj matjesh i ka bërë në formë koordinatave dhe matja është bërë nga vija bazë e nuk është bërë nga shenja numër 45 e deri tek kutia postare, ku pas matjes së bërë me metër nga ana e ekspertit distanca nga numri 45 deri tek kutia postare (Nr.58) është 3 metra e 70 cm, detonatori nr.45 i evidentuar si remote kontroll duke sqaruar se në bazë të vendit të ngjarjes ku ka ndodhur shpërthimi dyshohet se ka qenë materie eksplozive TNT, i cili inicohet me detonator elektrik ose mekanik, për të cilin në këtë rast dyshohet se ka qenë detonator elektrik. Pastaj ka shtuar se në rastin konkret bomba në fjalë nuk përbëhet veç prej

eksplozivit dhe detonatorit por në rastin konkret ka pasur edhe një pajisje që pranon frekuenca të caktuara që e fut në veprim dhe ajo pajisje e liron një energji elektrike e cila e inicon detonatorin dhe detonatori e aktivizon eksplozivin, ku distanca e këtij aktivizuesi të detonatorit për pranuesin e frekuencave apo marrësin del të jetë deri në një kilometër, ku duhet të ketë shikim vizual dërguesi dhe pranuesi. Por, për të iniciuar eksplozivin detonatori duhet të jetë i vendosur në masën e eksplozivit, ndërsa pas shpërthimit të detonatorit nuk mund të konstatohet se kush ka qenë prodhuesi, sepse me rastin e shpërthimit detonatori dëmtohet dhe nuk mund të bëjmë identifikimin.

5.8. Me dëgjimin e dëshmitares– ekspertes Sh. G. - F nga AKF-ja, gjykata ka kuptuar se ka bërë ekzaminimin e diviarit dhe që nga data 08.10.2018 nga ora 07:00/h, deri në momentin kur mbërrin policia në vend ngjarje, i ka nxjerr video incizimet që i takojnë kësaj periudhe, mirëpo është bërë edhe një kërkesë që të nxirret edhe një video incizim i cili ceket edhe në raport, i cili ndodhet në kamerën nr.5 po e njëjta datë është koha e precizuar në raportin final 02:03 min, ku një i dyshuar vendos diçka ku shihet edhe në video, duke shtuar se për të është e panjohur, ku shton se këtë imazh e ka dërguar edhe në raportin elektronik si video incizim i cili është pastruar dhe i qartësuar aq sa e ka lejuar programi Forenzikë të cilin e kanë në përdorim. Po ashtu ka sqaruar se, softueri amped five, përdoret për pastrimin e pamjeve dhe qartësimin e pamjeve, duke shtuar se ky softuer është i licencuar nga AKF-ja, filtrat të cilët i ka ky softuer përdorën në raste të ndryshme dhe jo të gjithë filterat përdoren në një rast të vetëm.

Mirëpo ekspertja ka sqaruar se nuk mund të përgjigjet se a mund të nxirren tiparet individuale për identifikimin e personit bazuar në parimet e antropologjisë fizike me arsyetimin se nuk është në domenin e saj, por ka sqaruar se të gjitha ekspertizat që i kryejnë i kanë të rregulluara me procedura, ndërsa se a mund të nxirren tiparet individuale për identifikimin e personit bazuar në parimet e antropologjisë fizike, kjo nuk është e rregulluar me procedurat e AKF-së, andaj kjo ekspertizë nuk kryhet në kuadër të AKF-së.

Gjykata, ka analizuar me kujdes edhe konstatimin e bërë nga ana e ekspertes, e cila ka deklaruar se: *“ka arritur të vërtetoj faktin se në dëshminë - kamerën nr. 5, të përshkruara si më lart, është evidentuar po e njëjta datë dhe koha e precizuar në raportin final 02:03 min, ku një i dyshuar i panjohur vendos diçka ku shihet edhe në video, duke shtuar se për të është e panjohur”,* e një gjë e tillë nuk është kontestuese për gjykatën dhe gjen mbështetje edhe nga *Raporti i ekspertimit i bërë nga AKF, me nr. AKF-2023-0291, i dt. 18.08.2023,* konstatohet se: disa nga pasqyrimet e këtyre ekzaminimeve janë pasqyruara si: pamje nga kamera 5, pamja e vendosjes së pajisjes eksplozive (02:03:02 2018), dhe nga e njëjta kamerë, shihet i dyshuari gjatë vendosjes së pajisjes eksplozive (02:03:02 2018), dhe nga *shikimi i CD-së me video incizim 2018-EA-1124, të dt.14.10.2018,* rezulton se, ky video incizim është marrë nga kamerat e sigurisë së shtëpisë së viktimës, e ku vërtetohet se me dt. 14.10.2018 rreth orës 02:03:02 sek., një person i gjinisë mashkull, vendos diçka në kutinë postare të shtëpisë së të dëmtuarit, ky person shihet nga video incizimi se çalon dhe ka të veshura pantallona që veshin ushtarët.

Mirëpo për gjykatën nuk është i qartë dhe mbetet i pazbuluar fakti se kush është personi i cili ka vendosur materien eksplozive në postën e cila gjendej e vendosur në dyert e oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., dhe personi i cili ka ndërmarrë këto veprime inkriminuese ditën kritike, a është i pandehuri.

5.9. Me dëgjimin e dëshmitarit S. S. nga IEDD, në shqyrtim gjyqësor, gjykata ka kuptuar se, lloji i eksplozivit TNT si dhe çdo eksploziv tjetër drejtimin e shpërthimit e ka në 360 shkallë, mirëpo

nëse është i vendosur afër ndonjë muri apo ndonjë pengese siç ka qenë në rastin e caktuar vala goditëse shkon në drejtimin e kundërt të pengesës, shpejtësia e shpërthimit të eksplozivit TNT është rreth 7000 metra në sekonda, ndërsa, eksplozivi matet me shpejtësi të shpërthimit e jo me forcë, pas shpërthimit largësia në të cilën vepron TNT pa pengesa, varet prej sasisë, nëse kemi sasi të vogël nuk mund të bëjë dëme shumë larg, mirëpo, nëse kemi sasi të madhe dëmet janë shumë të mëdhaja.

Eksperti ka sqaruar se, distanca e personave të pranishëm në raport me bombën ka qenë e ndryshme, i ndjeri ka qenë shumë afër bombës, ndërsa, tjetri person ka qenë më larg. Po ashtu, ka shtuar se bomba e cila është punuar në atë lokacion ka pasur edhe sfera metalike për me shkakto lëndime në njerëz dhe kjo varet se si dhe ku e godet trupin e njeriut. Tutje, ka shtuar se në raportin pas operacional është marr me provën nr.45, një remote kontroll detonator, dhe një trak ngjitëse.

Mirëpo eksperti nuk ka arritur të shpjegoj temperaturën që zhvillon TNT pas shpërthimit, duke theksuar se nuk e din mirëpo, në shpërthim përveç temperaturës ka edhe valë goditëse shumë të mëdha, ku për të prodhuar një bombë në këtë rast kanë përdorë remote kontroll ose teledirigjim që e ka përdorur kryesi prej një distance për ta iniciuar bombën. Gjithashtu, ka shtuar se në rastin konkret përpos dërguesit duhet me pas edhe pranuesin që të funksionoj pajisja dërgues-pranues, në atë pranuesin lidhet detonatori, detonatori vendoset në eksploziv, pra, detonatori e ndezë eksplozivin dhe në këtë mënyrë krijohet bomba me teledirigjim. Ka shtuar se, remote kontroll i cili është gjetur është pranuesi, i cili ka qenë i vendosur së bashku me mjetin shpërthyes – eksplozivin dhe asnjëherë nuk ndodh me u djeg të gjitha pjesët dhe asnjëherë nuk ndodh me u zhduk detonatori nga temperatura. Pra, për ta iniciuar një eksploziv të këtij lloji duhet të kemi patjetër detonatorin të vendosur në eksploziv, për arsye se për iniciimin e këtij eksplozivi i nevojitet një goditje e menjëhershme me një temperaturë shumë të lartë për iniciim të eksplozivit.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se bazuar në raportin e ekspertimit, por edhe nga deklarimi i ekspertit, distanca e personave të pranishëm në raport me bombën ka qenë e ndryshme, i ndjeri ka qenë shumë afër bombës, ndërsa, tjetri person ka qenë më larg, dhe bomba e cila është punuar ka pasur edhe sfera metalike me qëllim që të shkaktoj lëndime në njerëz. Këto pohime të ekspertit gjejnë mbështetje edhe në *Raportin pas operacional të Njesisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive* ku është konstatuar se, me datën 14.10.2018, IEDD kishte dalë në vendin e ngjarjes lidhur me një shpërthim që ishte bërë afër derës së hyrjes së shtëpisë së viktimës H. A.. Bazuar në shikimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes nga operatorët e kësaj njësie, mjeti shpërthyes – bomba artizanale, ka qenë e vendosur në kutinë postare e cila ishte e vendosur në murin afër derës së hyrjes së oborrit dhe është iniciuar nga distanca-me remote kontrol. Si lëndë eksplozive bazuar në gjurmët që kanë lënë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të analizimit të testit fushor del të jetë TNT i iniciuar nga detonatori elektrik. Gjithashtu në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe sfera metalike të cilat kanë qenë të vendosura në mjetin shpërthyes e që shërbejnë për shkaktimin e dëmeve më të mëdha te njerëzit dhe gjësendet.

## 6. Vlerësimi i mbrojtjes së të pandehurit

Gjykata, ka bërë edhe vlerësimin e mbrojtjes që ka paraqitur i pandehuri, me ç'rast ka deklaruar se: - data 14.10.2018 nuk i kujton asnjë gjë, por, pasi i është bastisur restoranti në mesin e muajit Korrik 2020, është vënë në lëvizje sepse kishte marr dijeni se është person në kërkim ndërkombëtar, dhe iu ka drejtu kompanisë Vodafon, të cilës i ka kërkuar tabulatet telefonike të

numrit personal . . . nga data 01.Shtator 2018 deri me datë 30 Tetor 2018, gjatë kohës kur ka qenë në kërkim ndërkombëtar, kompanisë Vodafon i është drejtuar tri herë me kërkesë, ku pas kërkesës së tretë ka arritur ti sigurojë tabulatet telefonike. Pasi verifikimit të numrave të personave të dt.14.10.2018, i kishte telefonuar shtetasit L. Sh., diku rreth orës 7.00/h të mëngjesit, dhe i kishte kërkuar për ta ndërtuar një mur me tulla aty te banaku i restorantit, i cili ja kishte mbyll telefonin pa e kuptuar përgjigjen, pasi kishte pirë kafe është drejtuar direkt dhe e ka takuar fizikisht te shtëpia e tij, ku punon në ndërtim bashkë me vëllain dhe prindin e vet. Pasi ia ka dhënë porosinë e punës atij personi ka udhëtuar drejt Shkodrës, ku ka takuar shtetasen L. LL., pasi ka pirë kafe te një restorant që punon si sanitare e i cili është në qendër të qytetit, i ka dhënë një shumë lekësh, pasi djali i saj kishte punuar në orar të shkurtër tek i njëjti, dhe e kishte marr djalin e L. me veti, i ka telefonuar shtetasit P. P.t dhe i ka kërkuar për me i punuar do dërrasa, është takuar me P. fizikisht, së bashku me P. dhe J. kanë shkuar tek G. të cilin e ka takuar për herë të parë atë ditë dhe as nuk kishte pasur numër kontakti me të, ia ka shpjeguar se si duhet ti punojë dërrasat dhe i njëjti i ka thënë: “ që ti sjellë, do të punojë deri në darkë”, duke shtuar se pastaj është nisur drejt fshatit Lohe-Koplik, së bashku me J., ku kanë shkuar tek shtëpia e shtetasit P. B., dhe i kishte thënë se i duhen dy lloj dërrasash, disa ja kishte kërkuar gështenje që ta punoj kapakun e banakut dhe disa tjera ia kishte kërkuar me gjatësi 4m. Sqaron se i kanë zbritur dhe i kanë ngarkuar në foristradë, dhe bashkë me J. kishin shkuar tek punishtja e G., dhe aty i kishte telefonuar shtetasit P. P., ku ka ardh për herë të dytë prapë tek punishtja e G., dhe ka ndejt derisa i kanë përpunuar por nuk ka pasur shumë vonesë, pasi edhe G. i kishte përfunduar shumë shpejt. Pasi e kishte parë foton e foristradës, mban mend se Foristrada ka qëndruar në Prizren tek një servis, pronari i servisit quhet S. P., e kishte marr përsipër për me e rregulluar karroserinë, e din që kishte hyrë në autobus në Kosovë dhe kur kishte shkuar te servisi, foristrada ka qenë e pa punuar, pra, mendon se data e fundit që ka hyrë në Shqipëri ka qenë fillimi i muajit Tetor, data nuk i kujtohet, por pas datës 06.10.2018, nuk ka ardhur asnjëherë tjetër në Kosovë, duke shtuar se deri në momentin kur është sjell me polici në Kosovë, ka hyrë edhe vet privatisht në territorin e Republikës së Kosovës, afërsisht 20 herë, ndoshta më shumë apo edhe më pak, ndërsa arsyeja pse në Tetorin e vitit 2018, i ka ndërprerë vizitat në Kosovë, ka qenë largimi i bashkëshortes së tij në Itali dhe barra e punës në shtëpi dhe në familje sepse kishte mbajtur bagëti, dhe nuk ka pasur kush me u kujdes kur ka ikur nusja.

Gjykata nuk ia fali besimin deklaramit të të njëjtit se para datës 14.10.2018, nuk e ka njohur A. K.n, po ashtu para kësaj datë nuk e ka njohur edhe të ndjerin H. A., pasi që gjatë zhvillimit të procedurës në këtë çështje penale, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri është njohur me të lartcekurit, me të cilët kishin planifikuar që të kryenin vrasjen me pagesë, por ia fali besimin që nuk e ka njohur të dëmtuar F. A., as nuk e ka takuar e as nuk ka pasur kontakte me të, kurse para datës 14.10.2018, ka qenë në Kosovë, por kurrë në jetë nuk kishte qenë në fsh. S., e as nuk njeh askënd të këtij fshati, tutje ka shtuar se përveç kohës kur ka vdekur A. e për të cilën deklaroi se ka komentuar por nuk është i sigurt nëse ka kontaktuar me të dëmtuarën, herë tjetër nuk kishte komunikuar asnjë me juve, e as nuk është takuar asnjëherë fizikisht me ju. Ndërsa për mesazhin e dërguar, një natë para natës kritike ka qenë ora një e natës, me adresën “. . .”, duke i kërkuar që ti thotë burrit dhe plakut le të vijnë andej sepse është duke e ndrequr një çati, i njëjti thekson se nuk ka komunikuar kurrë.

Gjykata, ia fali besimin mbrojtjes së të pandehurit, sidomos për pjesën që i përshkruan veprimet të cilat i kishte ndërmarrë gjatë datës 14.10.2018, për takimin e zhvilluar me dëshmitaren L. LL. dhe pagesën e kryer nga D. për punën e kryer nga djali i dëshmitares, pastaj për kontaktimin dhe takimet e zhvilluara më dëshmitarët, e të cilët dëshmitar i forcojnë pretendimet e të pandehurit dhe të cilat mbështesin alibinë se i njëjti në ditën kritike ka qenë në Rep. e Shqipërisë, pasi që në tërësi përputhen me provat materiale të cilat ndodhen në shkresa të lëndës, si *raporti i sistemit*



*për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës, Raporti i Sektorit për Fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së, Raporti i ekspertimit i bërë nga AKF, me nr. AKF-2023-0291, i datës 18.08.2023 dhe Raporti i ekspertimit i lëshuar nga Instituti Forenzik në Cyrih të Zvicrës.* Kurse sa i përket raportit të ekspertimit se a i është marr ndonjë foto apo ndonjë matje nga ana e policisë apo dikujt tjetër, ka treguar se matjet, fotot dhe të gjitha të dhënat i ka dhënë ditën që është arrestuar e deri më tani i janë bërë pesë herë matjet, mirëpo, nga data 17.11.2023, nuk i janë bërë foto e as matje, e ky deklaram ka mbështetje në raportet e cekura më lartë. Gjithashtu gjykata ja fali besimin mbrojtjes së të pandehurit, sa i përket pjesës kur mohon se ka komunikuar me të dëmtuarit- dëshmitarët F. A. dhe A. K., pasi që të njëjtit përpos deklarimeve të tilla nuk kanë ofruar prova materiale që mbështesin këtë pretendim të tyre.

E po ashtu, gjykata ka pasur parasysh faktin se provat që e inkriminojnë të pandehurin, se i njëjti ditën kritike ka qenë në territorin e Rep. së Kosovës dhe i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar sipas aktakuzës së PTH. Prizren se kinse ka vendosur një materiale eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., dhe përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., janë deklaramet e të dëmtuarve- dëshmitarëve, të cilat nuk kanë mbështetje në provat tjera, përpos në supozimet e tyre, ashtu që gjykata ka pasur parasysh se argumentet që janë kundër të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë, përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet diçka e tillë duhet të konsiderohen se nuk ekzistojnë. Andaj, gjykata në këtë rast nuk ka mundur ta vërtetojë me siguri të plotë se i akuzuari ka privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. dhe i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit A. K..

### 6.1. *Pretendimet e prokurorisë*

Prokurorja e shtetit, në fjalën përfundimtare, në tërësi ka qëndruar pranë aktakuzës, me ç'rast ka deklaruar se në këtë çështje penale ekzistojnë prova të pakontestueshme nga të cilat vërtetohet se i pandehuri D. Gj., me dashje e ka dëshiruar kryerjen e veprave penale, duke qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe atë pasi që ditën kritike i pandehuri rreth orës 02:03 min, ka vendosur një materie eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., në momentin kur tani i ndjeri rreth orës 08:02 min, del nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll dyert e oborrit, i pandehuri nga një largësi e panjohur përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K., me pa mëdyshje nga provat e administruara materiale, në tërësi është provuar se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprave penale për të cilat akuzohet si në aktakuzë, dhe këtë e ka bazuar kryesisht në dëshmitë e dëshmitarëve - të dëmtuarve F. A. (e dëmtuar), A. K. (i dëmtuar) dhe F. A. P., G. A., pjesërisht nga deklaramet e dëshmitarëve G. B., S. B. dhe L.A. të dhëna gjatë procedurës penale. Andaj, duke konsideruar se në veprimet e të pandehurit janë formuar elementet esenciale të veprave penale për të cilat është akuzuar, ka kërkuar nga Gjykata që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprat e lartcekura penale, ta dënoj sipas Ligjit, si dhe të bëj konfiskimin e sendeve të përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që me rastin e matjes së dënimit, gjykata ti merr për bazë këto rrethana rënduese: faktin se vepra penale në fjalë ka rrezikshmëri të madhe shoqërore, faktin se viktimat ka qenë i njohur për të, se eksplozivi i llojit TNT me ligjin për armët e Rep. së Kosovës nuk u lejohet qytetarëve ta mbajnë në pronësi, në posedim dhe me lejen e organit kompetent, faktin se i akuzuari në asnjë moment nuk ka shprehur keqardhje dhe pendim si dhe pas kësaj raportet mes dy familjeve A. janë përkeqësuar edhe më shumë, kurse prokuroria nuk ka gjetur rrethana lehtësuese në drejtim të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të gjykatës, pretendimet e prokurorisë janë të pabazuara, sepse nga dëshmitarët e lartcekur, provat materiale të proceduara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, por edhe nga vet mbrojtja e të pandehurit, nuk është vërtetuar se i pandehuri me datë, kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në aktakuzë, me dashje, ka kryer veprën penale Vrasja e rëndë nga neni 179 parag. 1.5 të KPK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, deri te një përfundim i tillë ka ardhur pikërisht duke pasur parasysh sidomos faktin se prokuroria nuk ka arritur që ta argumentoj se i pandehuri ditën kritike ka qenë në territorin e Rep. së Kosovës dhe i ka kryer veprat penale pasi që rreth orës 02:03 min, ka vendosur një materie eksplozivi në shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H. (në kuti postare), në momentin kur tani i ndjeri rreth orës 08:02 min, del nga dyert e oborrit e pikërisht kur tenton të mbyll derën e oborrit, i pandehuri nga një largësi e panjohur përmes teledirigjimit e aktivizon atë materie eksplozivi dhe nga shpërthimi, mbetet në vend i vdekur H. A. dhe lëndime trupore merr i dëmtuari A. K.. Se i pandehuri ka vendosur eksplozivin në kutinë postare tek dyert e oborrit të shtëpisë së viktimës, nuk ka mundur të vërtetohet as me provat materiale dhe personale të mbledhura gjatë fazës së hetimit nga ana e prokurores së shtetit, e as nga provat e mbledhura dhe të proceduara gjatë procedurës gjyqësore.

#### *7. Propozimet e palëve*

Palët në procedurë nuk kanë pasur propozime tjera për nxjerrjen e ndonjë prove.

#### *8. Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjykata, duke u bazuar në përshkrimin faktik të aktakuzës, ka analizuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 parag. 1.5 i KPK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, po ashtu konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorisë se i pandehuri me dashje e ka privuar nga jeta tani të ndjerin H. dhe me atë rast ka vënë në rrezik jetën e të dëmtuarit A., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri rreth orës 02:30 min., ka vendosur një materie eksplozivi në kutinë postare në dyert e oborrit të shtëpisë së tani të ndjerit H., pasi që me asnjë provë qoftë materiale apo personale nuk është provuar se i pandehuri ka qenë personi i cili e ka vendosur këtë materie eksplozive e cila ka shkaktuar pasoja për tani të ndjerin, por këtë e ka bazuar vetëm në deklarimin e të dëmtuarve - dëshmitarëve, të cilët sa i përket kësaj çështje kanë qenë kontradiktor me vetveten, meqenëse gjatë dhënies së dëshmisë në gjykatë, nga ana e njëjtëve është pohuar fakti se tani i ndjeri H. me të pandehurin D. ishin takuar me qëllim të vrasjes me pagesë të B. A.t, dhe me arsyetimin se kinse ishin prishur për shkak të çështjes së pagesës dhe se ditën kritike i pandehuri ishte në territorin e Kosovës, për gjykatën kjo është irelevante, pasi këto pohime dhe supozime të tyre nuk kanë gjetur mbështetje në asnjë provë materiale e as personale, të administruar gjatë gjithë procedurës penale.

Nuk qëndrojnë edhe pretendimet e prokurorisë se i pandehuri me materien eksplozive të tipit dhe natyrës së panjohur, që e ka vendosur në kutinë postare-shtyllën e dyerve të oborrit të shtëpisë

së tani të ndjerit H., e këtë fillimisht duke u bazuar në faktin se nga *CD-ja me video incizim 2018-EA-1124, të datës 14.10.2018, rreth orës 02:03:02, min shihet një person i gjinisë mashkull që vendos diçka në kutinë postare të shtëpisë së të dëmtuarit, ku nga video incizimi shihet se çalon dhe ka të veshura pantallona ushtarake, ndërsa në raportin e ekspertimit të gjurmëve daktiloskopike me nr. AKF/2019-0545/2019-484, të datës 25.06.2019, nga i cili ka rezultuar se nga ekzaminimi i dëshmisë së gjetur në vendin e ngjarjes e evidentuar E#2 një bateri me mbishkrimin Fujifilm, rezulton se në sipërfaqen e baterisë nuk ka pasur nxitje të vijave papilare, e po ashtu edhe nga raporti i sektorit për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të T.I.-së, e kryer nga Policia e Kosovës, si dhe nga raporti i ekspertimit i bërë nga AKF, me nr. AKF-2023-0291, i dt. 18.08.2023, dhe raporti i ekspertimit i lëshuar nga Instituti Forenzik në Cyrih të Zvicrës, nga këto tri ekspertiza nuk ka mundur të vërtetohet se, personi i cili shihet në videoincizimin e marrë nga kamerat e tani të ndjerit, është i pandehuri D. Gj..*

Po ashtu, nuk qëndrojnë edhe pretendimet e prokurorisë se i pandehuri me datë 14.10.2018, pa autorizim, ka poseduar materie eksplozivi të tipit dhe natyrës së panjohur në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla e të cilin eksploziv ditën kritike rreth orës 08:02 min, i pandehuri e aktivizon në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës duke privuar nga jeta tani të ndjerin H. A. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, pasi që përveç provave të cekura më lartë edhe nga raporti për menaxhimin e kufirit të Policisë së Kosovës, rezulton se D. Gj., me datë 11.09.2018, në ora 10:32 minuta, ka hyrë në territorin e Rep. së Kosovës përmes pikës kufitare të Vermicës. Me datë 30.09.2018, në ora 14:33 minuta, D. Gj. ka hyrë në territorin e Rep. së Kosovës, pra në rastin konkret nuk ka mundur të vërtetohet se i pandehurit ditën kritike ka qenë në fshatin S. dhe i njëjti e ka vendosur materien eksplozive dhe përmes teledirigjimit e ka aktivizuar këtë materie e cila ka sjellë pasoja fatale për jetën e viktimës.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 3 par. 2 të KPPK-së, ku është paraparë parimi *in dubio pro reo*, e i cili parasheh se: “*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”, si dhe pas administrimit dhe analizimit të provave (personale dhe materiale) gjatë shqyrtimit gjyqësor, daljes në vend të ngjarjes-rikonstruksionit, mbrojtjes së të pandehurit, si dhe fjalës përfundimtare të palëve, nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, andaj duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënpar.1.3 të KPPK-së, të akuzuarin D. Gj., e ka liruar nga akuza për veprat penale Vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1, pika 1.5 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

#### *9. Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike*

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarve lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

#### *10. Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës penale*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti për Krime të Rënda  
PKR.nr.112/2022 datë 17.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale,  
Ardiana Nikollbibaj Thaqi

Kryetari i trupit gjykues,  
Ilir I. Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.